Activities for the protection and maintenance of monuments, alongside their tracking in the territory of our country, took the first steps with the creation of the Institute of Sciences, from a small core of researchers and archaeologists. In those previous years, they were few in number but they laid the foundation of a work that continued to grow in years.

The first important step in this field was the drafting of the first list of monuments under state protection (1948), which brought consequently the need for maintenance work on them. It was a small nucleus of a major strand for the nation, with capable and dedicated pople, who, for a decade worked in difficult conditions, to discover real whealth of national culture. It is worth mentioning these precursor as Jovan Adami, Viktori Puzanova, Theofan Popa and Koço Zheku, who laid the foundation of establishing a special sector, when in 1959, at the State University of Tirana, arose the Material Culture Group - at the Institute of History and Linguistics.

By that time, an organized job for monuments tracking and their putting under protection began, - protection of the Museum City of Berat in 1961 and ther cities (List of 1963), restoration atelier arose, foreign experts were invited to evaluate the real cultural whealth and teach the method of restoration. Let us mention here is Bllavatskin, Llazarev, Filatov and Kostka.

At the end of the year 1962 the personel of restoration sector grew and began to really function, so we have an increased volume of work, the degree of interference, there was a participation in the Second Congress of Restorers in Venice (1964) with a commentary and an exhibition on the museum city of Berat. All these quantitative and qualitative changes, alongside the efforts of managerial staff like Gani Strazimiri, made possible the creation of the Institute of Cultural Monuments, 50 years ago, which marked a turning point in this field.

The Institute pursued clear tasks: the protection and restoration of monuments, which required professional preparation work of all employees. Thus, the control of the existing situation of the monuments was accompanied with the tracking of monuments in the entire territory, especially for the medieval folk architecture and construction, about which, someone else was not dealing enough. New lists of monuments under state protection were designed and historical

centers in other cities of the country were declared.

Restoration of monuments started from their continuous maintenance, that consisted in damage repairing that the monument suffered as well as in interventions to avoid further damage, up to the interventions to a full assessment, pointing out its historical and artistic values that time and bad treatment had hidden or alienated. Scientific sessions were organized and the publication of the magazine “Monumentet” started, which gave support to the professional development of staff and the assessment of their work.

Fundamental changes in political and economic life of the country after the years ‘80 affected the activity of the Institute, the research and restoration work, provizion of funds, removal of professionals, lack of interest by young people to deal with it as well as the introduction without criterion of the private.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Prof. Dr. Pirro THOMO

DO NOT COPY

PËR NJË INTERPRETIM MË TË DREJTË TË NOCIONEVE "MONUMENT I KATEGORISË SË DYTË" DHE "RIJETËZIM I MONUMENTEVE"

Në legjislacionin shqiptar, nocioni "monument i kategorisë së dytë" është shumë i vjetër. Për herë të parë e ndeshim te "Rregullorja mbi Administrimin e Qytetit-muze të Beratit", miratuar me Vendimin Nr. 170, datë 2.6.1961 të Këshillit të Ministrave. Sipas kësaj rregulloreje, monumente të kategorisë së dytë klasifikoheshin të gjitha banesat brenda zonave-muze, përveç monumenteve të kategorisë së parë, në të cilat ruhej rigorozisht pamja e jashtme. Është e kuptueshme se kjo lidhej me vlerat urbanistike të ansambleve muze, sepse heqja ose transformimi i një njësie do të cenonte unitetin stilistik të gjithë ansamblit. Për të krijuar kushte të favorshme banimi, në këtë kategori monumentesh lejoheshin ndryshime të brendshme (Fig. 1, 2).

Me kalimin e viteve dhe me shpalljen e Qendrave Historike edhe të qyteteve të tjera, ndryshoi dhe koncepti fillestar i monumentit të kategorisë së dytë. Tashmë monumente të kategorisë së dytë nuk kufizohen vetëm brenda Qendrës Historike, por ato ndodhen edhe zonat e tjera të qytetit, në zonat e mbrojtura, madje dhe në zonat e lira, duke u nisur nga vlerat e këtyre ndërtimeve. Pra ato shpallen jo vetën nga vlerat e formulimit të



Fig. 1. Pamje nga Berati



Fig. 2. Pamje nga Gjirokastra

jashtëm arkitektonik për t'u integruar me ansamblin e mbrojtur, por edhe nga vlerat vetiake që këto ndërtime përmbajnë. Për t'iu përgjigjur këtij koncepti të ri, përkufizimi i kësaj kategorie monumentesh në ligjin e trashëgimisë është i tillë: *"Monumente të kategorisë së dytë janë ndërtimet me vlera të spikatura, kryesisht në pamjen e tyre të jashtme....."* (Neni 27). E zbërthyer kjo në rregulloret përkatëse merr formulimin: *"Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete".*

Sot kanë ndryshuar dhe kriteret e përzgjedhjes së ndërtimeve të klasifikuara si monumente të kategorisë së dytë. Kështu p.sh., kriteret ku jemi mbështetur për propozimet për shpalljen e monumenteve të kategorisë së dytë për qytetin e Korçës kanë qenë:

1. Të përfaqësohen të gjitha periudhat historike të zhvillimit të qytetit. Me këtë nënkuptojmë jo vetëm periudhat e vjetra, por edhe ato të reja me ndërtesat karakteristike për çdo periudhë.

2. Të përfaqësohen të gjitha tendencat arkitektonike karakteristike për çdo periudhë historike, duke përfshirë dhe ato me tendenca formaliste apo eklektike, të cilat dëshmojnë për shijet e shoqërisë









Fig. 3.1, 3.2. Amfiteatri i Veronës

Fig. 4.1, 4.2. Irodio, Akropoli i Athinës

DOWNLOAD COPY

qytetare në disa periudha të caktuara. Po kështu është theksuar dhe futja e koncepteve moderne apo racionale.

3. Me qenë se shembujt më të goditur të zhvillimit tipologjik të banesës janë cilësuar si monumente të kategorisë së parë, rëndësi iu vu dhe shpërndarjes territoriale të kësaj tipologjie në pjesët e ndryshme të qytetit.

4. Në ansamblet që shquhen për unitetin e formulimit urbanistik, siç është në rastin konkret bulevard "Republika", janë zgjedhur ato banesa që marrin pjesë aktive në këtë formulim.

5. Rëndësi i është kushtuar dhe pozicionit të banesave në rrjetin rrugor, i cili për lagjet e reja i bindet sistemit urbanistik ortogonal. Këto banesa do të shërbejnë si garanci e ruajtjes së sistemit urbanistik





Fig. 5.1, 5.2. Teatri i Butrintit

dhe si reperë për ruajtjen e siluetit të ansambleve gjatë ndërtimeve apo rikonstruksioneve të reja, të lejuara nga Rregullorja e Qendrës Historike.

Ndonëse kriteret për përcaktimin e ndërtesave si monumente të kategorisë së dytë kanë ndryshuar, përkufizimet e tyre në legjislacion përmbajnë një dozë të theksuar të përkufizimit të vjetër.

Në praktikë ndeshemi shumë shpesh me kërkesa për ripërdorim monumentesh. Kalohet kështu në nocionin e dytë: rijetëzimin e monumentit (*vitalization, reanimation*). Në qoftë se kriteret për shpallje monumentesh janë tashmë të konsoliduara, në bazë të të cilave janë arritur në përfundime të njësuara dhe të pranuara nga specialistët e kësaj fushe, më me interes na duket diskutimi i problemit tjetër, përdorimi i tyre, sepse këtu pleksen koncepte dhe interesa të fushave të ndryshme, duke mos arritur gjithmonë në mendime të njëjta dhe në zgjidhje të pranueshme. Rijetëzimi i monumenteve është edhe ky një nocion i vjetër, që lidhet me konservimin dhe përdorimin e tyre për nevojat e dobishme të shoqërisë. Por procesi i rijetëzimit ka një kusht themelor, të konsakruar në ligje vendase, siç është Ligji 9048 (Neni 29, pika 6, Neni 39) për trashëgiminë kulturore dhe në konventa ndërkombëtare, siç është Karta e Venecias (Neni 5), që përdorimi i monumentit në asnjë mënyrë nuk duhet të cënojë vlerat, për të cilat një ndërtim është klasifikuar monument kulture.

Në praktikën botërore për rijetëzimin e monumenteve është parapëlqyer përdorimi i tyre me funksionet të ngjashme me karakterin fillestar. Kështu ka ndodhur p.sh. me amfiteatrin e Veronës (Fig. 3.1, 3.2)., apo Irodhion në shpatin e kodrës së Akropolit të Athinës (Fig. 4.1, 4.2)., të cilat përdoren gjerësisht për shfaqje teatrale, koncertale e deri operistike. Ky parim është zbatuar edhe në vendin tonë, siç është rasti i teatrit të Butrintit, ku kryhen Festivalet Ndërkombëtre të Teatrove (Fig. 5.1, 5.2)., ose i amfiteatrit të Durrësit,

DO NOT COPY

ku herë pas here janë kryer aktivitete kulturore (Fig. 6.1, 6.2).

Por, në shumë raste të tjera është i papranueshëm





Fig. 6.1, 6.2. Amfiteatri i Durrësit

tjetërsimi i karakterit të monumentit. Tipik është rasti i projektit **të rijetëzimit** të Kalasë së Lezhës, projekti i së cilës e kthente kalanë në një qendër hoteliere, projekt i cili me të drejtë u quajt i papranueshëm (Fig. 7.1, 7.2).

Por, në praktikën botërore ka dhe raste kur ruhet vetëm pamja e jashtme, ndërsa nga brenda kryhen ndryshime kompozicionale e funksionale. Rast për këtë shërben qendra tregtaro-shoqërore në buleverdin Cimisqi të Selanikut. Ndërtesat me funksion fillestar





Fig. 7.1, 7.2. Kalaja mesjetare e Lezhës

magazina duhani, të cilat janë të papërdorshme në ditët tona, do të stononin me karakterin e gjallë dhe plot lëvizje të kësaj arterie tregtare elitare. Mbas diskutimeve të shumta u vendos që të ruheshin fasadat e jashtme për të mos dëmtuar siluetin dhe historicizmin e rrugës (Fig. 8.1, 8.2)., mbushur me ndërtesa të vjetra, ndërsa pjesa e brendshme e kuartallit të marrë një funksion të ri, në përputhje me karakterin e shëtitores, pra si një qendër e gjallë tregtare, kulturore e administrative (Fig. 9.1, 9.2).

Le të rikthehemi të rijetëzimi i monumenteve të kategorisë së dytë, ku kërkesat e ripërdorimit të tyre janë më të shumtat, duke arritur shpesh herë në praktika të gabuara, që marrin për bazë vetëm një pjesë të përkufizimit, ruajtjen e pamjes së jashtme, duke neglizhuar komponenten e dytë dhe shumë esenciale, vlerat e spikatura të këtyre ndërtimeve.

Duke pasur parasysh kriteret e shpalljes së monumenteve, arrijmë në përfundimin se vetëm në një pjesë të ndërtimeve të propozuara për monumente të kategorisë së dytë do të ruhen rigorozisht për pamjen e tyre të jashtme, ndërsa nga brenda mund të ndryshojë

DO NOT COPY









Fig. 8.1, 8.2, Qendra tregtaro-shoqërore, Selanik. Pamje nga rrugët kryesore

Fig. 9.1, 9.2. Qendra tregtaro-shoqërore, Selanik. Pamje nga oborri i brendshëm

zgjidhja kompozicionale dhe funksionale.

Por edhe në tilla raste shpesh për nevojat e përdorimit të ri nuk respektohen vlerat ose logjika e kompozimit të pamjes së jashtme. Si shembull na shërben një banesë në bulevard "Republika" të Korçës, e kthyer në restorant (Fig. 10.1, 10.2). Këtu janë prishur shkallët ballore, është mbyllur porta qendrore e rrethimit me kangjella të oborrit dhe janë ndërtuar shkallët me hyrje anësore, duke përdorur në këtë rast hyrjen sekondare të banesës (Fig. 11.1, 11.2). Në këtë rast projektuesi i këtyre ndryshimeve, të cilat i janë dukur të parëndësishme, nuk ka kuptuar thelbin e formulimit të shëtitores, mbushur me vila të njëkohëshme me banesën në fjalë. Karakteristikë për shëtitoren është vendosja ballore e ndërtesave karshi rrugës, ndërtimi i shkallëve qendrore paradë, zgjerimi i hapësirës urbanistike nëpërmjet rrethimit me kangjella dhe zbukurimit të saj me sipërfaqet e gjelbëruara të oborreve, si dhe me skulpturë monumentale e dekorative të rrethimeve të banesave, të cilat i kanë dhënë vlera të vërteta estetike shëtitores (Fig. 12.1, 12.2). Është e kuptueshme se transformimi i hyrjes së banesës ka cënuar pikërisht

DO NOT COPY





Fig. 10.1, 10.2. Banesë në Korçë

këtë karakter progresiv shoqëror dhe këtë vlerë estetike dhe urbanistike të shëtitores.





Fig. 11.1,11.2. Banesë në Korçë. Transformimi i hyrjes

Por, ndër ndërtime të tjera të propozuara për qytetin e Korçës do të ishte e palejueshme tjetërsimi i funksionit fillestar.

Për shembull, është propozuar për t'u vënë në





Fig. 12.1, 12.2. Banesa në Bulevard Republika, Korçë

mbrojtje hotel "Pallas" në shëtitoren e Shën Gjergjit, si ndërtim i parë i projektuar dhe përdorur si hotel, që në vitin 1928 (apo 1926) (Fig. 13). Në këtë rast, tjetërsimi i funksionit fillestar, duke ruajtur të paprekur pamjen e jashtme, nuk do të kishte kuptim, sepse do të binte ndesh me argumentimin për përcaktimin e kësaj ndërtese si monument, si hotel i parë në qytet dhe me një koherencë ndërmjet funksionit dhe formulimit arkitektonik të

DO NOT COPY



Fig. 13. Hotel Pallas, Korçë

jashtëm. Përcaktimi si monument i kategorisë së dytë i jep mundësi përmirësimeve të kushteve të brendshme për të rritur klasën e hotelit, gjithmonë duke mos prekur funksionin fillestar.

Ose le të shqyrtojmë ndërtesën e Liceut Kombëtar, ndërtuar në 1937 (Fig. 14), dhuratë e bamirësit të njohur korçar Thoma Turtulli, krahas dhuratave të tjera, si Biblioteka, Spitali, Shkolla Teknike etj. Përdorimi deri vonë i ndërtesës për nevojat e administratës ushtarake, pra ndryshimi i funksionit, dëmtonte jo vetëm vlerat e monumentit, por dhunonte dhe kujtimin e donatorit



Fig. 14. Liceu Kombëtar, Korçë

më të madh korçar. Rikthimi i ndërtesës në institucion universitar ishte zgjidhja më e përshtatshme, sepse respektonte si vlerat, ashtu dhe destinacionin mësimor fillestar të ndërtesës, madje duke e lartësuar atë.

Rasti i projektit të transformimit të Hotel Dajtit për kërkesa administrative është rasti më domethënës i keqinterpretimit të nocionit monument i kategorisë së dytë, ku pretendohet se është ruajtur pamja e jashtme





Fig.15.1, 15.2. Hotel Dajti, Tiranë dhe pjesë e projektit të transformimit

DO NOT COPY

e ndërtesës. Hotel Dajti, vepër e arkitektit italian Gherardo Bosio, krahas ndërtesës së Universitetit, Akademisë së Arteve, Kolonadës me Rektoratin dhe Muzeun Arkeologjik, Kryeministrinë, Pallatin e Brigadave, përveç planeve urbanistike në Tiranë, përbën një set ndërtesash, ku shpalosen fuqishëm konceptet progresiste të tij, si pasues i Walter Gropiusit apo shkollës Bauhaus në Gjermani etj., duke u bërë pjesë e një rrethi artistësh e arkitektësh që i kishin vënë vetes misionin e vështirë për të sjellë frymën avanguarde edhe në Itali. Si gjithë ndërtimet e tij, edhe hotel Dajti, si përfaqësuese të rrymës arkitektonike racionale të viteve 30-40 të shekullit të kaluar, dallohet për një zgjidhje të përkryer funksionale, si dhe për një koherencë të suksesshme dhe të pagabueshme të zgjidhjes së brendshme me pamjen e jashtme. Pikërisht këto janë vlerat e vërteta të ndërtesës, të denja për t'u cilësuar monument kulture dhe jo vetëm ndodhja e saj në Qendrën Historike të Tiranës. Tjetërsimi i funksionit të ndërtesës do të sillte prishjen e hamonisë ndërmjet zgjidhjes kompozicionale dhe formulimit arkitektonik të jashtëm, pra do të sillte cënimin e vlerave të vërteta për të cilat ndërtesa është shpallur monument kulture. Në rast zbatimi të këtij projekti do të kemi një vëllim të thjeshtë brenda Qendrës Historike, por do të humbisnim një monument të mirëfilltë, gjë që nuk do na i falnin brezat e ardhshme (Fig. 15.1, 15.2).

Si përfundim, mund të themi se shumë nga keqinterpretimet e nocioneve të mësipërme, të cilat rrjedhin edhe nga përkufizimet jo shumë të qarta të legjislacionit janë të riparueshme, sepse është më e lehtë të qartësojmë përkufizimet, se sa të dëmtojmë monumentet. Po kështu në kartelat e monumenteve duhet të theksohen argumentet e shpalljes së tyre si monumente të kategorisë së dytë apo të parë, si dhe vlerat reale të çdo njërës prej tyre.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Pirro THOMO

DO NOT COPY

FOR A FAIRER INTERPRETATION OF THE NOTIONS "MONUMENT OF THE SECOND CATEGORY" AND "RIVITALIZATION OF MONUMENTS"

Referring to the Albanian legislation, the term "monument of second category" is very old. We came across the term for the first time in the "Regulation on the Administration of the Museum City of Berat", approved by Decision no. 170, dated 02.06.1961 of the Council of Ministers. Under this regulation, the monuments classified in the second category were all the buildings within the Museum Area Zones, besides monuments of the first category, in which appearance was rigorously kept. It is understood that it was related to urban values of museum ensembles, because the removal or transformation of a unit would affect all the stylistic unity of the ensemble. To create favorable housing conditions, in this category of monuments, internal changes were allowed.

Over the years and with the announcement of the Historic Centres of other cities, the original concept of the second category monument changed. They are located not only in the museum areas, but also in other areas of the city, starting not only from external architectural formulation values to be integrated with the protected ensemble, but also from the personal values these constructions contain.

To respond to this new concept, the definition of this category of monuments in the heritage law is such: «Monuments of the second category are the constructions of distinguished values, mainly in their outward appearance .....». Resolving this in the respective regulations it takes the formulation: «monuments of the second category are buildings with cultural and historical values, mainly formative of urban-architectural ensembles, that participate in the compositional formulation of the city, but also preserving architectural values in themselves»

In practice, besides the correct understanding of this definition, we encounter cases when it is just taken only a part of the definition, maintaining the outward appearance, neglecting the second but most essential component, the salient values of these properties. This often leads to the violation or loss of real values of the monument.

The same thing happens with the notion revitalization. Revitalization, Vitalizzazione, vitalization, reanimation is a process, which enables the use of the monument for useful needs of the society. But this process has an underlying condition, consecrated in domestic laws, such as Law 9048 for cultural heritage and international conventions, such as the Charter of Venice, the use of the monument in no way should undermine the values on which a building is classified monument of culture. Even here, in addition to positive examples, we encounter occassions, when this fundamental principle is violated wrongfully, practically losing the monument.

DO NOT COPY

Lejla HADŽIĆ
Drejtore e Trashëgimisë Kulturore pa Kufij, Shqipëri
Elena MAMANI
Zv.Drejtore e Trashëgimisë Kulturore pa Kufij, Shqipëri

DO NOT COPY

VLERËSIMI I GJENDJES SË 650 NDËRTESAVE TË DEKLARUARA SI MONUMENTE TË KATEGORISË SË PARË DHE TË DYTË NË QENDRËN HISTORIKE TË GJIROKASTRËS DHE KATEGORIZIMI I NDËRHYRJEVE.

1. HYRJE

Vlerësimi i gjendjes së monumenteve të kategorisë së 1-rë dhe të 2-të u krye gjatë periudhës 15 Nëntor 2014 – 31 Janar 2015. Vlerësimi përfshiu 650 ndërtesa të shpallura monumente kulture në Qendrën Historike të Gjirokastrës.

Ky proces u ndërmor nga Organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) dhe Universitetin Epoka. Qëllimi i këtij vlerësimi ishte të analizonte gjendjen aktuale të 650 monumenteve dhe t'i klasifikonin ato sipas prioriteteve për ndërhyrje.

Secili monument u analizua duke përdorur formularin e vlerësimit të gjendjes së tij. Në këtë mënyrë u krijua një dosje për secilin monument që përmbante formularin e plotësuar dhe fotografi.

Metodologjia e vlerësimit u bazua në kombinimin e të dhënave mbi gjendjen aktuale të monumenteve, (përdorimi/funksioni, kategoria e rrezikut, përmbajtja e elementëve historikë), për të rezultuar në kategorizimin sipas prioriteteve për ndërhyrje. Prioritetet e ndërhyrjeve u analizuan më tej për të rezultuar në propozimin për hapat që duhen ndërmarrë përsa i përket ndërhyrjeve në monumentet e kategorisë së 1-rë dhe të 2-të.

Ky është një vlerësim i dytë i këtij lloji i bërë për monumentet e Gjirokastrës. Vlerësimi i parë është bërë nga një grup ekspertësh italianë[1] në vitin 2003. Brenda këtij dokumenti do të paraqesim disa krahasime midis dy studimeve për të treguar se sa i shpejtë është procesi i degradimit të monumenteve në Gjirokastër.

Qëllimi i këtij studimi/vlerësimi ishte krijimi i themeleve për ndërtimin e një strategjie konkrete për ndërhyrjet në monumentet e Gjirokastrës. Ky vlerësim i gjendjes së monumenteve mund të drejtojë nivelet si dhe prioritetet për gjithë ndërhyrjet në monumentet e Gjirokastrës në të ardhmen.

2. METODOLOGJIA

Vlerësimi i monumenteve u përcaktua në bazë të

[1] Torreni, Francesco, *ed., Alla Scoperta della Città di Pietra: il Piano di Ricupero del Centro Storico di Gjirokastra, Torino: 2001-5 - Një studim i thellësishëm i qytetit të vjetër të Gjirokastrës i publikuar në 3 volume.*

aspekteve kyçe të mëposhtme:

Gjendja e Monumentit Përdorimi/Funksioni Rrezikshmëria Konteksti Historik

Secili prej elementëve të mësipërm është përcaktuar në bazë të një formulari vlerësimi që është plotësuar nepërmjet vizitave dhe vlerësimit në terren të çdo monumenti individualisht. Matrica e kombinimit të të dhënave të formularit të vlerësimit përcakton kategorinë e prioriteteve.

2.1 Gjendja e Strukturës së monumentit

Vlerësimi i gjendjes së monumenteve u krye nëpërmjet vëzhgimit vizual të elementeve të tyre strukturorë: çatia, muret, dyshemetë/tavanet. Gjendja e secilit prej elementeve përcaktohej në 4 nivele: "e mirë", "e dobët", "e keqe", "shumë e keqe" ose "jo" (për elementët që mungonin plotësisht). Vlerësimi i përgjithshëm i strukturës së monumenteve përcaktohej duke iu referuar gjendjes më të keqe të njërit prej 3 elementeve (Fig. 1- Shembull).



Fig. 1. Shembull

Nëse njëri prej elementëve strukturorë mungon plotësisht, ndërtesa konsiderohet që të jetë në një **gjendje shumë të keqe**, prandaj vlerësimi i përgjithshëm bëhet duke marrë parasysh vlerësimin më të ulët të bërë për elementët e tjerë: **i dobët, i keq apo shumë i keq**.

2.2 Përdorimi/Funksioni

Përdorimi i monumentit përcaktohet si: i pabanuar, pjesërisht i banuar/pjesërisht në funksion, i banuar/në funksion.

Përdorimi përcaktohet më tej sipas pronësisë (private, private/me shumë pronarë, komunitet fetar, shtet apo tjetër) (Fig. 2, 3 - Shembull).



Fig. 2. Shembull



Fig. 3. Shembull

Këto të dhëna do të shtohen vetëm nëse janë të njohura apo janë gjendur gjatë vizitës në monument.

Më tej, mënyra e përdorimit përcaktohet sipas atij

DO NOT COPY

publik apo privat (me mundësinë për të shtuar më shumë opsione nëse do ishte e nevojshme) (Fig. 4 – Shembull)

4. PËRDORIMI më shumë se një opsion

☐ Përdorim privat ☐ Përdorim publik

Fig. 4. Shembull

Të dhënat nga:
Gjendja e Monumentit
Përdorimi/Funksioni
do të kombinohen duke përdorur MATRICËN e



Fig. 5. Niveli i parë i Matricës

5. GJENDJA E MONUMENTIT

Gjendja e Elementëve Strukturorë

Mirë	Keq	Dobët	Shumë Keq	No	
☐	☐	☐	☑	☐	Çatia
☑	☐	☐	☐	☐	Muratura
☑	☐	☐	☐	☐	Dysheme/Tavane

Gjendja e Përgjithshme

Mirë	Keq	Dobët	Shumë Keq
☐	☐	☐	☑

Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme

Emëruesi i përbashkët më i ulët për të tre elementët strukturorë. Nëse një nga elementët është vlerësuar me "Jo" të mos merret parasysh

3. PËRDORIMI

☐ E Pabanuar apo jo në përdorim
☑ Pjesërisht e banuar apo në përdorim
☐ E banuar apo në përdorim

Fig. 6. Shembull

DO NOT COPY

mëposhtme (Fig. 5) (Fig. 6).

2.3 Rrezikshmëria

Nëse nga konstatimi në terren do të kishim rezultatin që monumenti është në **gjendje shumë të keqe** strukturore, **është pjesërisht i banuar apo pjesërisht në përdorim**, atëherë do rezultonte se ky monument paraqet një **rrezik shumë të lartë** (Fig. 7).

Pas përcaktimit të rrezikshmërisë (kategorisë së riskut), monumenti vlerësohet më tej bazuar në kontekstin historik që elementët e tij mbartin.

2.4 Përmbajtja Historike

Përmbajtja historike i referohet elementëve historikë /autentikë të mbetura në monument. Monumentet e kategorisë së 1-rë janë vlerësuar bazuar në elementët e tyre të jashtëm dhe të brendshëm (interior), ndërsa monumentet e kategorisë së 2-të për elementët e tyre të jashtëm.



Fig. 7. Shembull i kombinimit të të dhënave të Matricës

DO NOT COPY

Monumentet e kategorisë së 1-rë

Elementët e jashtëm të identifikuar janë: çatia, muratura e jashtme, suvaja, dyert, dritaret, porta e jashtme (hyrja).

Elementët e brendshëm të identifikuar janë: dysheme/tavan, muret e brendshme, vepra arti/punime artizanale në dru, vepra arti/piktura.

Monumentet e kategorisë së 2-të

Elementët e jashtëm të identifikuar janë: çatia, muratura e jashtme, suvaja, dyert, dritaret, porta e jashtme (hyrja).

Përmbledhja e vlerësimit të këtyre elementëve është një llogaritje matematikore[2] që përcakton nivelin e elementëve historikë në **të ulët, mesatar, të lartë dhe shume të lartë** (Fig. 8).



Fig. 8. Shembull

[2] *Në llogaritjen matematikore të gjithë elementët janë konsideruar me të njëjtat vlera*

2.5 Kategoria e Prioriteteve

Niveli i rrezikshmërisë në kombinim me të dhënat e përmbajtjes historike përcakton kategoritë e prioriteteve.

Nëse marrim si shembull një monument të klasifikuar në kategorinë e **rrezikshmërisë së lartë** dhe me **përmbajtje historike të mesme** dhe bëjmë kombinimin e këtyre dy elementëve sipas pjesës së dytë të Matricës, rezulton se ky monument është në



Fig. 9. Shembull i kombinimit të të dhënave të Matricës

kategorinë e prioriteteve B (Fig. 9).

Përcaktimi i kategorive të prioriteteve shtjellohet më tej në 7 kategori:

A – Rrezik i menjëhershëm, përmbajtja historike e lartë

B – Rrezik i menjëhershëm, përmbajtja historike e ulët

C – Shkatërrim i ngadalshëm, përmbajtja

DO NOT COPY

historike e lartë

D – Shkatërrim i ngadalshëm, përmbajtja historike e ulët

E – Në rrezik/ndërtesa vulnerable, përmbajtja historike e lartë

F – Në rrezik/ndërtesa vulnerable, përmbajtja historike e ulët

G – Ndërtesa në gjendje të mirë ose të dobët strukturore, përmbajtja historike e lartë ose e ulët

2.6 Kategoritë e ndërhyrjeve

Për të përcaktuar kategorizimin për ndërhyrjet, kategoritë e prioriteteve A-G janë kombinuar më tej me faktorët e mëposhtëm:

-Gjendja e monumentit (shumë e keqe, e keqe, e dobët, e mirë, shumë e mirë)

-Modifikimet e bëra në monument (ndërhyrjet e paligjshme)

-Niveli i përmbajtjes historike/elementët autentikë (i lartë, i mesëm, i ulët).

Përmbledhja e gjithë elementeve të mësipërm rezultoi në kategoritë e mëposhtme të ndërhyrjeve:

-Tipi 1 - Rrënoja

-Tipi 2 - Para rrënimit

-Tipi 3 - Shumë e keqe/ndërhyrje të jashtëligjshme

-Tipi 4 - E keqe/ndërhyrje të jashtëligjshme

-Tipi 5 - Dobët/ndërhyrje të jashtëligjshme

-Tipi 6 - Mirë/ndërhyrje të jashtëligjshme

-Tipi 7 - Shumë mirë/ndërhyrje të jashtëligjshme

-Tipi 8 - Jo në nevojë për ndërhyrje të menjëhershme

Kategoritë e mëposhtme:

-Para rrënimit

-Shumë e keqe/ndërhyrje të jashtëligjshme

-E keqe/ndërhyrje të jashtëligjshme

-Dobët/ndërhyrje të jashtëligjshme

Janë shqyrtuar më tej dhe nga aspekti i banimit/përdorimit.

Kategoria:

-Shumë mirë/ndërhyrje të jashtëligjshme

U shqyrtua edhe më tej kundra përmbajtjes historike, duke marrë parasysh monumentet me përmbajtje historike të ulët dhe të mesme.

Përmbledhje e rezultateve mund të gjenden në Tabelën 9 (Fig. 10).

Kategoritë e ndërhyrjeve	Lloji i ndërhyrjes	kategori prioriteti A		kategori prioriteti B		kategori prioriteti C		kategori prioriteti D		kategori prioriteti E		kategori prioriteti F		kategori prioriteti G		total
		kat. 1-rë	kat. 2-të	kat. 1-rë	kat. 2-të	kat. 1-rë	kat. 2-të	kat. 1-rë	kat. 2-të	kat. 1-rë	kat. 2-të	kat. 1-rë	kat. 2-të	kat. 1-rë	kat. 2-të	
RRËNOJA	1	4	7	1	21				1							
total		4	7	1	21				1							34
PARA KOLAPSIT	2 pa banuar	2	3	1	2											
	2.1banuar	4	2		1											
total		6	5	1	3											15
SHUMË KEQ/NDËRHYRJE TË PALIGJSHME	3 pa banuar		19	1	5								1			
	3.1banuar		4		2	2	6									
total			23	1	7	2	6						1			40
EQ/NDËRHYRJE TË PALIGJSHM	4pa banuar	1					18		2	2	6		6			
	4.1 banuar									1	12		3			
total							18		2	3	18		9			51
DOBËT/NDËRHYRJE TË PALIGJSHME	5 pa banuar									1	5		5			
	5.1 banuar								4	7	29		21			
total									4	8	34		26			72
MIRË/NDËRHYRJE TË PALIGJSHME	6											2	23			
total												2	23			25
SHUMË MIRË/NDËRHYRJE TË PALIGJSHME	7													13	122	
	7.1														170	
total														13	292	305
JO NDËRHYRJE TË MENJËHERSHME	8													17	88	
total														17	88	105

Fig. 10. Përmbledhje e Rezultateve

DO NOT COPY

3. KRAHASIME VIZUALE

Monumentet e Gjirokastrës po degradojnë me ritme të shpejta. Kjo është më se e dukshme në krahasimin me studimin e bërë nga skuadra italiane, nga ku mund të shikojmë se vetëm në 8 vjet, monumente me çati janë kthyer në rrënoja (Foto 11, 12) (Foto 13,14).

Faktor tjetër shqetësues është dhe transformimi i monumenteve nëpërmjet ndërhyrjeve të jashtëligjshme. (Foto 15), (Foto 16).

DO NOT COPY









Fig 11, 12. Monumenti Hadëri; lart -2006; poshtë - 2014

Fig 13,14. Monumenti Dalipi; lart -2006; poshtë - 2014



Fig. 15. Monumenti Lani, kategoria e 2-të



Fig. 16. Monumenti Mangaj, kategoria e 2-të

4. KONKLUZIONE

Qendra Historike e Gjirokastrës përmban afërsisht 1200 ndërtesa historike, prej të cilave, **650 janë të shpallura Monumente Kulture** dhe kanë nevojë të menjëhershme për një qasje strategjike.

Nga vlerësimi që u bë për gjendjen e 650 monumenteve të kategorisë së 1-rë dhe të 2-të u verifikua se këto monumente janë në një gjendje kritike. **169 monumente** kanë rezultuar të jenë në kategorinë e gjendjes strukturore **shumë të keqe** apo **të dobët**, **35** prej të cilave **janë rrënoja**. Analiza përmbledhëse ka rezultuar në ndarjen e monumenteve sipas 7 kategorive të ndryshme prioritetesh. Kategoritë e prioriteteve kanë rezultuar më tej në kategoritë e ndërhyrjeve, ku **51 monumente** janë **në nevojë të ndërhyrjeve të menjëhershme** dhe **40** të tjera **në nevojë të ndërhyrjeve brenda një kohe shumë të shkurtër**.

Sipas rezultateve të vlerësimit të gjendjes, **357 monumente** u janë nënshtruar **ndërhyrjeve të jashtëligjshme**, dhe këto përfaqësojnë më shumë se gjysmën e ndërtesave të shpallura monumente. **122** prej këtyre 357 monumenteve **kanë humbur pothuajse gjithë karakteristikat e tyre monumentale**. **170 monumentet** e tjerë **janë transformuar plotësisht.**

Monumentet e abandonuar janë ato që paraqesin rrezikshmëri më të lartë. Sot në Gjirokastër ka **79 monumenta të pabanuara** (në këtë numër nuk përfshihen monumentet e rrënuara) dhe gjendja e tyre është duke u përkeqësuar.

Kjo strategji përfshin një sërë hapash; plan i integruar konservimi për zonën e mbrojtur; ndërhyrje emergjente stabilizuese; përpilimi i projekteve të plota restauruese për monumentet: projekte të plota riadaptimi të monumenteve të transformuar; përpilimi i programeve dhe planeve të mirëmbajtjes, ndërhyrje këto që konsiderohen për një periudhë afatshkurtër (2 vjeçare) dhe afatgjatë (10 vjeçare).

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është ngritja e një skeme monitorimi të përvitshme për monumentet. Në këtë mënyrë monumentet mund të monitorohen si dhe të ndalohen ndërhyrjet e paligjshme.

5. FALËNDERIME

Ne do të donim të falënderonim Drejtoren e

DO NOT COPY

Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë zj. Arta Dollani dhe Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastër, z. Albert Kasi, për kontributin e tyre në udhëzimin e grupit të punës në faza esenciale të studimit.

Do të donim të falënderonim gjithashtu Universitetin EPOKA dhe studentët e arkitekturës, Dorela Sina, Bledi Trashani, Luljeta Spahiu dhe arkitekten Elva Cana për punën e tyre të përkushtuar edhe pse shpesh herë nën kushtet e vështira klimaterike të Gjirokastrës.

Falënderime të përzemërta shkojnë për profesorët e tyre, Prof. Dr. Frida Pashako dhe Prof. Jurtin Hajro, për mbështetjen dhe udhëzimet e tyre profesionale.

Gjithashtu, duam të falënderojmë Universitetin e Gothenburgh, Suedi dhe praktikantin e tyre, z. Anton Bachs, për kontributin e tij të paçmueshëm në procesin e vlerësimit.

Falënderime z. Matthias Bickert për asistencën e tij në implementimin e projektit dhe hartografinë.

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFI

1. Torreni, Francesco, ed. *Alla Scoperta della Città di Pietra: il Piano di Ricupero del Centro Storico di Gjirokastra*. Torino, 2001-5 - An in-depth study of the old town of Gjirokastra in 3 volumes.
2. Matrica është zhvilluar bazuar në metodologjinë e English Heritage për vlerësimin e monumenteve në rrezik dhe metodologjinë e zhvilluar gjatë projektit të Trashëgimisë Kulturore pa Kufij - Redefining Cultural Values through the Built Heritage of SE Europe (2007-2010).

Lejla Hadžić
Executive Director, Cultural Heritage without Borders, Albania
Elena Mamani
Deputy Director, Cultural Heritage without Borders, Albania

DO NOT COPY

CONDITION ASSESSMENT AND CATEGORIZATION FOR INTERVENTIONS 650 DECLARED 1ST AND 2ND CATEGORY MONUMENTS IN HISTORICAL CORE OF GJIROKASTRA FOR CONSERVATION OF TANGIBLE MONUMENTS

Understanding built heritage as more than the material remains of human-made structures, pervades the work of Cultural Heritage without Borders (CHwB). For the past 20 years, CHwB has been active in developing effective and replicable models both for preserving historic monuments and for building as well as nurturing relations with local conservation professionals and local communities.

The main bulk of work of CHwB remains to be in Gjirokastra. One of the last works conducted by the organization in a partnership with Regional Directorate of National Culture and EPOKA University was the study on Condition assessment and categorization for interventions for 658 listed monuments of 1st and 2nd category in the Historic City of Gjirokastra.

Designated monuments of 1st and 2nd category as verified through condition assessment are in a critical condition. 169 monuments have resulted to be in poor and very bad overall condition out of which 35 are ruins. The summarized analyses have resulted in 7 priority categories. Priority categories have further resulted in categorization of intervention, where 51 monuments are seeking most urgent interventions and further 40 require urgent interventions.

Illegal interventions have affected 357 monuments, which represents more then half of a monument fund. Out of 357 monuments being modified, 122 have lost all their monumental characteristics. Further 170 are transformed almost totally.

Vacant monuments still represent the biggest threat for monuments. Today in Gjirokastra there are 79 non-occupied monuments (not calculating ruins to this figure) and their condition is worsening.

Prof. Dr. Niko CIVICI
Universiteti i Tiranës
Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar

DO NOT COPY

RREZATIMI X – MUNDËSI PËR STUDIMIN E VEPRAVE TË ARTIT; VËSHTRIM MBI VEPRIMTARITË E PËRBASHKËTA

Rrezatimi X përbën një nga zonat e spektrit elektromagnetik që ka gjetur përdorim të gjerë në një sërë metodash që përdoren me sukses për studimin e materialeve, ndër të cilat edhe materialet që përdoren në veprat e artit. Metodat më të njohura janë Radiografia X, Difraksioni X si dhe Fluoreshenca X në të gjitha variantet e realizimit të saj. Informacioni mbi strukturën dhe përbërjen e materialeve të përdorura për veprat e artit, që merret nëpërmjet këtyre metodave, ka rëndësi si për njohjen e metodës së punës së artistit ashtu dhe për zgjedhjen e procedurave më të përshtatshme për konservimin dhe restaurimin e tyre. Për këto arsye ky informacion është mjaft i rëndësishëm për specialistët që studiojnë apo mirëmbajnë veprat e artit.

Metoda e Fluoreshencës së rrezatimit X (XRF) filloi të përdoret për herë të parë në vendin tonë në Institutin e Fizikës Bërthamore në fund të viteve 1970. Gjatë këtyre 35 viteve, laboratori është rritur si nga pikëpamja e infrastrukturës laboratorike ashtu dhe nga pikëpamja e fushave të aplikimeve, ndër të cilat bashkëpunimi me specialistët e IMK për studimin e materialeve të përdorur në pikturat dhe pikturat murale ka qenë një nga më të hershmet.

Në këtë punim, krahas paraqitjes së disa metodave që mbështeten në rrezatimin X dhe mundësive analitike që ekzistojnë në laboratorin FRX të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, do të përshkruhen fazat e ndryshme të bashkëpunimit me specialistët e IMK, shoqëruar me rezultatet e disa studimeve tipike për ikonat dhe pikturat murale.

Materialet e objekteve të trashëgimisë kulturore

Përveç aspekteve estetike, kulturore dhe historike, objektet e trashëgimisë kulturore sjellin edhe informacione mbi mjeshtërinë e artistëve që i kanë krijuar ato. Përgjithësisht këto objekte përbëhen nga materiale me natyrë komplekse të përgatitur nga artistët apo artizanët nëpërmjet përpunimit të lëndëve të para sipas praktikave teknologjike përgjithësisht të ndërlikuara. Për më tepër gjendja aktuale e këtyre materialeve reflekton edhe ndryshimet që kanë ndodhur

gjatë qëndrimit për një kohë relativisht të gjatë në kushtet në të cilat ato janë ruajtur apo gjetur.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, njohja e materialeve dhe teknologjisë së prodhimit të këtyre objekteve është bërë shumë e rëndësishme për konservuesit, restauratorët apo studiuesit e veprave të artit. Interesi për njohjen e materialeve lidhet së pari me nevojën për konservimin e këtyre objekteve dhe së dyti me interesin për të hedhur dritë mbi çështje më të përgjithshme si vendi dhe periudha e prodhimit apo autorësia dhe autenticiteti i tyre [1]. Të dhënat analitike mbi përbërjen dhe strukturën e materialeve duke lejuar vlerësimin e shkallës dhe shkaqeve të degradimit hapin rrugën për zgjedhjen e proceseve optimale të restaurimit dhe konservimit të tyre. Në të njëjtën kohë krahasimi i këtyre të dhënave me ato të objekteve të ngjashme dhe të studiuar më parë, nga vendi apo rajoni, lejon të hidhet dritë mbi çështje të prejardhjes, datimit apo autorësisë së objekteve. Ky interes i rritur shfaqet në numrin e madh të botimeve në revista shkencore si të fushës së restaurimit ashtu dhe atyre të përdorimit të metodave analitike. Në të njëjtën kohë është shtuar numri i konferencave e simpoziumeve shkencore ndërkombëtare që organizohen në mënyrë të rregullt dhe ku paraqiten punime të përbashkëta të specialistëve të veprave të artit dhe atyre të metodave analitike.

Natyra unikale dhe rëndësia kulturore dhe historike e objekteve të trashëgimisë kulturore vendosin disa kërkesa rigoroze ndaj metodave analitike që mund të përdoren për studimin e tyre [1]. Kërkesa më e rëndësishme lidhet me ruajtjen e integritetit aktual të objektit gjatë dhe pas kryerjes së analizës. Kjo kërkon që metoda analitike të ketë natyrë jo shkatërruese, kryerje e analizës mundësisht pa marrje mostre, dhe të mos jetë invazive, të mos lerë gjurmë të dukshme të kryerjes së analizës. Vështirësitë e lëvizjes së këtyre objekteve kërkojnë që metoda analitike të realizohet me sisteme të transportueshëm që analizat të mund të kryhen in-situ, në vendet ku gjenden objektet. Përveç këtyre ka edhe disa kërkesa të tjera që lidhen me mundësitë e metodave për të kryer analiza të sakta pavarësisht nga forma apo madhësia fizike e objektit, natyra shumë elementore dhe ndjeshmëria e mjaftueshme që lejojnë marrjen e informacionit për një numër të madh elementesh dhe mundësinë për të analizuar elementet me përqendrim të ulët, etj. Për fat të keq nuk ekziston një metodë e vetme analitike që të plotësojë të gjitha kërkesat dhe që të japë të gjithë informacionin e kërkuar gjatë studimeve të këtyre objekteve, por megjithatë disa metoda si Fluoreshenca e Rrezatimit X apo Spektroskopia Raman, ofrojnë mundësi për analiza jo shkatërruese, jo invazive, me ndjeshmëri të mjaftueshme dhe që mund të kryhen in-situ.

Metoda analitike që mbështeten në rrezatimin X

Rrezatimi X apo Röntgen është një formë e rrezatimit elektromagnetik me gjatësi vale në zonën nga 0.01 – 10 nanometër (energji 100 eV – 100 keV). Në spektrin elektromagnetik kjo zonë ndodhet midis rrezatimit ultraviolet (UV) dhe rrezatimit gama. Karakteristikë për rrezatimin X është fakti se ai ka energji të përshtatshme për bashkëveprimin me elektronet e shtresave të brendshme të atomeve të lëndës dhe në të njëjtën kohë ka gjatësi vale të përafërt me dimensionet e kristaleve të mineraleve të ndryshme. Këto veti të rrezatimit X përbëjnë bazën mbi të cilën janë zhvilluar një sërë metodash për të kryer analiza të ndryshme të lëndëve.

Kur një tufë e rrezatimit X bie mbi lëndë një pjesë e tufës depërton lëndën (tufë e transmetuar), një pjesë absorbohet nga elektronet e atomeve të cilët si rezultat i kësaj lëshojnë një rrezatim të tyre karakteristik (tufa e emetuar) dhe pjesa tjetër e tufës do

DO NOT COPY

të reflektohet dhe shpërhapet (tufa e difraktuar). Duke qenë se intensiteti (sasia) dhe karakteristikat energjitike të secilës tufë varen në masë të madhe nga lloji i lëndës nëpër të cilën kalon rrezatimi atëherë matja e tyre na jep informacion për karakteristikat e lëndës. Kështu, metodat e Radiografisë dhe të Tomografisë mbështeten në matjen e tufës së rrezatimit X të transmetuar nëpërmjet lëndës dhe lejojnë vrojtimin e strukturave me përbërje dhe densitet të ndryshëm që ndodhen në brendësi të lëndës. Matje e tufës së difraktuar nga lënda përdoret në metodën e Difraksionit të rrezatimit X që na lejon përcaktimin cilësor dhe sasior të përmbajtjes së strukturave kristaline minerale në lëndë. Metodat e Fluoreshencës së rrezatimit X mbështeten në matjen e tufës së emetuar nga lënda, që përbëhet kryesisht nga rrezatimi karakteristik i atomeve përbërës, dhe japin informacion lidhur me përbërjen elementare të lëndës. Në varësi të mënyrës dhe pajisjeve që përdoren për matjen e tufës së emetuar nga lënda janë zhvilluar një sërë metodash (Fluoreshenca X me dispersion energjetik (EDXRF), Fluoreshenca X me dispersion valor (WDXRF), Fluoreshenca X me reflektim total (TXRF), Fluoreshenca X me mikro tufë (mikro-XRF)) që kanë gjetur përdorime për analizën e materialeve të llojeve të ndryshme. Zhvillimet e dhjetëvjeçareve të fundit në fushën e prodhimit të tubave të rrezatimit X me fuqi të vogël dhe detektorëve që punojnë në temperaturën e dhomës ka bërë të mundur ndërtimin e sistemeve portabël EDXRF me karakteristika të krahasueshme me sistemet laboratorike por që mund të kryejnë matje në kondita fushore (in-situ).

Përdorimi i metodës së Fluoreshencës së Rrezatimit X në vendin tonë

Punimet në fushën e përdorimit të metodës së Fluoreshencës së Rrezatimit X me dispersion energjetik në vendin tonë kanë filluar në fund të viteve 1970 nga një grup i vogël kërkuesish në Institutin e Fizikës Bërthamore duke përdorur sisteme të thjeshtë të optimizuar për analizën e një elementi. Më pas, nëpërmjet disa projekteve të bashkëpunimit teknik me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) infrastruktura e laboratorit është zhvilluar si nga përgatitja e specialistëve ashtu dhe nga pajisjet që përdoren. Aktualisht në laboratorin e Fluoreshencës së rrezatimit X të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, që tani është pjesë e Universitetit të Tiranës, janë në funksionim disa sisteme të Fluoreshencës së Rrezatimit X që lejojnë studime dhe aplikime në fusha të ndryshme si gjeologjia e mineralet, metalurgjia, mjedisi, trashëgimia kulturore, etj. Sistemet EDXRF që përdorin tubin e rrezatimit X dhe radioizotope si rrezatim primar përdoren gjerësisht në laborator për analizën sasiore të mostrave nga materiale të ndryshme. Sistemi TXRF përdoret për analizën e përmbajtjes së mikro elementeve kryesisht në mostra ujore apo në mikro mostra të ngurta të marra nga objekte të ndryshme. Përbërja elementare e detajeve të imta të mostrave të ndryshme mund të studiohen me anë të sistemit mikro-XRF i cili përdor eksitimin me anë të një tufe të fokusuar (rreth 70 mikron) të rrezatimit primar. Në laborator është ndërtuar një sistem portabël EDXRF i cili përdoret për matje të objekteve të ndryshëm jashtë laboratorit (in-situ).

Përdorimi i metodës EDXRF për studimin e objekteve të trashëgimisë kulturore ka qenë një drejtim i hershem i punës së laboratorit tonë i cili ka ardhur duke u rritur sidomos gjatë viteve të fundit. Gjatë periudhës 1980 – 2000 ka pasur një bashkëpunim të herë pas hershëm me Institutin e Monumenteve të Kulturës që konkretizohej me analizat e pigmenteve në mostrat e pikturave murale apo ikonave që silleshin në laborator si dhe me laboratorin e Restaurimit të

DO NOT COPY

Institutit të Kulturës Popullore për të cilin analizoheshin mostra nga fondi arkeologjik dhe etnografik kryesisht për qëllime diagnostikimi të gjendjes së materialeve. Aplikimi i parë i rëndësishëm në këtë periudhë ka qenë ekzaminimi i pikturës "Portret i Plakut" nga fondi i Galerisë së Arteve në Tiranë e cila dyshohej se mund të ishte e vepër e Rembrandit [2] si dhe një botim mbi pigmentet e përdorura në një ikonë të Onufrit [3].

Periudha pas viteve 2000, si rezultat i rritjes së mundësive analitike të laboratorit por edhe i mundësive më të mëdha për bashkëpunim bilateral me institucione brenda dhe jashtë vendit, karakterizohet nga një zgjerim i bashkëpunimit me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Institutin e Arkeologjisë si dhe me kolegë nga universitete apo qendra kërkimore jashtë vendit. Bashkëpunimi ndërkombëtar ka qenë veçanërisht i rëndësishëm pasi duke mundësuar zgjerimin e gamës së metodave analitike të përdorura ka lejuar marrjen e një informacioni më të plotë për objektet në studim. Në bashkëpunim me kolegë nga IMK, Galeria e Arteve, Drejtoritë e Monumenteve të Kulturës në Korçë dhe Berat u ndërmorën disa veprimtari që synonin një studim më sistematik të ikonave dhe pikturave murale sipas autorëve të tyre. Kështu u studiuan në mënyrë të detajuar një grup ikonash të Onufër Qiprioitit të ekspozuara në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë [4,5] si dhe një grup ikonash të Konstantin Jeremonakut nga fondi i ikonave të Muzeut në Korçë [4,6]. Në kuadër të një projekti bilateral me kolegë nga Universiteti Aristotel i Selanikut, Greqi u studiuan pikturat murale të kishave të Shën Todrit, Berat, Shën Kollit, Shelcan dhe Shën e Premtes, Valsh me piktura të Onufrit [7] si dhe ato të kishës së Shën Triadës në Berat [8] dhe Shën Thanasit në Voskopojë [9]. Gjatë një projekti tjetër të bashkëpunimit bilateral me kolegë nga Italia janë studiuar pikturat murale të kishës "Shën Mëri Vllaherna" në Berat [10]. Rezultatet e këtyre studimeve japin të dhëna mbi materialet e përdorura (pigmente, llaci e grundi) dhe gjendjen e ruajtjes së tyre si dhe lejojnë evidentimin e ngjashmërive apo ndryshimeve midis veprave që iu përkasin periudhave e autorëve të ndryshëm.

Nëpërmjet aktiviteteve të ngjashme janë kryer disa studime të grupeve të ndryshme të objekteve arkeologjikë nga vendbanime dhe periudha të ndryshme. Të dhëna lidhur me lëndët e para dhe teknologjinë e pjekjes janë nxjerrë për grupe të ndryshme qeramikash nga vendbanime të periudhave të ndryshme, si qeramikat e Neolitit të Hershëm nga vendbanimet e zonës së Korçës [11], terakota nga Belshi [12] dhe qeramika me glazurë të periudhës Bizantine nga Durrësi [13]. Studimet e grupeve të ndryshme të objekteve prej qelqi, si qelqet e periudhës Romake nga Durrësi [14], xhama dritaresh, enë qelqi dhe tesera prej qelqi mozaikësh të shek 5-6 AD [15], enë qelqi të shek 16-17 nga Lezha [16], diskutojnë probleme të lëndëve të para të prodhimit dhe si rezultat edhe të shkëmbimeve tregtare në rajonin tonë. Objektet metalike janë studiuar nga grupe të ndryshme. Gjatë një projekti bilateral me kolegë grekë është kryer një studim mjaft i plotë i monedhave prej argjendi të thesarit të Kreshpanit, ku përfshihen koleksioni më i madh i monedhave prej argjendi të mbretit ilir Monun [17, 18]. Monedha të ndryshme prej bronzi, objekte zbukurimi, mjete pune dhe armë të ndryshme prej bakri, bronzi dhe hekuri janë përfshirë në studimet e doktoraturave të disa studenteve [19].

Në zgjerimin e bashkëpunimit si brenda ashtu edhe jashtë vendit ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe pjesëmarrja jonë në disa projekte rajonale të mbështetura nga IAEA të cilat kanë pasur si objektiv zgjerimin e përdorimit të metodave analitike bërthamore në studimin e objekteve të trashëgimisë kulturore duke u mbështetur si në krijimin e grupeve

PONTOPOLY

me specialistë nga të dy fushat brenda vendit ashtu dhe në krijimin e kushteve për bashkëpunim midis grupeve të vendeve të ndryshme. Në periudhën 2005 – 2015 IAEA ka mbështetur disa projekte në këtë fushë duke organizuar një sërë seminare dhe takime me pjesëmarrje të specialistëve nga të dy fushat gjatë të cilave janë diskutuar si probleme të metodave analitike ashtu dhe ato të restaurimit e konservimit të objekteve. Në këto takime krahas shkëmbimit të eksperiencave midis grupeve të ndryshme shpesh janë ftuar specialistë të mirënjohur të cilët kanë dhënë eksperiencat më të përparuara në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nëpërmjet përdorimit të metodave analitike. Disa kolegë nga IFBZ si dhe nga IMK e Instituti i Arkeologjisë janë përfshirë në këto aktivitete si brenda ashtu edhe jashtë vendit, gjë që ka kontribuar në krijimin e një atmosfere bashkëpunuese.

Rezultatet pozitive të punës së përbashkët kanë filluar të shfaqen në disa drejtime. Kolegët restauratorë janë ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së materialeve me të cilët ata operojnë nëpërmjet kryerjes së analizave dhe për këtë arsye kërkesat për kryerjen analizave kanë filluar të paraprijnë veprimtaritë e restaurimit në mënyrë më të rregullt se më parë. Një arritje pozitive është edhe futja e një kurrikule lidhur me metodat analitike instrumentale në degën e Arkeologjisë dhe Restaurimit në Fakultetin e Histori Gjeografisë të Universitetit të Tiranës, e cila do të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve të rinj me njohuri në këtë fushë. Nga ana tjetër disa specialistë të rinj të Fizikës dhe Kimisë janë duke kryer tezat e studimeve të Doktoraturës në fushën e studimit të objekteve të trashëgimisë kulturore. Krijimi i një brezi të ri specialistësh nga të dy fushat përbën një bazë të mirë për vazhdimësinë e aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen.

Përmbledhje e rezultateve nga studimet e ikonave dhe pikturave murale

Më poshtë do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur rezultatet e marra nga disa studime të kryera mbi materialet e përdorur në ikona dhe piktura murale të monumenteve të periudhave të ndryshme. Nga objektet e studiuar ne kemi përzgjedhur disa që mendojmë se mund të përfaqësojnë periudhat në të cilat janë krijuar. Kështu, nga ikonat e studiuara si përfaqësues të periudhës Bizantine, shek. 13 – 14, kemi përzgjedhur ikonën e Shën Spiridonit (Galeria e Arteve Tiranë) dhe ikonën "Mandili i Krishtit" (Muzeu Historik Tiranë) [20]. Ikonat e Onufrit, "Krishti Pantokrator" dhe "Hyrja në Tempull" (Muzeu "Onufri" Berat) [21], dhe ikonat "Shën Mëria me Krishtin" dhe "Pagëzimi i Krishtit" (Muzeu Historik Tiranë) atribuar Onufër Qipriotit [5] përfaqësojnë periudhën e shek. 16 – 17. Dy ikona të K. Jeremonakut, "Shën Dhimitri" e "Shën Johan Vladimiri" (Muzeu i ikonave Korçë) [6], përfaqësojnë periudhën e shek 18, ndërsa ikona "Mbledhja e Krye engjëjve" (Muzeu Historik Kombëtar) [22] duhet t'i përkasë gjysmës së dytë të shek 19. Në tabelën 1 paraqiten materialet e identifikuar gjatë studimit të këtyre ikonave të cilat janë nxjerrë nga botimet apo raportet teknike të shkruara në secilin rast, ku përfshihen fotografitë dhe pozicionet e matjeve.

Të gjitha ikonat janë pikturuar me teknikën e temperas mbi një shtresë përgatitore prej gipsi i cili është identifikuar qartë nga matjet e kryera në secilën ikonë. Në të gjitha rastet numri i pigmenteve të përdorur është relativisht i vogël dhe ata janë pigmente relativisht të shtrenjtë për kohën kur janë përdorur (okra janë përdorur pak, vetëm në përzierje për nuanca të caktuara). Përgjithësisht vihet re një vazhdimësi e përdorimit të pigmenteve me natyrë minerale për të gjithë periudhën deri në shek. 19, me përjashtim

PROOF COPY

të faktit që pigmenti i verdhë "Orpiment" (me bazë arseniku), për arsye të vetive helmuese, si në praktikën botërore, fillon të përdoret gjithmonë e më pak pas shek 16. Kështu në ikonën "Shën Spiridoni" sfondi i verdhë është përgatitur me orpiment ndërsa në të gjitha ikonat e tjera ai është përgatitur prej ari dhe orpimenti është gjetur në sasi të vogla i përzierë me pigmente të tjerë në tone të caktuara të ngjyrave. Ndryshimet që mund të vihen re në përdorimin e disa pigmenteve në ikona të ndryshme mund të lidhen me preferencat e autorëve apo mundësitë ekonomike.

Mungesa e identifikimit të pigmenteve të periudhës industriale (prodhuar afërsisht pas vitit 1850) nga njëra anë përforcon origjinalitetin dhe datimin e ikonave dhe nga ana tjetër tregon se mbi to nuk është kryer ndonjë ndërhyrje e mëvonshme.

Ikona "Mbledhja e Krye engjëjve" ka një ndërtim kompleks me ndërhyrje të ndryshme dhe është përfshirë këtu për të treguar mundësinë që ofrojnë të dhënat analitike për të ndihmuar në evidentimin e pjesëve origjinale si dhe në datimin e pikturave. Në një zonë me ngjyrë jeshile të ikonës, që konsiderohet si origjinale, është identifikuar pigmenti jeshil "Emerald Green" i prodhuar dhe përdorur në piktura pas vitit 1820 [23]. Përveç kësaj, në pjesë të gjëra të ikonës vihet re prezenca e elementeve Barium, Zink dhe Plumb që përfaqësojnë një pigment të bardhë të njohur si Litopom që gjatë shek 19 zëvendësoi pigmentin "E bardhë Plumbi" [23]. Për tu theksuar është edhe fakti se ari i përdorur për sfondin e ikonës është me karat mjaft të ulët (përqendrim i lartë i Cu e Zn) ndryshe nga ari pothuaj i pastër i ikonave më të vjetra.

Mbështetur në këto të dhëna prezenca e pigmentit "Emerald Green" vendos vitin 1820 si kufi të poshtëm të përgatitjes së ikonës, por prezenca në shumë pika e Zinkut e Bariumit e afron këtë periudhë në fund të shekullit 19 apo fillim të shekullit 20. Evidentimi më i saktë i pjesëve origjinale dhe zonave të ripikturuara si dhe materialeve përkatëse kërkon një studim më të plotë të ikonës me pajisjet FRX me mikro-tufë (Figura 1 – 8), (Tabela 1).

Tabela 1. Materialete identifikuar në ikona të periudhave të ndryshme.

Ikona	E bardhë	E verdhë	E kuqe	Jeshile	Blu	E zezë	Grund
Mandili i Krishtit Shek. 13 Anonim	E bardhë Plumbi	Ar	Kuqe Plumbi; Okër kuqe	Dhe jeshil			Gips
Shën Spiridoni Shek. 13 Anonim	E bardhë Plumbi	Orpiment	Cinabër; Okër kuqe	Orpiment + Indigo	Indigo	Karbon	Gips
Krishti Pantokrator Shek. 16 Onufri	E bardhë Plumbi	Ar; Okër e verdhë	Cinabër; Okër e kuqe	Malakit ose verdegris		Karbon	Gips
Prezantimi në tempull Shek 16 Onufri	E bardhë Plumbi	Ar; Okër e verdhë	Cinabër; Kuqe plumbi; Okër e kuqe	Malakit ose verdegris		Karbon	Gips
Shën Mëria me Krishtin Shek 17 O. Qiprioti	E bardhë Plumbi	Ar; Okër e verdhë; Orpiment	Cinabër; Kuqe plumbi; Okër e kuqe		Smalt	Karbon (kocka)	Gips
Pagëzimi i Krishtit Shek 17 O. Qiprioti	E bardhë Plumbi	Ar; Okër e verdhe; Orpiment	Cinabër; Kuqe plumbi; Okër e kuqe	Malakit ose verdegris	Indigo	Karbon	Gips
Shën Dhimitri Shek. 18 K. Jeremonaku	E bardhë Plumbi	Ar	Cinabar; Kuqe plumbi	Malakit ose verdegris	Indigo		Gips
Shën Johan Vladimiri Shek. 18 K. Jeremonaku	E bardhë Plumbi	Ar	Kuqe plumbi	Malakit ose verdegris		Karbon	Gips
Mbledhja e Krye engjëjve Shek. ? Anonim	E bardhë plumbi; Litopom	Ar (karat i ulët); Okër e verdhë; Verdhë kromi	Cinabër; Kuqe plumbi; Okër e kuqe	Emerald Green; Pigment modern	Indigo	Karbon	Gips

Tabela 1. Materialet e identifikuar në ikona të periudhave të ndryshme

DO NOT COPY

Në tabelën 2 bëhet një paraqitje e përmbledhur e materialeve të identifikuar në pikturat murale të disa monumenteve të periudhave të ndryshme, të cilat janë nxjerrë nga botimet apo raportet teknike të shkruara në secilin rast, ku përfshihen fotografitë dhe pozicionet e matjeve.

Periudha e Krishterimit të hershëm (Shek. 5 – 6) përfaqësohet nga pikturat murale të bazilikës paleokristiane të zbuluar në Elbasan në 2006 [24] dhe ato të bodrumeve të kishës së "40 Shenjtoreve" në Sarandë [25]. Për periudhën Bizantine kemi përfshirë pikturat e kishave të Shën Vangjelizmoit [26] dhe Shën Triadës në Berat [8]. Kishat e Shën Todrit në Berat, Shën Kollit në Shelcan dhe Shën e Premtes në Valsh të pikturuara nga Onufri përfaqësojnë pikturën murale të shek 16 [7], ndërsa kisha e Shën Thanasit në Voskopojë [9] dhe Xhamia e Beqareve në Berat [27] përfaqësojnë pikturat e shekujve 18 e 19.

Në të gjitha rastet shtresa përgatitore e pikturave përbëhet prej llaci me përmbajte të lartë gëlqere që dëshmon përgatitjen e tyre me teknikën e afreskut. Duhet theksuar se në disa raste, si kisha e Shën Mëri Vllaherna në Berat (që nuk është përfshirë në tabelë) dhe Shën Thanasi në Voskopojë piktura duhet të jetë përgatitur në dy faza, e para me teknikën e afreskut dhe e dyta me atë "a secco". Në llaçin e kishës së Shën Todrit në Berat janë identifikuar agregate gipsi të përzierë me llaçin që mund të dëshmojë një teknikë të veçantë të përdorur nga Onufri. Gjurmë të gipsit janë gjetur edhe në disa mostra të llaçit të kishës së Shën Vangjelizmoit.

Edhe në rastin e pikturave murale numri i pigmenteve të përdorur për të gjitha ngjyrat është i vogël. Përgjithësisht ata janë të njëjtë me pigmentet që janë përdorur për ikonat, vetëm se në pikturat murale, sidomos ato më të vjetra, predominon përdorimi i pigmenteve më të lira me bazë dherash. Kështu për ngjyrën e bardhë përdoret gjerësisht gëlqerja dhe vetëm në monumentet e shek 18 e 19 është identifikuar prezenca e të bardhës së plumbit. Po ashtu për ngjyrën e verdhë është përdorur okra e verdhë jo vetëm në sfondet e verdha por edhe për aureolat e shenjtorëve. Përdorimi i arit për këto të fundit është evidentuar në kishën e Shën Thanasit në Voskopojë. Në të njëjtën mënyrë, karboni dhe dheu jeshil janë përdorur për ngjyrat e zeza dhe jeshile në të gjitha rastet e studiuara. Karboni, i cili nuk mund të identifikohet direkt nëpërmjet metodës FRX, duhet të jetë përdorur për ngjyrën e zezë, me përjashtim të kishës së "Shën Thanasit" në Voskopojë ku është identifikuar për herë të parë përdorimi i një pigmenti të zi me bazë mangan (terra bruna). Për ngjyrën e kuqe krahas okrës së kuqe janë përdorur edhe pigmentet e kuqe plumbi dhe cinabër sidomos në monumentet pas shek 14. Pigmenti azurit është përdorur në shumicën e rasteve për ngjyrën blu, por krahas tij në disa monumente janë identifikuar edhe pigmentet më të shtrenjtë si ultramarine (lapis lazuli) dhe smalt. Është interesante të vihet në dukje se smalti i identifikuar në tri objektet e studiuar (ikona "Shën Mëria me Krishtin" e O. Qipriotit, Kisha "Shën e Premte" Valsh dhe Kisha "Shën Thanasi" Voskopojë) që mbulojnë një periudhë gati dy shekullore, duhet të ketë ardhur nga i njëjti burim. Kjo mbështetet në ngjashmërinë e elementeve gjurmë dhe të raporteve ndërelementore që përmbajnë mostrat e smaltit të analizuara. Këto të bëjnë të mendosh se burimi duhet të ketë qenë nga minierat e smaltit në Saksoni, të cilat kanë qenë burimet kryesore të smaltit në Evropë [23].

Rezultatet tregojnë se si në rastin e ikonave edhe në pikturat murale vihet re një vazhdimësi e përdorimit të të njëjtëve lloje pigmentesh për të gjithë periudhën e mbuluar nga monumentet e paraqitura. Përzgjedhja e pigmenteve të përdorur nga artistët përveç traditës duhet të jetë lidhur edhe me gjendjen ekonomike të vendit në periudhat përkatëse. Gama më e gjerë e pigmenteve dhe

DO NOT COPY

përdorimi me shumicë i disa pigmenteve të shtrenjtë në kishën e Shën Thanasit në Voskopojë është dëshmi e zhvillimit dhe nivelit ekonomik të qytetit në atë periudhë (Figurat 9 – 12), (Tabela 2).

Krahas analizave të materialeve të përdorur për pikturat murale vëmendje i është kushtuar edhe investigimit të gjendjes së ruajtjes së tyre. Në aktivitetet e kryera në kuadër të një projekti bilateral

	E bardhë	E verdhë	E kuqe	Jeshile	Blu	E zezë	Grund
Bazilika Elbasan (shek. 5-6)	Gëlqere	Okër e verdhë, Orpiment	Okër e kuqe		Azurit	Karbon	Gëlqere
40 Shenjtorët Sarandë (shek. 5-6)	Gëlqere	Okër e verdhë, Orpiment	Okër e kuqe, Kuqe Plumbi		Azurit	Karbon	Gëlqere
Shën Vangjelizmoi Berat (shek. 14)	Gëlqere	Okër e verdhë	Okër e kuqe, Cinabër	Dhe jeshil	Ultra marine	Karbon	Gëlqere; Gips
Shën Triadha Berat (shek. 14)	Gëlqere	Okër e verdhë, Orpiment	Okër e kuqe, Cinabër	Dhe jeshil	Azurit	Karbon	Gëlqere
Shën Todri Berat (shek. 16)	Gëlqere	Okër e verdhë	Okër e kuqe, Cinabër	Dhe jeshil	Azurit	Karbon	Gëlqere (gips)
Shen Kolli Shelcan (shek. 16)	Gëlqere	Okër e verdhë	Okër e kuqe			Karbon	Gëlqere
Shën e Premtja Valsh (shek. 16)	Gëlqere	Okër e verdhë	Okër e kuqe	Dhe jeshil	Smalt	Karbon	Gëlqere
Shën Thanasi Voskopojë (shek. 18)	Gëlqere; E bardhë plumbi	Ar; E verdhë plumbi; Okër e verdhe	Okër e kuqe, Cinabër	Dhe jeshil	Smalt	Karbon; Oksid mangani	Gëlqere
Xhami e Begarëve Berat (shek. 19)	Gëlqere; E bardhë plumbi	Okër e verdhë	Okër e kuqe; Kuqe plumbi; Cinabër	Dhe jeshil		Karbon	Gëlqere

DO NOT COPY

Tabela 2. Materiale të identifikuar në pikturat murale të disa monumenteve të periudhave të ndryshme

me kolegë nga Italia kemi kryer vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së ruajtjes së një skene nga piktura murale e kishës "Shën Mëri Vllaherna" në Berat duke përdorur procedurën standarde të propozuar nga autoritetet italiane të kësaj fushe (CNR). Procedura përfshin vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes nga restauratorët nëpërmjet vëzhgimit vizual të kujdesshëm, fotografimit në dritë normale, fotografimit me dritë anësore, fotografimin me dritë UV dhe IR (infra te kuqe) dhe ruajtjen e të gjithë informacionit në forme digjitale. Procesi i fundit përfshin kryerjen e analizave me metoda jo shkatërruese [11].

Në pikturat murale të kishave të pikturuara nga Onufri kemi identifikuar edhe produktet e degradimit të pikturave murale, që shkaktojnë veshje dhe zbardhje të pikturës [7, 8]. Produktet kryesore të identifikuara kanë qenë sulfate dhe oksalate që dëshmojnë degradimin për shkak të ndotjes mjedisore (prezenca e oksideve të squfurit nga mjedisi por edhe nga djegia e qirinjve) si dhe degradimin biologjik (mikroorganizma që depozitohen mbi sipërfaqe dhe prodhojnë oksalate). Përveç këtyre produkteve që janë të lidhur me sipërfaqen kemi edhe depozitime të ndryshme minerale (pluhura, blozë, etj.) të cilat mund të pastrohen më lehtë. Vëzhgimet e kryera në monumentet e tjera dëshmojnë për një situatë të ngjashme të proceseve të degradimit.

Përfundime

Metodat që mbështeten në rrezatimin X (Radiografia X, Difraksioni X dhe Fluoreshenca e rrezatimit X) përdoren gjerësisht për studimin e përbërjes dhe strukturës së materialeve nga të cilët përbëhen objektet e trashëgimisë kulturore. Mundësitë e këtyre metodave për të kryer analiza in-situ dhe pa e dëmtuar objektin konsiderohen si avantazhet kryesore të tyre.

Përdorimi i metodës XRF për studimin e objekteve të trashëgimisë kulturore është një drejtim i rëndësishëm i punës së Laboratorit XRF në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, i cili zotëron eksperiencën dhe bazën e nevojshme të aparaturave për këto lloj aplikimesh. Gjatë viteve është vendosur një bashkëpunim i frytshëm me specialistët e IMK dhe Institutit të Arkeologjisë i cili është konkretizuar në një sërë studimesh me vlerë si të objekteve të fondit arkeologjik ashtu dhe të monumenteve të ndryshëm. Rezultatet e këtyre studimeve janë të vlefshme jo vetëm për njohjen e materialeve dhe teknologjive të përdorura nga artistët artizanë por edhe për zgjedhjen e rrugëve më të mira për restaurimin e ruajtjen e tyre.

Artikulli trajton në mënyrë të përmbledhur rezultatet e fituara nga studimet e materialeve të përdorur në ikona dhe piktura murale të disa monumenteve që i përkasin periudhave e shkollave të ndryshme. Rezultatet tregojnë se në të dy rastet piktorët kanë përdorur një numër të kufizuar pigmentesh që kanë qenë të disponueshëm në periudhën përkatëse dhe përzgjedhja duhet të jetë kushtëzuar kryesisht nga situata ekonomike e vendit. Në të njëjtën kohë vihet re tendenca e piktorëve, kur ju krijohen mundësitë, për të ndjekur trendin e pikturës perëndimore edhe në përdorimin e pigmenteve të shtrenjtë por me cilësi të lartë (lapis lazuli, smalt, etj.) si dhe të produkteve të dala rishtas në treg (piktura të fundit të shek 19).

Sidoqoftë diskutimet dhe përfundimet e paraqitura më lart duhen konsideruar si orientuese pasi numri i objekteve të analizuar është relativisht i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të tyre dhe nga ana tjetër përzgjedhja mund të mos jetë më e mira e mundshme. Po ashtu studimi i pikturave murale përfshin rezultatet nga një apo dy skena të studiuara dhe jo të gjithë sipërfaqen e pikturuar të monumentit.

DO NOT COPY

REFERENCA

1. Van Grieken R., Janssens K. (eds.), *Cultural Heritage Conservation and Environmental Impact Assessment by Non-Destructive Testing and Micro-Analysis*, Balkema publishers, ISBN 90-580-9681-5 (2005).
2. Dani S., Gjeli P., *Analiza EDXRF e pigmenteve të përdorur në pikturën 'Portret i një plaku, Raport teknik*, IFB, Tiranë,1982
3. Dani S., Beci M., *Monumentet No. 2*, 169-172, (1988)
4. Civici N., Arapi M., Kallamata K., Demiraj G., Stamati F. "Të dhëna paraprake për përbërjen e pigmenteve të përdorura në disa ikona të piktorëve shqiptarë të Mesjetës", në *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*, botim i KAOSH, Tiranë, p. 325 – 340, 2003
5. Civici N., "Non-destructive identification of inorganic pigments used in 16 – 17th century Albanian icons by total reflection x-ray fluorescence analysis", *Journal of Cultural Heritage*, 7, 4, 339-343, 2006
6. Civici N., Demko O., Clark R. J. H., "Identification of pigments used on late 17th century Albanian icons by Total reflection X-ray fluorescence and Raman microscopy", *Journal of Cultural Heritage*, 6, 157-164, 2005
7. Pavlidou E., Arapi M., Zorba T., Anastasiou M., Civici N., Stamati F., Paraskevopoulos K.M., "Onoufrios, the famous XVI's Century Iconographer, creator of the "Berati School": Studying the Technique and Materials used in Wall Paintings of Inscribed Churches", *Applied Physics*, A 83, 709-717, 2006
8. Civici N., Anastasiou M., Zorba T., Paraskevopolous K., Dilo T., Stamati F., Arapi M. "Studying wall paintings in Berati castle (Albania): Comparative examination of materials and techniques in XIVth and XVIth century churches", *Journal of Cultural Heritage*, 9, 207-213, 2008
9. Pavlidou E., Civici N., Caushi E., Anastasiou L., Zorba T., Hatzikraniotis E., Paraskevopoulos K. M., "Study of Painting Materials and Techniques in the 18th Century St. Athanasius Church in Moschopolis, Albania", *in Materials Issues in Art and Archaeology VIII*, edited by Vandiver P., Casadio F., McCarthy B., Tykot R.H., Sil J.L.R. (Mater. Res. Soc. Symp. Proc. Volume 1047, Warrendale, PA, 2008), 1047-Y03-05
10. Civici N., Caushi E., Carocci I., Ridolfi S., "Ekzaminimi diagnostikues me metoda jo-shkatërruese dhe portative në pikturat murale të kishës së Shën Mërisë Vllaherna në kala, Berat", *Monumentet*, vol 52, 25 – 35, 2014
11. Ndrecka E., Gjipali I., Civici N., "Analytical investigation of pottery from different Neolithic sites in south-east Albania", *The International Physics*

DO NOT COPY

Conference (IPCT2015), FSHN, Tirana 2015
12. Civici N., "Analysis of Illyrian terracotta figurines of Aphrodite and other ceramic objects using EDXRF spectrometry", *X-Ray Spectrometry*, 36, 92-98, 2007
13. Civici N., Dilo T., Stamati F., Hoti A., "Investigation of glazed ceramic objects from Durres, Albania: Preliminary results", *Balkan Symposium on Archaeometry – "Science meets Archaeology & Art History*, 18 – 20 September 2008, Ohrid, Macedonia
14. Smit Z., Tartari F., Stamati F., Vevecka Priftaj A., Istenic J. (2013), "Analysis of Roman glass from Albania by PIXE–PIGE method", *Nuclear Instruments and Methods in Physics Research* B 296,7–13.
15. Vataj E., "*Studimi i objekteve antike prej qelqi të zbuluara në vendin tonë duke përdorur metoda analitike jo shkatërruese*", Punim Doktorature, FSHN, Tiranë, 2016
16. Smit Z., Stamati F., Civici N., Vevecka-Priftaj A., Kos M., Jezersek D., "Analysis of Venetian-type glass fragments from the ancient city of Lezha (Albania)", *Nuclear Instruments and Methods in Physics Research B*, 267, 15, 2538-2544, 2009
17. Civici N., Gjongecaj SH., Stamati F., Dilo T., Pavlidou E., Polychroniadis E. K., Smit Z., "Compositional study of IIIrd century BC silver coins from Kreshpan hoard (Albania) using EDXRF spectrometry", *Nuclear Instruments and Methods in Physics Research B*, 258, 414-420, 2007
18. Pistofidis N., Vourlias G., Dilo T., Civici N., Gjongecaj Sh., Skolianos S., Polychroniadis E. K., "An estimate of the minting method of three silver coins of the 3rd century B.C. through their microstructural study", *Physica B: Condensed Matter 405* (9), pp. 2166-2170, 2010, doi:10.1016/j.physb.2010.01.129
19. Dilo T., Civici N., Stamati F., Bilani O., Cakaj O., Duka E., Qoku E., Vangjeli Sh., "Studime arkeometalurgjike të objekteve metalike antike të Shqipërisë" – Review, *Buletini i Fakultetit te Shkencave të Natyrës*, ISSN 2305-882X, Nr. 16, p 65-74, 2013
20. Civici N. "Application of XRF techniques for the identification of pigments in albanian icons", *International Conference of the Chemical Societies of the South-East European Countries* (ICOSECS-5), 10 – 14 September 2006, Ohrid, Macedonia
21. Civici N. "Non destructive investigation of 16th century Albanian icons using a portable XRF spectrometer", *Balkan Symposium on Archaeometry – "Science meets Archaeology & Art History"*, 18 – 20 September 2008, Ohrid, Macedonia

DO NOT COPY

22. Civici N., “Rezultatet e analizave të kryera në ikonën “Mbledhja e Krye Engjëjve”, *Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë”, Raport Teknik*, 2015
23. Feller R.L. (ed), Artists Pigments: *A Handbook of their history and Characteristics*, Cambridge University Press, Vol 1-3, 1986-1994
24. Civici N., “Rezultatet e analizave të kryera në pikturën murale të bazilikës Elbasan”, *Raport Teknik*, 2007
25. Civici N., “Rezultatet e analizave të kryera në pikturën murale të kishës “40 Shenjtorët”, Sarandë”, *Raport Teknik*, 2005
26. Civici N., “Rezultatet e analizave të kryera në pikturën murale të kishës së Shën Vangjelizmoit, Berat”, *Raport Teknik*, 2014
27. Merkaj E., Civici N., “Micro-XRF investigation of the decoration materials and techniques of the “Helvetia Tekke” in Berat”, *The International Physics Conference (IPCT2015)*, FSHN, Tirana, 2015

DO NOT COPY

Prof. Dr. Niko CIVICI
Institute of Applied Nuclear Physics, University of Tirana

DO NOT COPY

X-RAYS – AN OPORTUNITY FOR THE STUDY OF ARTWORKS; OVERVIEW ON JOINT ACTIVITIES

X-rays represents one of the areas of the electromagnetic spectrum that has found widespread use in a variety of analytical techniques, which are successfully used for the study of materials. The most popular methods used for the study of materials of cultural heritage artifacts are X-ray radiography, X-ray diffraction and X-ray fluorescence in all its diverse variants. Information on the structure and composition of the materials used for artworks' manufacture, obtained through these techniques, is of great importance for the conservators and art historians because it can lead to the selection of the most suitable procedures for their conservation and restoration and can help understand the artists' mastery.

The application of X ray fluorescence (XRF) in our country started at the Institute of Nuclear Physics in late 1970. During these years, the laboratory infrastructure and the fields of application of the technique have grown and expanded. The study of materials used in paintings and wall paintings, in cooperation with IMK specialists, being one of the earliest applications of the technique, is still continuing and extended to different kind of artifacts with cultural and historical relevance.

In this paper, in addition to the presentation of several techniques that rely on X-rays and existing analytical capabilities at the XRF laboratory of the Institute of Applied Nuclear Physics, we will present the different stages of our cooperation with IMK specialists for the study of paintings, icons, wall paintings. Based on the results of several studies performed on icons and wall paintings we will also present a summary of the most important materials identified in a number of icons and wall paintings that extend from 5th to 19th century.

DO NOT COPY



Figura 1. Ikona "Mandili i Krishtit", anonim, shek. 13



Figura 2. Ikona "Shën Spiridoni", anonim, shek. 13



Figura 3. Ikona "Krishti Pantokrator", Onufri, shek. 16



Figura 4. Ikona "Hyrja në Tempull", Onufri, shek. 16

DO NOT COPY



Figura 5. Ikona "Shën Mëria me Krishtin", Qiprioti, shek. 16-17



Figura 6. Ikona "Pagëzimi i Krishtit", Qiprioti, shek. 16-17



Figura 7. Ikona "Shën Johan Vladimiri", K. Jeromonaku, shek. 18



Figura 8. Ikona "Mbledhja e Krye engjëjve", anonim, shek. ? (19-20)

DO NOT COPY



Figura 9. Fragment nga piktura murale në bodrumet e kishës "40 Shenjtorët", Sarandë



Figura 10. Fragment nga piktura murale në kishën "Shën Todri", Berat

DO NOT COPY



Figura 11. Fragment nga piktura murale në kishën "Shën Thanas", Voskopojë



Figura 12. Fragment nga piktura murale në xhaminë e Beqarëve, Berat

DO NOT COPY

monumentet
54/2016

Maksim MITROJORGJI

MORFOLOGJIA DHE STRUKTURA E HAPËSIRËS URBANE NË QYTETET SHQIPTARE

DO NOT COPY

Shpesh, në momente qetësie, bëjmë pyetjen *përse na pëlqen qyteti tradicional, përse ndihemi mirë në të, vallë është vetëm nostalgji, përse jemi të detyruar të jetojmë në struktura urbane pa jetë komunitare?*

Një përgjigje e menjëhershme mund të jetë duke radhitur pikërisht ato arsye që e bëjnë jetën të thjeshtë, në mes njerëzve që arrijmë t'i njohim e të komunikojmë, në mes të një mjedisi të njohur, të rrethuar nga shumë gjëra të vogla që i njohim, me të cilat na lidhin ndodhi të jetës sonë dhe ku e përditshmja e rëndomtë e jetës dhe peizazhit urban na krijon qetësi, rehati, siguri dhe mundësi për të kuptuar se ky qytet është yni dhe ne i përkasim atij. Pikërisht për të kuptuar këtë përkatësi me vendin, le të mundohemi të thellohemi më poshtë në dallimin e atyre cilësive që e bëjnë qytetin të jetueshëm, por, dhe të zbulojmë se çfarë kanë humbur qytetet tona nga identiteti i tyre urban dhe kulturor gjatë këtyre viteve të urbanizimit të tejskajshëm.

Në analizë do të marrim katër ndër qytetet tona kryesore, Elbasanin, Vlorën, Korçën dhe Tiranën, nisur nga situata e tyre urbane e viteve 1930-1950, kur ata mund të konsiderohen akoma struktura urbane vernakulare, të krijuara nga veprimtaria spontane e banorëve. Këtë, më tej do ta krahasojmë me situatën e sotme, ku mbi këto qytete ka vepruar planifikimi urban por dhe marrëzia e pas 1990-tës.



Fig. 1. Situata gjeomorfologjike e vendndodhjes së qyteteve Berat, Shkodër dhe Elbasan. Pozita strategjike e tyre dhe mënyra e shtrirjes në territorin përreth.

Qyteti tradicional është i ngulitur thellë dhe qëndrueshëm në mjedisin gjeografik dhe natyror të zgjedhur për ngritjen e vendbanimit. Këtë karakter "vendor" e dallojmë në çdo element të strukturës urbane. E gjejmë në rrjetën rrugore, organizimin e nyjeve urbane dhe hapësirave publike, në unitetin dhe harmoninë e peizazhit urban me atë natyror, në ekuilibret pamore apo kontrastet në siluetin e përgjithshëm. E gjejmë në modelet arkitekturore që krijon dhe materialin e vendit që përdor, por mbi të gjitha e gjejmë në **zgjedhjen e vendit të ngritjes së qytetit, në mënyrën si ai pranon zhvillimin, si zgjedh drejtimet e shtrirjes në territorin përreth dhe si zgjedh mënyrën e kapërcimit të barrierave natyrore apo infrastrukturore** (Fig. 1, 2).



Fig. 2. Plani i qyteteve Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Tiranë sipas hartave të para vitit 1950 në shkallë të krahasueshme grafike. Janë struktura urbane shumë të ndryshme e tërësisht të pakrahasueshme.

Qyteti tradicional e vernakular është kuptimplotë për banorët. Në qytetin tradicional, **bashkësia dhe**



Fig. 3. Qyteti tradicional është kuptimplotë për banorët. Struktura urbane e Elbasanit dallon për shpërndarjen uniforme të rrjetit rrugor në planin e qytetit. Rrugët krijojnë blloqe të mëdhenj banimi rrethuar në formë unazore, si dhe ka dallueshmëri të hapësirave të nyjeve urbane. Pazari zë vend në qendrën gjeometrike të qytetit.

Struktura urbane e Vlorës karakterizohet nga një rrjet i dendur në qendër dhe shumë i rrallë e i shtrirë në periferi sipas tre drejtimeve kryesore. Pazari zë vend në skajin jugor të qytetit.

Sruktura urbane e Korçës dallon për një rrjet të dendur rrugor të konceptuar në trasim të lirë dhe gjeometrik këndrejtë, blloqe e banimit janë të vegjël dhe të rrethuar unazë nga rrugët. Pazari zë vend në skajin perëndimor të qytetit.

Struktura urbane e Tiranës dallon nga rrugët e rralla, sistemi unazor është i madh, gjë që favorizon përdorimin e rrugicave qorre. Dallohen tre drejtimet kryesore të ardhjes në qytet. Pazari zë vend në qendër të qytetit.

DO NOT COPY

individi, në mënyrë të pavetëdijshme, ruajnë ndjenjën e përzgjedhjes së mënyrës së jetesës. Kjo ndodh si brenda modelit arkitekturor të banesës edhe në modelin e organizimit të strukturës urbane dhe hapësirës publike. Është rrjedhim i logjikshëm i mënyrës së tyre të jetesës në një moment të caktuar kohe apo periudhe historike. Është rrjedhojë e përvojave të gjata jetësore dhe për këtë, qyteti kthehet në mishërim të kujtesës kolektive të banorëve. Çdo strukturë urbane vernakulare e lindur nga një mënyrë e caktuar jetese ndikon mbi të po me të njëjtën forcë. Ndikon në krijimin, zhvillimin dhe ruajtjen e riteve, ceremonialit, dokeve, ndikon në përcaktimin e kodeve, ligjeve dhe simboleve vendore, dhe në përgjithësi në vendosjen dhe ruajtjen e ekuilibrave shoqërore e kulturore të bashkësisë (Fig. 3).

Qytetin tradicional e dallon struktura e hapësirës publike e përbërë nga hapësira e rrugëve, nyjeve urbane dhe shesheve, shumë e veçantë dhe kuptimplotë në secilin prej tyre (Fig. 4).

Një tjetër dallim në morfologjinë urbane të qyteteve të traditës është shkalla e urbanizimit dhe zënia e tokës me ndërtim. Çdo qytet paraqet situata dhe mënyra të ndryshme të kalimit nga qendra në periferi dhe kufiri ndarës urban/rural është i ndryshëm në secilin prej tyre. Por, një tjetër dallim mes tyre është dhe shkalla e ndryshme e hapësirës së lirë urbane, private apo publike. Shumë rrugë, urbanizim i lartë dhe dendësi ndërtimesh, japin mundësinë e të pasurit të më shumë hapësire urbane publike dhe pak hapësire urbane private, por pak rrugë kanë kuptimin e pak hapësire publike dhe shumë hapësire urbane private (Fig. 5).



Fig. 4. Struktura e hapësirës publike në qytetet Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Tiranë



Fig. 5. Struktura e ndërtimeve dhe niveli i përdorimit apo zënies së tokës në qytetetet Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Tiranë

DO NOT COPY



Qyteti tradicional, me dimensionin e tij njerëzor dhe forcën e brendshme vetë-organizuese e vetë-korrigjuese, pranon ndryshimin dhe transformimin e strukturës së tij urbane ashtu siç pranon edhe ndryshimin e modeleve arkitekturore të ndërtimeve. Është shumë më e mundshme të operohet gjatë proceseve rinovuese apo edhe zhvilluese në strukturat urbane vernakulare se sa në strukturat urbane të projektuara dhe shumë statike dhe të ngurta përballë çdo ndryshimi që kërkon koha. Ndikimi i strukturës vernakulare mbi situatën e sotme urbane të qyteteve dallon në trasimin e akseve kryesore, drejtimet e shtrirjes dhe zhvillimit të qytetit, mënyrën e kapërcimit të barrierave natyrore apo infrastrukturore, shkallën e urbanizimit dhe dëndësinë e ndërtimeve (Fig. 6, 7).



DO NOT COPY

Fig. 6. Fig. 7. Struktura urbane në Elbasan, Vlorë, Korçë mbi situatën e sotme urbane të tyre. Dallon ndikimi i strukturës vernakulare mbi strukturën e sotme të rrjetit rrugor që nënkupton forcën e brendshme të tyre për përshtatje dhe zhvillim.

Struktura urbane, arkitektura dhe jeta qytetare në qytetin tradicional janë produkt i sjelljes së njeriut këmbësor, produkt i modulit gjeometrik të largësive të përshkuara në këmbë. Kjo gjeometri e lëvizjes këmbësore frymëzon dhe koncepton: rrjetën e hapësirave publike, si pole të jetës në bashkësi por dhe shkallëzimin hierarkik të hapësirës urbane në tërësi. Hapësirat publike janë të lidhura në një rrjetë të dendur me karakter unazor, me trasim të lirë organik, ose gjeometrik. Organizimi i nyjeve, shesheve publike, hapësirave të rrjetit rrugor, dendësia e ndërtimeve por dhe mënyra se si këto ndërtime bashkëqëndrojnë ndërmjet tyre janë fenomene urbane produkt i modulit, largësi-kohë, të lëvizjes këmbësore të njeriut, aplikimi i të cilit e bën qytetin më të jetueshëm. *Qyteti tradicional lidh dhe harmonizon, lëvizjen e këmbësorëve në hapësirën urbane 'rrugë' me qëndrimin në hapësirat urbane 'nyje' dhe 'sheshe'*. Në këtë mënyrë ai i transformon këta elemente të strukturës urbane në bashkësi hapësinore publike me frekuentim të lartë, i kthen në vende marrëdhëniesh njerëzore, komunikimi dhe ceremonialesh. Hapësira urbane e rrugës së përditshme dhe e sheshit, e formuluar qartë nga ndërtimet apo elemente të tjerë urbanë, të gjendura pranë apo në mes blloqeve të banimit, trajtohen si hapësira të jashtme të banesave pra si 'hapësira urbane gjysëm private të jashtme pozitive' (Fig. 8, 9, 10).

Në qytetin tradicional dallohet shumë dukshëm ekuilibri ndërmjet lirisë dhe rregullit. Brenda shumëllojshmërisë dhe mospërsëritjes nuk



Fig. 8. Rrjeta e shpërndarjes së hapësirave publike në planin e Tiranës së vjetër, nyjet urbane dhe dimensioni këmbësor në shpërndarjen e tyre. Shumë prej tyre kanë përcaktuar nyjet e sotme urbane por duke humbur shumë nga natyra e tyre humane në shërbim të banorit këmbësor.

DO NOT COPY



Fig. 9. Elbasan
Struktura urbane e viteve 1940-'50 mbi pamjen e sotme të qytetit.
Në hartën e mbivendosur mund të dallojmë fare qartë strukturën e rrjetit rrugor të vjetër mbi situatën e sotme. Vetëm një aks i ri është hapur në mes kopshtijeve të blloqeve të banimit. Gjurmët e tjera janë mjaftuar vetëm me zgjerim e drejtim për t'ju përshtatur kohës, por shumë rrugë të brendshme ruajnë plotësisht gjendjen e tyre të dikurshme.



Fig. 10. Elbasan
Situata e ndërtimeve në vitet 1940 mbi pamjen e sotme të qytetit na ve në dukje dendësimin e ndërtimeve duke dëmtuar kopshtet që kanë qënë zemrat e gjelbëra të blloqeve të banimit.

mund të mos dallosh harmoninë dhe unitetin, pra të përbashkëtën kompozicionale, të përbashkëtën në mendim.

Është pikërisht principi i shumëllojshmërisë brenda karakterit unik të së tërës dhe lirisë brenda rregullit, që siguron identitetin morfologjik të vendbanimeve të traditës. Ky princip realizon harmoninë konceptuale, produkt i të cilës është identiteti arkitekturor, estetik dhe shoqëror i çdo vendbanimi, identiteti i peizazhit historik urban të tij, i realizuar nëpërmjet një gjuhe shprehëse urbane, arkitekturore dhe kulturore të papërsëritëshme. Kjo krijon dallueshmërinë dhe të veçantën e çdo vendbanimi në tërësinë kombëtare të trashëgimisë kulturore. E veçanta brenda karakterit të së tërës dhe liria brenda rregullit janë principe të ndikimit të ndërsjellë të psikologjisë së jetës mbi formën fizike dhe hapësinore të vendbanimit dhe nga ana tjetër e ligjeve ndërtimore në jetën shoqërore të tij. Në këtë mënyrë, peizazhi kulturor krijon atë tërësi ku ritualet, si përjetime psikologjike të paprekshme, dhe artefaktet, kuadri i objekteve të prekshëm që i mbështesin ato, janë në harmoni dhe ekuilibër (Fig. 11, 12, 13).

Rëndësi në strukturën urbane të qyteteve tradicionale marrin nyjet, të cilat në morfologjimë e kësaj strukture nuk janë vetëm kryqëzime rrugësh, por, edhe pika takimi të bashkimit të blloqeve dhe si të tilla janë më të gjalla, më komunikative. Shpesh ato janë kufij bashkues dhe ndarës të zonave funksionale të qytetit (banim-zonë ekonomike) ose pole urbane ku gjejnë vend objektet e kultit (Fig. 14, 15).

Tjetër element i morfologjisë urbane, që ka nevojë për reflektim dhe analizë është mënyra e formulimit hapësinor në elementin rrugë, ku dallon spontaniteti, e papritura, e rastësishmja. Dy janë elementet urbanistike e arkitekturore të formulimit hapësinor të rrugës në qytetin

DO NOT COPY



Fig. 11. Fragmente, në shkallë të përafërt, nga harta e qyteteve për të bërë dallimin e morfologjisë urbane dhe strukturës hapësinore të veçantë të secilit. Mundet, fare dukshëm, të bëhen krahasimet ndërmjet rrjetave rrugore të lira, organike apo gjeometrike, nyjeve urbane, madhësisë së bllokut të banimit, formës së organizimit të ndërtimeve brenda tij dhe mënyrës së grupimit të tyre, dendësisë së ndërtimeve dhe së fundi, mënyrës së formulimit hapësinor të elementit rrugë dhe shesh.



Fig. 12. Mënyra e konceptimit të lirë dhe unazor i rrjetit rrugor në qytetin e Elbasanit krijon blloqet e banimit jo shumë të mëdhej dhe me dendësi jo të madhe ndërtimesh. Më shumë dallon hapësira e lirë, e gjelbër dhe hapësira publike e strukturës së rrjetit rrugor.

DO NOT COPY



Fig. 13. Blloku i banimit, në qytetet e traditës, nxit prirjen drejt fqinjësisë, nxit komunikimin dhe ndjenjën e bashkësisë së banorëve. Blloku i banimit në Elbasan dallohet për veçorinë e tij në kompozimin perimetral të ndërtimeve, buzë rrugëve unazore, duke lënë të lirë, të gjelbër, zemrën e tij ku përgjithësisht janë kopshtijet private. Në ilustrim paraqitet: Formimi i bllokut të banimit / Bashkësia dhe lidhja e blloqeve / Struktura e hapësirës publike. Kompozimi dhe dendësia e ndërtimeve / Gjelbërimi / Organizimi dhe Formulimi i hapësirës nyje urbane.



Fig. 14, 15. Katër nyje urbane në planin e Elbasanit. Pranë qendrës ato janë të shoqëruara me shesh publik në funksion të objekteve shoqërore. Brenda zonës së banimit janë thjesht kryqëzime rrugore me potencial të fshehur për të qënë qendra shoqërore. Në aspektin e organizimit hapësinor, formulimi i tyre është spontan dhe antiperspektiv.

DO NOT COPY

e Elbasanit: godina dhe muret rrethuese të oborreve (Fig. 16, 16.1, 16.2, 17, 18).

Në studimin apo analizën morfologjike të strukturës urbane të qytetit të Korçës, rëndësi ka vlerësimi i momentit historik të shtrirjes së qytetit n**ë territore të reja rreth vitit** 1870. Gjatë këtij procesi të zhvillimit dhe shtrirjes së qytetit në territore të reja, në mënyrë shumë spontane por dhe shumë logjike u arrit



Fig. 16. Elbasan. Skema të formulimit të hapësirës urbane në elementin rrugë.







Fig. 16-1, 16-2. Peizazhi urban i Elbasanit dje dhe sot.



Fig. 17, 18. Pamje e peizazhit urban të qytetit të Korçës në dy faza të zhvillimit të tij para dhe pas vitit 1870.

DO NOT COPY

ruajtja e principeve kompozicionale të organizimit të bllokut të banimit si dhe në tërësi i morfologjisë urbane të qytetit, duke realizuar atë harmoni dhe ekuilibër morfologjik të dallueshëm dhe të veçantë për këtë qytet. Kjo u arrit nëpërmjet respektimit të shkallës së ndërtimeve, ruajtjes së principeve të organizimit të ndërtimeve brenda bllokut të banimit, respektimit të mënyrës së formulimit të hapësirave rrugë-sheshe dhe ruajtjes në tërësi të peizazhit urban. Por, në të njëjtën kohë dallojnë dhe risitë në strukturën e rrjetit rrugor ortogonal me devijime të vogla dhe zhvillimet në tipologjinë e banesës të pasuruar me elemente të kultivuar arkitekturore dekorative. Një tjetër risi është dhe pasurimi i elementëve formulues të rrugës ku shtohet rrethimi me kangjella që realizon transparencën hapësinore, vibrimin hapësinor të rrugës dhe bashkësinë e hapësirës publike me atë private (Fig. 19-31).



Fig. 19. Dy pamje ajrore të strukturës urbane të qytetit të Korçës.

Hapësira publike në qytetin tradicional ka karakter shumëfunksional e për rrjedhojë është shumë e frekuentuar. Kjo cilësi krijon tërësinë **e një strukture urbane organike, ku elementet urbane janë në unitet të plotë funksional.** Uniteti i të gjithë faktorëve kompleksë që përcaktojnë lindjen, rritjen, transformimin dhe jetën e përditëshme urbane shtrihen në çdo nivel të organizimit të strukturës urbane të qytetit tradicional, që nga struktura e qytetit si e tërë, deri tek blloku i banimit, grup banesat dhe arkitektura e secilës prej tyre.

Ky unitet kompleks i faktorëve shoqërorë, teknikë dhe kulturorë të jetës, është pikërisht ai që i



Fig. 20. Fragment i strukturës urbane në lagjen e vjetër të qytetit të ndërtuar para vitit 1870. Duke filluar nga sipër majtas: Fragment nga harta e qytetit 1937, situata e ndërtimeve, struktura e rrjetit rrugor, struktura e hapësirës publike, hapësira e lirë dhe intensiteti i zënies së tokës me ndërtim.

DOKTORATURA





Fig. 21, 22. Foto të rrugicave të qytetit në lagjen e vjetër.



Fig. 23. Fragment i strukturës urbane në lagjen e qytetit të Korçës të ndërtuar pas vitit 1870. Duke filluar nga sipër majtas: Fragment harta e qytetit 1937, situata e ndërtimeve, struktura e rrjetit rrugor, struktura e hapësirës publike, hapësira e lirë dhe intensiteti i zënies së tokës me ndërtim.

DOKTORATURË



Foto 24, 25. Foto të rrugicave të qytetit në lagjen e re, ndërtuar pas vitit 1870



Fig. 26. Skema krahasuese të organizimit të ndërtimeve brenda bllokut të banimit në lagjen e vjetër dhe të re të qytetit të Korçës

DO NOT COPY



Fig. 27. Skema krahasuese të strukturës së hapësirës publike dhe rrjetit rrugor në lagjen e vjetër dhe lagjen e re të qytetit të Korçës. Dallon hapësia publike "nyje urbane" dhe karakteri unazor i rrugëve rreth bllokut të banimit si dhe efekti i diagonales që e afron lagjen e re me morfologjinë e së shkuarës. Ngjashmëria morfologjike është më se e plotë pavarësisht ndryshimeve në trasimin e rrjetit rrugor, i lirë dhe më organik në lagjen e vjetër dhe gjeometrik e drejtkëndor në lagjen e re.



Fig. 28. Ngjashmëri morfologjike e organizimit të ndërtimeve brenda bllokut të banimit dhe mënyrës së formulimit të hapësirës publike, rrugës dhe nyjeve, në dy skemat e rrjetës së strukturës urbane të qytetit.



Fig. 29. Organizimi i hapësirës private me përdorim publik rreth objekteve të kultit. Katedralja ortodokse dhe xhamia e Mirahorit. Hapësira urbane pranon dhe bën pjesë të saj hapësirën private me funksion publik të objekteve të kultit dhe jo në pak raste edhe hapësirën private të njësive të banimit.

DO NOT COPY



Fig. 30. Në qytetin e Korçës, formulimi hapësinor i elementit "Rrugë" realizon bashkëpunimin e hapësirës publike me hapësirën private të oborreve. Në lagjen e re, si element i formulimit të rrugës shtohet kangjella metalike dekorative dhe transparente. Ky koncept dominon në këtë lagje e bllok banimi. Kjo është veçanërisht e dukshme në Bulevardin "Republika", arteria kryesore e lagjes së re. Në këtë rast, hapësira urbane fiton vibrim anësor nëpërmjet mos pasjes së efektit korridor dhe mos ekzistencës së vijës së detyrueshme të ndërtimit.

mungon urbanistikës moderne, që ka si parim themelor ndarjen apo zonimin funksional. Ky parim mund të lehtësojë punën e planifikuesit urban, kur organizon zonën e qendrës, zonat e banimit, zonat e shërbimeve, zonat ekonomike e prodhuese, zonat e gjelbërta e çlodhëse, kategoritë e ndryshme të lëvizjes e transportit etj. por, nuk ndihmon në shkrirjen në një të tërë organike të elementëve që formojnë objektin urban.



Fig. 31. Krahasim i strukturës morfologjike të bllokut të banimit në të katër qytetet e marrë në analizë. Të përbashkëtat dhe ndryshimet dallohen: Në formën e bllokut, madhësinë e tij, mënyrën e kompozimit të ndërtimeve brenda tij, formën dhe madhësinë e parcelës së ndërtimit, raportet qendër/periferi në konceptimin e bllokut të banimit, në dendësinë e ndërtimeve dhe shkallën e urbanizimit dhe së fundmi në shkallën e formulimit hapësinor të elementit rrugë.

Në vend të mbylljes

Siç pamë nga ilustrimet e paraqitura, urbanistika e qytetit tradicional, apo vernakular, nuk është problem stilesh. Asgjë nuk është e paracaktuar. Pikërisht kjo na tregon dëshirën e qytetit për identitet, ndryshim dhe përshtatje. E kundërta ndodh me urbanistikën moderne, e cila gjatë planifikimit e kategorizon strukturën urbane në: organike, racionale, kompozicionale monumentale, gjeometrike etj. Gjithë këto tregojnë vënien në plan të parë të koncepteve planifikues formalë, që nuk lidhen me logjikën e brendshme të objektit urban. Tregojnë se kemi kaluar nga qyteti për t'u jetuar në qytetin e

DO NOT COPY

makinave dhe presim të kalojmë në qytetin e varianteve të sugjeruar nga programet kompjuterike.

Qyteti tradicional që kemi trashëguar na tregon kudo se e pranon të renë, si në rinovim dhe transformimin e strukturës urbane, ashtu edhe në arkitekturë. Duhet vërtet shumë pak dedikim dhe kujdes për të dalluar principet që i dhanë atij këtë vitalitet e jetëgjatësi. Këto principe të përgjithshme që dalluam në këtë kumtesë mund të shërbejnë për një punë planifikuese e rinovuese të strukturave urbane me synimin e krijimit të qytetit për njeriun, të qytetit me fytyrë bashkëkohore.

Ajo çka vërehet sot është fakti se modelet urbanistike dhe arkitekturore, moderne dhe tradicionale, janë shumë larg njëri tjetrit. Mjedisi i sotëm inovativ e teknologjik vështirëson, në mos e shkatërron, çdo mundësi për transmetimin e ideve dhe përvojave, zbulimeve apo vlerave që dallohen nga analizat që kryhen mbi trashëgiminë vendore. Ky fenomen para së gjithash kufizon krijimtarinë në rrugën drejt një planifikimi urban të qëndrueshëm, të lidhur me vlerat lokale, por më tepër me trashëgiminë dhe identitetin shoqëror e kulturor. Përvoja vendore është siguri e nivelit të lartë për sukses krahas përqafimit të të rejave të teknologjisë bashkohore.

Por, themeli i urbanistikës vernakulare, i asaj që ne kemi trashëguar në qytetet tona mund të përmblidhet në pak principe bazë për t'i patur si udhërrëfyese:

- **Çdo qytet ka dhe duhet të ruajë identitetin e tij urban;**
- **Çdo qytet ushqen tek banorët e tij ndjenjën e përkatësisë me vendin;**
- **Çdo qytet krijon dhe kërkon të ruajë cilësi të dallueshme arkitekturore;**
- **Çdo qytet zotëron trashëgimi të dallueshme shoqërore e kulturore**.

Pikërisht këto principe bazë rrezikohen sot. Klasikët e arkitekturës moderne u mbështetën te trashëgimia vernakulare, modelet e të cilës i gjetën edhe në arkitekturën e Mesdheut. Ata ndërtuan ide që përfaqësojnë plotësisht vlerat që dallojnë arkitekturën dhe urbanistikën vernakulare. Ata dalluan dhe vlerësuan: *vlerat fizike dhe estetike të materialit, vërtetësinë strukturore të ndërtimit, minimalizmin funksional dhe ekonomik, projektimin modular, përshtatjen me mjedisin dhe kontekstin, pjekurinë kohore të veprës, elasticitetin apo pranimin e ndërhyrjeve të mëvonëshme në vepër, hapësirën e shkallës njerëzore, identitetin dhe karakterin organik të strukturave urbane tradicionale, ekuilibrin ndërmjet lirisë dhe rregullit, përshtatjen dhe lidhjen organike me vendin, mënyrën e organizimit të bllokut të banimit, tipologjitë e shumta të banesës duke i konsideruar reflektuese të mënyrave të ndryshme të jetesës etj. etj.*

Janë principe të përgjithëshme, jo kufizuese të krijimtarisë, të njëjta me ato që ka aplikuar ndër shekuj krijimtaria pa autorë, ku tipi nuk është model për t'u përsëritur, por filozofi lokale, kombëtare apo rajonale për të frymëzuar, ku fiton logjika e krijimit të formës dhe jo e kundërta.

Sot, për fat të keq, në brezin e tretë të projektuesve modernë është mohuar pikërisht themeli mbi të cilin u ngrit arkitektura modern, duke rënë tërësisht në 'akademizëm modern' fenomen i ngjashëm me 'akademizmin neoklasik', që u mohua në fund të shek. XIX–të nga krijuesit e arkitekturës modern, në emër të së resë që duhet të vinte.

DO NOT COPY

Maksim MITROJORGJI

DO NOT COPY

MORPHOLOGY AND STRUCTURE OF THE URBAN SPACE IN THE ALBANIAN TOWNS

Often, in moments of silence, we ask the question why do we like the traditional city, why do we feel comfortable in it, is it only nostalgia, why are we obliged to live in urban structures without community life? So, in order to understand this belonging to the *place*, let's discover what our cities have been losing from their urban and cultural identity along these years of extreme urbanization.

Let us analyze four Albanian cities, such as Elbasan, Valona, Korça and Tirana, starting from their urban situation between 1930-1950.

The traditional city is deeply and constantly embedded in the geographic and natural environment chosen to raise a settlement. We find it in the architectural models that it creates and in the local materials that it uses, but most of all we find it in the site selection for the raise of the settlement, in the way that it embraces development, how it chooses to expand its surroundings and how it chooses to overcome the natural and infrastructural barriers.

The vernacular city, is meaningful to its citizens. In the traditional city, **community and the individual, unconsciously, preserve the feeling of the selection of the way of life.**

Another difference in the urban morphology of the traditional cities is the scale of urbanization and the use of land. Every city presents situations and different ways of overpassing from the center to the suburbs and the urban/rural separator is different in each of them.

The traditional city, with its human dimension and the inner self-organizer and self-corrective strength, accepts change and transformation in its urban structure as well the change of the architectural models of the buildings.

Urban structure, architecture and the citylife in the traditional city are product of the pedestrian behaviour, product of geometric model of the distances traversed by foot.

The traditional city connects and harmonizes the pedestrian movements in the urban space "the Street, with the standstill in the urban space "junction" and "squares".

In the traditional city, the equilibrium between freedom and order is easily distinguished. Within diversity and non-repetition we can distinguish the harmony and the unity, meaning the common compositional characteristics and common thinking. **It is exactly the prínciple of diversity within the unic character of the hole and freedom within order, that**

ensures the morphological identity of the traditionl settlements.

In the study of the urban structure of Korça, the historic moment of the city extension in new territories in the 1870's that is important in the moment of evaluation. During this process of development, in a very spontaneous and logic way, they achieved the preservation of the compositional principals of the residential block and of the urban morphology of the city, realizing the morphological harmony and equilibrium unique for every city.

The public space in the traditional city, has a multifunctional character and consequently very frequented. This value creates the hole of an **organic urban structure where the urban elements are in functional unity.** The unity of all the complex factors that establish the birth, the growth, the transformation and the everyday life expands in all the levels of the organization of the urban structure in the traditional city, from the city structure to the residential block, to the houses and to the architecture of each one of them.

The complex unity of the social, technical and cultural factors, is what is missing in the modern urban structures that has as its principle the separation or the functional zoning.

The inherited traditional city shows us that it accepts new interventions, in renovation, in the transformation of the urban structure, as well as in architecture. All it lacks of is a little more dedication and care to distinguish the principles that gave vitality and longevity to them.

The roots of the vernacular urbanization, of what we have inherited in our cities can be resumed in few principles as follow: *everycity has and has to preserve its own urban identity; every city feeds its citizens with the feeling of belonging; every city creates and seeks to conserve its own architectural characteristics; every city has a destinguished social and cultural legacy.*

But nowadays, unfortunately, in the third generation of modern designers, we have refused the basic foundation on which raised the modern architecture falling into "modern academism", a similar phenomenon with "neoclassic academism" that was denied in the end of the 19th century from the creators of modern architecture in the name of future.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Prof. Asoc. Dr. Armand VOKSHI
Universiteti Politeknik
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

DO NOT COPY

VLERAT ARKITEKTURORE DHE EVOLUCIONI I OBJEKTEVE TË BANIMIT NË TIRANË, 1930-1960

"Fizionomia e një qyteti, e një shteti, e një kombi nuk i jepet prej atyre pak veprave të veçanta, por prej atyre shumë e shumë të tjerave që kritika historike i klasifikon si "arkitektura minore", të cilat janë më pak të lidhur me kërkesat e qëllimit të përfaqësimit, më shumë të nënshtruara nga limitet ekonomike dhe nga modestia e atyre që nuk duan të kalojnë në kotësi." [1]

Giuseppe Pagano

Kjo thënie e arkitektit italian, i cili kulmonte me punën e tij teorike e praktike në vitet '30 e '40 të shekullit të shkuar në studimin e fizionomisë së qytetit evropian, është mjaft domethënëse e kuptimplotë edhe për qendrat urbane shqiptare. Në realitet, përgjatë gjysmës së parë të shekullit të shkuar, janë kryer mjaft studime interesante mbi pëlhurat urbane dhe shtesëzimet e qyteteve, të cilat e shpërbënin dhe e diferenconin atë në dy pjesë: në elementë të arkitekturës minore dhe në elementë të arkitekturës kryesore. Këto të fundit konsiderohen ato vepra të ekselencës me veçanti estetike, funksionale e volumore, subjekte admirimi e reference, të domosdoshme për vetë qytetin, qytetarët e vizitorët e ndryshëm të qyteteve. Por, sipas Paganos dhe autorëve të tjerë, këto vepra të ekselencës mbështillen nga një masë e konsiderueshme objektesh, të cilët ata i grupojnë si arkitektura minore, ku të ndërtuara shpesh pa arkitektë dhe të lëna në hije prej të parave, ato kanë si funksion kryesor banimin. Megjithatë, fizionomia e qytetit, sipas Paganos, nuk jepet prej të parave siç edhe shumë e deklarojnë, por jepet sidomos prej kësaj mase të shtresëzuar në kohë të ndryshme, që lidh në mënyrë direkte memorien historike e sentimentale të individit me qytetin e tij. Janë ato që i japin vlerat e përhershme e të patjetërsueshme qytetit për njerëzit që e jetojnë dhe për ata që e vizitojnë. Janë po ato që i japin një identitet individual e të veçantë nga qëndrat e tjera. Për këtë është mjaft e rëndësishme evidentimi e konservimi i tyre, për të kuptuar e gjeneruar kodin e tij gjenetik urban, që ndoshta edhe është modifikuar me kohën, por edhe për t'iu përshtatur asaj gjithsesi e gjithmonë me trajta të reja, në mes të indit urban eksiztues.

Qytetet shqiptare e sidomos Tirana, pas shpalljes së saj kryeqytet, i janë nënshtruar një evolucioni të vrullshëm duke filluar nga vitet njëzetë e në ditët tona. Ndërthurja e arkitekturës kryesore me atë minore, deri në momentet e viteve njëzetë, përshtjellohej vetëm në disa objekte kulti të përmasave mesatare e modeste të të tre religjioneve kryesore, të shpërndara në mënyrë

tërësisht të paplanifikuar në territor dhe një masiviteti objektesh banimi një apo dy katëshe, që në shumicën e rasteve ishin derivat i një arkitekture vernakolare pa arkitektë. Kjo lloj arkitekture që mbështetej në traditën estetike, funksionale e konstruktive të mjeshtrave lokalë, që kishin arritur të ndërtonin shpesh edhe objekte banimi me vlera të veçanta, gjithnjë duke u mbështetur në tiparet e thella të një arkitekture otomane, orientale apo edhe ballkanike. Ajo vinte nga një influencë e fortë dhe e pakontestueshme, pas shekujsh dominimi nën perandorinë osmane.

Rasti i Tiranës mund të paraqitet si shembulli më i plotë i transformimeve të forta urbane e arkitektonike i një qendre urbane shqiptare, duke filluar nga trajtat e konfigurimit tipik oriental drejt gjendjes së tyre urbane aktuale. (Fig. 1) Nga pikëpamja historike, Tirana u zgjodh si kryeqytet i Shqipërisë në fillim të viteve njëzetë. Kjo u shoqërua edhe me një emigrim të vrullshëm demografik drejt saj, që në fakt nuk ka arritur të ndalet as në ditët tona. Zhvillimet urbane, sigurisht u shoqëruan në etapa të ndryshme me disa ndryshime radikale në mënyrën e konceptimit dhe konfigurimit të arkitekturës minore, të cilat ishin të ndryshme nga zhvillimet e ngadalta e monotone të mëparshme, të para deri në vitet njëzetë.

Tre janë momentet kryesore që vlejnë të përmenden nga pikëpamja e ndryshimeve arkitektonike të objekteve të banimit dhe që përkojnë edhe me epoka të rëndësishme historike të zhvillimeve të përgjithshme në Shqipëri:



Fig. 1. Planimetria e gjendjes ekzistuese e qytetit të Tiranës, viti 1917 (Arkivi Qendror i Ndërtimit)

DO NOT COPY

a) **Periudha midis viteve 1920-43 me zhvillimet e reja të tipologjisë me vila monofamiljare/bifamiljare për nënpunësit e shtetit të ri dhe për familjet "në gjendje të mirë ekonomike";**

b) **Periudha midis viteve 1939-43, gjatë pushtimit fashist, me projektimin e njësive të para shumëfamiljare për ushtarakët dhe nënpunësit italianë;**

c) **Periudha pas viteve 1950, me vendosjen e sistemit komunist, me njësite e reja masive të banimit për «njeriun e ri».**

Ndryshimet nga njëra tjetra si dhe në raport me arkitekturën e para viteve njëzetë në Tiranë janë shumë evidente në mjaft drejtime. Ndoshta prej trysnisë së kohës apo me hapjen mentale ndaj ndryshimeve arkitekturore evropiane prej arkitektëve të huaj e shqiptarë që ishin formuar në universitetet jashtë Shqipërisë, periudhat e këtyre fazave të vonuara në Shqipëri, edhe pse shumë pranë njëra-tjetrës, janë shumë intensive e të ndryshme nga njëra-tjetra.

Për të treja këto faza, përveç diferencave së tyre të thella që ato kanë nga njëra tjetra, të cilat do të shtjellohen fazë pas faze pak më poshtë, ato kanë edhe elemente përbashkues me njëra-tjetra. Këto elementë përbashkues janë:

1. Ndryshim i mënyrës së jetesës kohë pas kohe në ato vite dhe e mentalitetit të ri në raport me objektet e ndërtuara më parë;
2. Konceptim i ri sipas gjuhëve të reja arkitekturore të godinave të kësaj periudhe kundrejt asaj paraardhëse;
3. Shpërndarje të reja funksionale – distributive në raport me periudhën paraardhëse;
4. Teknologji të reja të ndërtimit, skemave strukturale dhe sidomos të përdorimit të materialeve të ndërtimit.

Vilat monofamiljare/bifamiljare të ndërtuara në vitet 1920 – 1943

Duke iu rikthyer periudhave të sipërpërmendura, ndryshimi i madh nis me vilat e reja monofamiljare/bifamiljare të ndërtuara në vitet 1920 – 1943, gjatë periudhës së Monarkisë Zog dhe gjatë pushtimit italian. Me gjithë fluksin e madh demografik drejt kryeqytetit të ri, krahas arkitekturës vernakolare të mjeshtrave lokalë **të parë deri në atë kohë**, me shpejtësi iu bashkëngjitën edhe vilat e reja, objektet e banimit dhe të shërbimeve diplomatike me arkitektura mjaft interesante të projektuara nga arkitektë shqiptarë, italianë e austriakë. (Fig. 2)



Fig. 2. Pamje të qytetit të Tiranës para zgjedhjes së tij kryeqytet. (Arkivi Marubi)

DO NOT COPY

Me planin e dytë rregullues të Kohler-it, Frashërit dhe Di Faustos[2,3] të vitit 1928-30 dhe ate të Bosios[4,5,6] të **vitit 1939-1941**, definoheshin pjesët e reja ekspansive të qytetit të Tiranës, që në disa raste kompletonin zonat ekzistuese buzë rrugëve kryesore apo edhe zonat e reja siç ishin: zona e "Tiranës së Re" apo zona midis rrugës së Elbasanit e bulevardit të ri. Vilat e reja apo ndërtimet në përgjithësi, për herë të parë i nënshtroheshin proceseve legale të marrjes së lejes së ndërtimit mbi bazat e një projekti arkitekturor e inxhinjerik.

Kërkesa për të projektuar hapësira të reja për një banim modern, në raport me kërkesat e reja shoqërore të kohës, solli edhe lindjen e problematikave të reja të lidhura me ndërtimin dhe projektimin e tyre mbi bazën e principeve e ideve të reja. Rinovimi arkitektonik, në raport me atë që ishte normalitet shekullor në sytë



Fig. 3. Fragmente fasadash dhe detajesh të vilave të ndërtuara në qytetin e Tiranës gjatë periudhës 1925-1943



Fig. 4. Planimetria e gjendjes ekzistuese e qytetit të Tiranës me pjesët ekspansive të vilave të reja, viti 1937 (Arkivi Qëndror i Ndërtimit)

e shqiptarëve, duhej parë pra edhe nga pikëpamja teknike: arkitektura si sintezë midis pjesës teknike dhe asaj estetike, e identifikuar në terma të reja të nevojës, abstraksionit dhe koherencës. (Fig. 3) Moria e informacionit që vinte nga zhvillimet e arkitekturës evropiane influencuan drejtime të ndryshme në mënyrën e të projektuarit të tyre, ku ana gjuhësore akitekturore e ndërtimore nuk shihej nga pikëpamja ideologjike apo kulturore e sociale. Të gjitha stilet ishin risi në vend pasi deri në atë kohë i kishin munguar panoramës arkitekturore të qytetit. Nga ana e organizimit volumetrik ato ishin vila relativisht prestigjoze në raport me atë çka shihej edhe nëper Evropë dhe planimetritë e këtyre objekteve janë të mirëorganizuara për një shtresë të pasur njerëzish. (Fig. 4)

Rrugët e Tiranës u kthyen në pasarela stilesh ku mund të dalloheshin qartë këto tre stile arkitekturore:

-Objekte të stilit neoklasik apo eklektik;

-Objekte të stilit racionalist;



Fig. 5. Pamje nga vila Libohova (1930), nga Legata Italiane (1930), nga Legata Turke (1931) dhe nga Shtëpia e Oficerëve (1933-34) (Arkiv Privat)

DO NOT COPY

-Vila tradicionale ose me përzierje stilesh.

Objektet e stilit neoklasik janë të përhapura nëpër zona të ndryshme të Tiranës dhe disa prej tyre janë: Vila Libohova (1930) në rrugën e Durrësit, ish Legata Turke (1931), ish Legata Italiane (1930), Shtëpia e Oficerëve (1934-35), vila e cila më pas u kthye në Muzeun Lenin-Stalin (1930), Vila Luarasi (1931), ish Legata çekosllovake në pronësi të F. Alizoti (1930) etj. Ato paraqiten me vlera të larta dekorative dhe volumore si përfaqësuese të gjuhëve të ndryshme brënda stilit neoklasik. (Fig. 5)

Ndërkohë, me interes paraqiten edhe vilat racionaliste e moderne siç mund të përmendim: Vila e Princeshës Sanije (1926-30), Vila Fortuzi (1930), Vila Dr. Simonidhit (1932-33), Vila e Shoqërise Straccioli & Fortuzi (1930), Godina Kërçiku tek Pazari i Ri (1935) etj. (Fig. 6) Arkitektura e përdorur në këto raste tenton të përfaqësojë atë, që në qytetet e rëndësishme evropiane kishte kohë që kishte nisur, mentalitetin e kohës së re. Në Evropë ajo dallonte nga pjesa neoklasike për shkaqe të forta ideologjike e morale arkitektonike, funksionale, teknologjike dhe në përdorim materialesh e pse jo edhe për ekspresivitetin e shoqërisë moderne. Ndoshta në Shqipëri e gjitha kjo më shumë përfaqësonte shijet bindëse të arkitektëve që i projektonin, sesa bindjet moderne të pronarëve shqiptarë porositës. Në rastin e vilës së Princeshës Sanije vërehet përveç lojës volumore racionale që akitekti austriak Kohler realizon në projektin e tij, ai kombinon një veshje interesante me pllaka të cilat janë të stampuara me motive floreale të tipit Jugendstil. Ndërkohë që tre të tjerat e sipërpërmendura, përveç lojës puriste volumore, kanë një trajtim në epidermë mjaft origjinal me tulla dekorative në fasadat e tyre, të kombinuara me pjesën e strukturave në dukje.

Pjesa e tretë e vilave përfaqësohet nga ato objekte me vlera të veçanta arkitekturore, të cilat në anën e tyre estetike kanë një rend të artikuluar jo qartë stilistik, por një përzierje elementësh të gjuhëve të ndryshme arkitektonike. Disa prej tyre janë : Vila Serreqi (1930),



Fig. 6. Pamje nga Vila e Princeshës Sanije (1926-30), Vila Fortuzi (1930), Vila Dr. Simonidhit (1932-33) dhe Vila e Shoqërisë Straccioli & Fortuzi (1930), (Arkiv Privat)



Fig. 7. Pamje nga Vila Nepravishta (1930), Rr. Hoxha Tahsin (1929-37) , Vila (Gjuta) 1930 , Vila Serreqi (1930), (Arkiv Privat)

DO NOT COPY

Vila Nepravishta (1930) , Vila e Dr. Bashos (1930), shumica e objekteve të ndërtuara në atë kohë në dy anët e rrugës Hoxha Tahsim, Tirana e Re etj. (Fig. 7) Kjo lloj tipologjie zë një vend të konsiderueshëm në ndërtimet e bëra në atë kohë në Tiranë e sasia e këtyre vilave është tejet e madhe. Ndoshta vetëkuptohet fakti që në vend mungonte një debat i fortë mbi teknikat e stilet tashmë të definuara në vendet e tjera, gjë që vinte si pasojë e prapambetjes historike të Shqipërisë.

Gjithsesi, nga pikëpamja e evolucionit të përgjithshëm kemi një progres të dukshëm në pak vite. Edhe nga pikëpamja kostruktive dhe e përdorimit të materialeve shohim një ndryshim rrënjësor nga çfarë ishte ndërtuar deri në atë kohë. Futja e elementëve të betonit dhe tullës, stukove të ndryshme, përdorimit të mermerëve e materialeve teknologjikë do të ndryshonte llogjikën e ndërtimit me teknikat e qerpiçit, gurit apo dhe teknikave të vjetra. Sasia e vilave ishte mjaft e madhe dhe duke qenë se këto shoqëroheshin me oborr përreth, sipërfaqja e qyteti të Tiranës u zmadhua në pak vite për shkak të kësaj tipologjie.

Njësitë e para shumëfamiliare për ushtarakët dhe nënpunësit italianë në vitet 1939-43

Gjatë viteve të pushtimit fashist, Tirana u studiua nga Gherardo Bosio në mënyrë integrale në Planin Rregullues të qytetit dhe përveç ideve interesante të zonifikimit të qytetit, sistemit unazor e koncentrik te qarkullimit, futjes së konceptit të "qytetit kopësht"etj, një element i rëndësishëm do të ishte edhe ndërhyrja në qytet në të ardhmen me objekte shumëfamiljare të banimit, që përbënte një risi në kornizën urbane e arkitektonike të qytetit. (Fig. 8) Sipas Bosios, edhe pse kjo gjë dukej e pamundur në atë kohë për vetë organizimin e mënyrës së jetesës së shqiptarëve, në të ardhmen jo shumë të largët, qytetarët e Tiranës do të organizoheshin në objekte shumëfamiljare të



Fig. 8. Fragment i maketit të qytetin së Tiranës i realizuar nga G.Bosio ne vitin 1939-40 (Arkivi Bosio)

shpërndara nëpër pjesë të ndryshme të qytetit. Ky do të vinte si rezultat i emancipimit të qytetarëve, i ndryshimit sipas kërkesave të kohës dhe si derivat i kostos më të vogël që do të kishte ndërtimi i tyre. Për shembull, në propozimin e projektit për transformimin të madh të sheshit Skenderbej, Bosio mendonte që objektet shumëfamiljare të banimit, duhet të ishin objekte lineare të vazhduara përgjatë rrugëve kryesore të organizuara me disa elementë kompozitivë të përsëritshëm. Ato do të shërbenin si silueta të reja të rrugëve kryesore e do të fshihnin gjatë fazës së gjatë të tranzicionit ambientet e brendshme të kuartalleve, deri në rinovimin përfundimtar të qytetit.

Të parat objekte që u ndërtuan ishin disa pallate tre katëshe që ishin organizuar nga ana urbanistike që në planin rregullues në zonën e Tiranes së Re. Ato u dedikuan për familjet e nënpunësve dhe të ushtarakëve italianë të cilët operonin në Shqipëri. Katër prej tyre të vendosura në mënyrë pingule me lumin e Lanës, (Fig. 9) të projektuara në maj të vitit 1940, morën emrin "Shtëpit e Nënpunsave" ndërsa të tjerat e organizuara në

DO NOT COPY



Fig. 9. Planimetria e kompleksit të banesave të nënpunësve buzë lumit Lana si dhe plani i katit përdhe, viti 1941 (Arkivi Qendror i Ndërtimit)

zonën e ish-Bllokut ishin lënë për familjet e ushtarakëve e nënpunësave. (Fig. 10) Në dukje ato paraqesin një arkitekturë funksionaliste racionale të thjeshtë, e cila mbështetet mbi disa planimetri me ambiente dinjitoze banimi. Apartamentet ishin të bollshme, me dhoma me hapësira të gjëra, ku në çdo shkallë ndodheshin 1 ose 2 apartamente. Ndërkohë që në arkiva ekzistojnë edhe objekte të tjera të realizuara nepër periferitë e Tiranës për familjet e punëtorëve të specializuar italianë, të cilët kishin ardhur për të punuar në Shqipëri në ato vite.

Projekti më ambicioz në këtë periudhë, përsa i



Fig. 10. Planimetria e kompleksit të banesave të nënpunësve në zonën e ish "Bllokut", plani i katit përdhe të një objekti dhe foto e gjendjes ekzistuese, viti 1941 (Arkivi Qendror i Ndërtimit)

perket banesave shumëfamiljare, është projekti *"Nuovo Edificio Abitazioni della B.N.A."* (Ndërtesa e Re e Banimit e B.K.Sh.) i Vittorio Morpurgos [7], arkitektit të Bankës Kombëtare. (Fig. 11) Ai u projektua në korrik të viti 1943 e nuk u realizua për shkakun se pak më pas Italia u tërhoq nga territoret shqiptare. Ky objekt u projektua për drejtuesit e Bankës Kombëtare dhe duhej të ishte mjaft cilësor si nga pikëpamja e organizimit të hapësirave të brendshme ashtu edhe nga konfigurimi volumor arkitektonik. Ai ishte një objekt i shtrirë në formë E-je e pozicionohej në jug të bankës, duke u lidhur me godinën e Parlamentit të Vjetër, e do të shërbente si një kuintë skenografike për godinën ekzistuese të bankës. Objekti, i cili fillonte me katër e mbaronte me gjashtë kate, kishte një gjatësi prej 67

DO NOT COPY



Fig. 11. Planvendosja e objektit të banesave të nënpunësve të Bankës, plani i katit përdhe dhe pamja ballore e godinës, korrik 1943 (Arkivi Qendror i Ndërtimit)

m dhe si në veshje ashtu edhe në trajtimin e çarjeve krijonte një harmoni evidente me objektin e bankës.

Njësitë e reja të banimit për «njeriun e ri» pas viteve 1950

Pas luftës, me vendosjen e diktaturës së komunizmit, tendenca e organizimit urban të qyteteve ndryshoi totalisht në raport me zhvillimet përpara viteve dyzet e pesë. Urbanistika dhe arkitektura i shërbyen regjimit komunist si instrumente efikase në plazmimin e konceptit të "njeriut të ri". Ky koncept nënkuptonte: së pari, barazinë sociale dhe ekonomike midis qytetarëve, pavarësisht statusit profesional e kulturor në shoqëri e së dyti, ai duhej të përkthehej edhe në barazi hapësinore e arkitekturore në të gjitha banesat e reja, të cilat do të ndërtoheshin më pas. "Njeriu i ri" do të banonte në apartamente, në banesa sociale, të organizuara sipas "standardeve të reja", të ekonomizuara në maksimum sipas konceptit të ekzistencës minimale. Kërkimi për konceptin e standardizimit të banimit ndoqi automatikisht eksperiencën tashmë të kolauduar të arkitektëve rusë apo të boshtit lindor, të cilët kishin kohë që kishin filluar me prodhimet në seri të arkitekturës real-socialiste. Kushtet u krijuan vetëm në vitet pesëdhjetë, kur filluan të kompozoheshin komplekset e para në pjesët qendrore të Tiranës. Sisteme shumë të gjata lineare objektesh banimi u vendosën në zonën e Shallvareve, duke krijuar një siluetë të re përgjatë rrugës që të çonte në Tiranën e Re e përgjatë lumit Lana. (Fig. 12) Gjatësia vetëm e objektit të parë buzë Parkut Rinia, bashkë me pjesën e futur në qendër, arrinte një shtrirje prej 186,6 metrash.



Fig. 12. Planvendosja e objektit të banesave te Shallvaret, plani i katit tip të një pjese dhe foto e kohës realizuar nga Parku "Rinia", janar 1952 (Arkivi Qendror i Ndërtimit)

DO NOT COPY

Në fakt, kemi ndryshime edhe nga pikëpamja arkitektonike në raport me racionalizmin funksionalist italian, të parë në ato objekte që u ndërtuan aty pranë një dekadë më parë. Projektet e firmosuara nga grupi i projektimit, nën drejtimin e arkitektëve B. Daja[8] e G. Strazimiri[9], si dhe komplekset e projektuara në bulevard dhe në kryqëzimin e rrugës së Durrësit me rrugën e ambasadave janë kompozuar mbi baza të forta të arkitekturës neoklasike real-socialiste ruse. Edhe pse janë objekte banimi, elementët dekorative të harqeve në bazamente, të frizave në dritare, kollonave dorike që përshkojnë dy-tre kate e dritaret me hark dhe elementët e tjerë, kanë arritur të krijojnë një ansambël harmonik monumental lehtësisht të perceptueshëm për vetë qytetin. Edhe pse ideja e përdorimit të një arkitekture të tillë pas një dekade lulëzimi të një racionalizmi thuajse mesdhetar, ishte e imponuar, ato kanë arritur të krijojnë "zonat historike" të munguara të qytetit me një stil të "kohës së shkuar".

Ky ishte vetëm fillimi i një rrugëtimi të gjatë ndërtimesh me banesa të standartizuara të cilat pak vite më vonë ndryshuan stil për tu parshtatur modestisht me elementë të thjeshtëzuar të Lëvizjes Moderne, të adaptuar pas viteve gjashtëdhjetë në të gjitha vendet e Lindjes. Normalisht, "standardizimi i ekzistencës minimale" u bë strategji e hekurt e shtetit komunist në vijim dhe erdhi si përgjigje e pamundësisë për të kënaqur kërkesën në rritje për banim të qytetarëve. standardizimi minimal u bë i detyrueshëm edhe në trajtimin e fasadave dhe elementëve arkitekturorë si dhe në plasticitetin volumetrik të objekteve.

Duke bërë një përmbledhje të tre periudhave, mund të themi që tema e banimit tenton të përballet me aspekte të ndryshme, të përcaktuara nga periudhat historike e politike korrespondente, që modifikojnë mënyrën e banimit në pika të ndryshme nga njëra tjetra drejt një "jete më moderne". Tema e banimit me variacionet tipologjike, kostruktive e gjuhësore të shpërndara në indin urban të qytetit të Tiranës, përbën një bosht të fortë qytet-formues me vlera mjaft pozitive që duhen ruajtur, vlerësuar e përcjellë gjeneratave të ardhshme.

DO NOT COPY

Referencat:

[1] Giuseppe Pagano, "Architettura nazionale", në *Casabella* n. 85, janar 1935, si dhe Giuseppe Pagano, *"Architettura e città durante il Fascismo"*, (a cura di Cesare De Seta), Editori Laterza, Roma-Bari, 1990, f. 34-35

[2] M. Giacomelli, A. Vokshi (a cura di), *Architetti e ingegneri italiani in Albania*, Edifir, Firenze, 2012, f. 29-34, 81-87

[3] A. Vokshi, *Tracce dell'Architettura Italiana in Albania*, DNA Editore, Firenze, 2014, f. 44-59

[4] C. Cresti, *Gherardo Bosio, architetto fiorentino*, Angelo Pontecorboli Editore, Firenze, 1996

[5] A. Vokshi, *vep. cit*, 2014, f. 117-151

[6] M.A. Giusti, *Albania, Architettura e Città*, Maschietto Editore, Firenze, 2006, f. 45-65

[7] A. Vokshi, *vep. cit,*, f. 230-131

[8] Ark. Besim Daja studioi në Lubjanë e Leningrad në vitet pesëdhjetë. Është autor i Pallatit të Kulturës, Planit urban të Qytetit "Studenti" etj.

[9] Ark. Gani Strazimiri filloi studimet para luftës në Torino për t'i përfunduar ato më pas në Moskë pas lufte. Nën drejtimin e tij, Grupi i Kulturës Materiale filloi veprimtarinë kërkimore për identifikimin e vlerave të rëndësishme monumentale të Shqipërisë e për t'i vënë ato nën mbrojtje.

Prof. Asoc. Dr. Armand VOKSHI
Polytechnic University
Faculty of Architecture and Urbanism

DO NOT COPY

ARCHITECTURAL VALUES AND THE EVOLUTION OF RESIDENTIAL BUILDINGS IN ALBANIA, 1930 - 1960

The beginning of thirties was generally an important moment in the rapid development of architecture in the Albanian cities. Especially in Tirana, but also in other urban centers had different transformations with architectural value very positive, that followed also in the post-war years. This research considers especially the evolution of residential buildings in Albania after 1930 until the beginning of the sixties.

The system of autochtonous traditional or oriental villas built up in the thirties were added after a series of villas designed by the Italian and Austrian architects, as well as talented Albanian architects, who were formed in Western schools. Architectural and functional values of these villas are an important excessiveness over in the history of Albanian architecture and now constitute the main basis of the memory of our cities.

Another interesting point is the evolution of the common residential buildings that began appearing in Tirana in the 1940s. They were originally designed for the accommodation needs of Italian citizens and soldiers but later, during the years of dictatorship, would prevail totally the urban development of Albanian cities.

After a historical perspective and an analytic point of view, architectural and social, this research aims to establish with examples some development tracks of this architecture, already quite important for our urban identity. This fragile architecture, in our times requires an essentials assessment and protection by the rapid development going on in recent decades in Albania.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

MONUMENTET INXHINIERIKE, PJESË E RËNDËSISHME E TRASHËGIMISË SONË KULTURORE
NDËRTIMET E VJETRA HIDRAULIKE SI FAKTOR HISTORIK

Historia e një populli formohet nga shumë burime, qofshin të shkruara apo verbale, por duhet thënë së trajtimi i objekteve të kulturës materiale përbën një ndër burimet më origjinale dhe më të prekshme për historinë. Në këtë mënyrë, botimet në fushën e trashëgimisë kulturore nuk përfaqësojnë vetëm analizën historike, tipologjike dhe ndërtimore të objekteve që trajtohen, por njëherazi në një masë të konsiderueshme përbëjnë një lëndë konkrete për hartimin e historisë së kombit. Në rastin konkret të temës së trajtuar mbi "Ndërtimet e Vjetra Hidraulike në Shqipëri" sikurse dhe në rastin e gjurmëve të tjera ndërtimore historike, pa dyshim edhe objektet e hershme hidraulike me donacionet dhe kronologjinë historike të realizimit, me larminë e tyre, me shpërndarjen territoriale, me kualitetin e ndërtimit etj., përbëjnë faktor material për lëndën e historisë sonë.

Së pari, numri i madh i këtyre lloj ndërtimeve dhe përhapja gjithëterritoriale e tyre anë e mbanë trojeve shqiptare dëshmojnë për faktin së vendi ynë përfaqëson një terren fiziko-gjeografik të pasur me ujëra. Lumenjtë e gjatë, përrenjtë e shumtë dhe burimet e shpeshta malore, gjatë gjithë historisë sonë kanë krijuar mundësinë e realizimit të ndërtimeve hidraulike në krahina të ndryshme të vendit.

Ndërtimet hidraulike kanë një vazhdimësi historike. Ato kanë shoqëruar që prej antikitetit periudhat e ndryshme të historisë sonë, duke qenë kështu dokumenta materiale të periudhave që përfaqësojnë. Në vartësi të inkuadrimit të trojeve tona në suazën e perandorive të mëdha, akoma dhe sot në terminologjinë tonë historike njihen objekte me cilësimin "Terma apo akuadukte romake", "Terma bizantine", "Banja turke" etj., natyrisht produkt i mjeshtrave vendorë dhe të asimiluar në traditën vendase të ndërtimit.

Historia e Artit Shqiptar të Ndërtimit është pjesë e Historisë së Përgjithshme të Popullit Shqiptar. Dhe sigurisht, objektet hidraulike zënë një kapitull të gjërë në fushën e Artit të Ndërtimeve. Në zbatimin e këtij lloji ndërtimesh tek në qartësisht vërehet një larmi tipologjike dhe funksionale si dhe një cilësi shumë e kualifikuar e realizimit të tyre. Mjeshtri popullor, donatori apo edhe projektuesi i çfarëdo formimi qoftë, në mënyrë intuitive nga përvoja apo me projekte të mirëfillta ose të improvizuara, kanë zbatuar me aftësi parimet e hidraulikës dhe hidroteknikës, të dhënat e fizikës dhe të gjeometrisë si dhe faktorët gjeotopografikë. Me këto shpjegohen ujësjellësit me ose pa presion, parimi hidraulik i enëve komunikuese, pjerrësitë e tubacioneve

dhe kanaleve, puset e dekantimit në ujësjellësit, zgjidhjet hidraulike dhe termoteknike në rastin e banjave publike etj. Të gjithë këta tregues nuk mund të jenë veçse një histori e prekshme për Artin Shqiptar të të Ndërtuarit. Dhe natyrshëm, ato përfaqësojnë bagazhin e mjeshtrit popullor, i cili jo vetëm ka ndërtuar, por madje edhe me një cilësi të admirueshme.

Historia e popullit tonë është jo vetëm një histori e përfshirjes në kuadrin e Perandorive të Mëdha në Ballkan dhe në Europë, por dhe një kronikë e gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit reciprok me vendet e rajonit. Ky bashkëpunim në kuadrin e shkëmbimit të përvojave dhe të respektimit të kontributeve dhe influencave reciproke është veçanërisht i pasqyruar në aktivitetin ndërtimor. Gjatë historisë së tij, populli ka qenë i ndërgjegjshëm për përvetësimin dhe zbatimin e përvojave pozitive nga fqinjët në fushën e ndërtimeve. Aplikimi i përvojave pozitive të të tjerëve nuk përfaqëson ulje dhe kompleks inferioriteti, përkundrazi, ai tregon formimin e një populli, i cili pranon dhe asimilon optimalen dhe pozitiven si elementë të zhvillimit dhe bashkekzistencës. Siç kemi përfituar nga të tjerët, kemi dhe kontribute në ndërtimin e objekteve hidraulike në Ballkan. Në këtë aspekt shquhen mjeshtërit e ndërtimeve hidraulike nga Lunxhëria, të cilët gjatë shekujve XVIII-XIX kanë ushtruar një veprimtari të gjerë jo vetëm në vendlindje, por edhe në Shqipërinë e Jugut. Veprat e tyre, krojet, ujësjellësit, digat e bonifikimit, mullinjtë etj., që ruhen ende në fshatrat e Lunxhërisë, Mingul, Nokovë, Dhoksat, Qestorat etj. impresionojnë me zgjidhjet e tyre teknike dhe funksionale. Sipas burimeve të shkruara, mjeshtërit hidraulikë nga Lunxhëria, gjatë shekullit të XIX kanë dhënë kontributin e tyre deri në qendrën e Perandorisë, Stamboll, ku ata njiheshin si "Çezmaxhinjtë publikë të Stambollit". Për këta mjeshtër të veprave hidraulike, familjen Xhaho nga Dhoksati, janë shprehur studiues dhe udhëtarë të ndryshëm, dëshmitarë të veprave të ndërtuara kudo nga mendja dhe dora e tyre.

Një figurë e njohur historike gjatë fundit të shekullit të XVIII-fillimi i XIX ka qenë Sundimtari i Pashallëkut të Janinës Ali Pashë Tepelena. Gjatë administrimit të tij në Shqipërinë e Jugut është zhvilluar një aktivitet i gjerë ndërtimor. Me emrin e Aliut është lidhur ngritja e shumë veprave në këto treva. Veç rrugëve dhe urave, mjaft objekte hidraulike ia atribuojnë atij. Të tilla janë Ujësjellësi i Kalasë së Gjirokastrës, i Bënçës në Tepelenë, i Vranishtit në Vlorë etj. Ali Pasha ka mbështetur mjeshtërit e Lunxhërisë gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre në Lunxhëri, në Zagori-Pogon, në Dropull, Gjirokastër, etj. Nën pushtetin e Aliut u financuan dhe u ndërtuan shumë vepra hidraulike në territorin e Pashallëkut të tij. Një tregues i rëndësishëm i zhvillimit historik të qyteteve tona mesjetare është dhe prania në këto qytete e një numri të konsiderueshëm objektesh hidraulike. Këto ndërtime, në unitet me zgjidhjet urbanistike, kompozimet funksionalo-arkitektonike, teknikat e ndërtimit, detajet e artit, etj. formojnë historinë e qyteteve tona mesjetare. Spikasin në këtë histori sarënxhat e Gjirokastrës, ujësjellësit dhe krojet e Beratit, puset dhe trumat e Shkodrës, tullumbat e Korçës etj., të cilët përbëjnë elementë tipikë për këto qytete.

Studimi historik i vendbanimeve, pozita gjeografike e tyre, janë kondicionuar me shtrirjen e rrugëve antiko-mesjetare. Këto i ndesh në luginat e lumenjve, në grykat malore etj. Historikisht qarkullimi nëpër to bëhej me karro, qerre dhe me anën e karvaneve tregtare me kafshë, me sistemin e qeraxhinjve gjatë mesjetës. Udhëtimi nëpër këto rrugë zgjaste me ditë, prandaj përgjatë tyre ekzistonin disa lloj objektesh të domosdoshëm për funksionimin normal të tyre, siç qenë stacionet "mansio" dhe "mutatio" në antikitet, hanet në mesjetë, karakollet mbrojtës në qafat malore etj.

DO NOT COPY

Veç këtyre, gjatë rrugëve të hershme hasim dhe krojet apo çezmat ku pinin ujë njerëzit dhe kafshët. Krojet dikur ishin në trajtën e burimit natyror dhe hera-herës përfaqësonin objekte me mure guri, me lugun e ujit, me koritën e kafshëve poshtë etj. Krojet përfaqësonin indikacione për vetë ekzistencën e rrugëve të njohura të kohës. Ato hasen gjatë rrugëve të harruara, si për shembull në aksin e luginës së lumit Shkumbin (Via Egnatia), në rrugën e Arbrit Tiranë-Dibër, në degën e Llëngës të Via Egnatias etj., duke u bërë kështu pjesë e vetë historisë së rrugëve të hershme. Përshkrimi i historisë së ndërtimeve hidraulike në Shqipëri nuk mund të kuptohet si një material i shkëputur nga trajtimi i këtyre lloj ndërtimeve në rajonin e Ballkanit. Ndërtimet hidraulike të antikitetit dhe mesjetës i gjen dhe në vendet e tjera të Ballkanit. Në kuadrin e Organizatave Ndërkombëtare të Trashëgimisë kulturore - UNESCO, ICOMOS, ICCROM etj., është detyrë e vendeve tona studimi i vlerave kulturore të rajonit të Ballkanit. Hartimi i historisë të ndërtimeve në çdo vend në veçanti, në unitet do të formojë Historinë e Artit të të Ndërtuarit në Ballkan. Me këtë ndërrmarje pozitive do të mundësohet dhe një raport objektiv ndërmjet influencave dhe kontributeve reciproke të kulturave të vendeve të rajonit.

Gjurmimi dhe studimi i ndërtimeve hidraulike në Shqipëri aktualisht përbën një problem që duhet trajtuar pa vonesë. Kjo jo vetëm së deri më tani janë të pastudiuar dhe vlerësuar, por dhe për faktin së këto lloj ndërtimesh janë shumë të ekspozuara në terren ndaj agjentëve atmosferikë dhe presionit të energjisë ujore. Për këto arsye ndërtimet hidraulike përgjithësisht kanë një jetëgjatësi të kufizuar. Për arsye të modernizimit të kushteve të jetesës shumë prej tyre ndodhen jashtë funksionit dhe në këtë mënyrë i hasim në gjendjen e objektit rrënojë.

Botimi i një monografie të ndërtimeve hidraulike mbështetur në ato objekte të mbetura deri më sot, përfaqëson vetë historinë e tyre, e cila për arsyet e përmendura më sipër do të vlerësohet akoma më tepër në kohët që do të vijnë, kur shumë prej tyre nuk do të jenë më. Në Komunitet çdo gjë përfaqësohet me historinë e saj, e cila plotëson atë që quhet Historia e përgjithshme e një kombi.

Eshtë i njohur fakti së shumë nga ndërtimet hidraulike, janë të lidhura me emra të figurave historike të antikitetit apo mesjetës. Kështu Ujësjellësi monumental që furnizonte Durrësin në kohën e Romës, është vepër e Perandorit të njohur romak Hadriani (vitet 117-138), me emrin e të cilit identifikohen mjaft vepra të asaj kohe, si rrugë (riparimet gjatë Via Egnatias), ura, ujësjellës, etj. Pas Hadrianit, Ujësjellësi i Durrësit u riparua në kohën e Aleksandër Severit (vitet 222-235).[1] Ujësjellësi tjetër romak, ai i Butrinti me gjatësi 3 km është ndërtuar në fillimet e shekullit të I të erës sonë në kohën e perandorit Oktavian Augusti.[2]

Stacioni Ad Quintum (mutatio) i shekujve I-II ka shërbyer si pikë e rëndësishme e rrugës romake lindje-perëndim Via Egnatia.[3] Ad Quintum ndodhet në fshatin Bradashesh, në hyrje të qytetit të Elbasanit (Scampini romak). Personaliteti historik i qytetit të Pejës, Haxhi Beu gjatë viteve 1462-1485 pat ndërtuar hamamin me emrin e tij në Çarshinë e Pejës, sot i ruajtur në gjendje të restauruar.[4]

Poeti dhe historiani i shquar nga Prizreni Suzi Çelebiu, në dy dekadat e para të shekullit të XVI ndërtoi shumë vepra publike në këtë qytet si: xhami, tyrbe, ura, etj. Gjithashtu, në Prizren mbahet mend dhe një

[1] Hoti, A. *Durrësi*. Tiranë, 2003, fq. 66.

[2] Karaiskaj, Gj. *Butrinti dhe fortifikimet e tij*. Tiranë, 1984, fq. 55.

[3] Shtylla, V., Papajani, L., "Të dhëna teknike mbi rrugën e luginës së Shkumbinit në antikitet dhe mesjetë", *Monumentet*, Tiranë, 1990, fq. 61.

[4] Rizaj, S. *Kosova gjatë shekujve XV-XVI-XVII*. fq. 219.

DO NOT COPY

krua me emrin e tij.[5] Në qendër të qytetit të Prizrenit, një nga monumentet më të spikatura mbetet Hamami i Gazi Mehmed Pashës, i vitit 1564.[6] Gazi Mehmed Pasha përfaqëson një figurë politiko-ushtarake, me mjaft reputacion në Prizrenin e fillim shekullit të XVI, qendër e zhvilluar e historisë së Shqipërisë.

Abdurrahman Pasha nga Peqini-Vezir në kohën e Sulltan Muhametit IV, figurë e rëndësishme e ekspeditave osmane për pushtimin e ishullit të Kretës, ka lënë emrin e tij në ndërtimin e hamamit të Peqinit,[7] nga i cili sot ruhen vetëm themelet dhe gjurmët e hipokaustit.

Në kujtesën historike, sot ujësjellësi që ka pas furnizuar me ujë Kalanë e Gjirokastrës, një vepër komplekse monumentale me gjatësi 12 km, identifikohet me emrin e Ali Pashë Tepelenës, i cili e realizoi atë në vitin 1812.[8]

Veç këtyre edhe shumë ndërtime të tjera të hershme hidraulike kanë histori të lidhura me figura apo ngjarje të shënuara historike.

RRUGËT DHE URAT SI FAKTORË HISTORIKË NË TROJET TONA

1.Objektet e Trashëgimisë nga Kultura Materiale janë dëshmitarë konkretë dhe të prekshëm nga periudha të ndryshme historike. Ata përfaqësojnë tregues të rëndësishëm historikë siç janë, periudha e ndërtimit, figurat historike dhe kontribuesit e ndërtimit të objekteve, tiparet arkitektonike dhe të teknikave të ndërtimit të tyre etj. Ndër këto objekte një vend të dukshëm zënë rrugët dhe urat. Infrastruktura historike rrugore në Shqipëri, mjaft e pasur dhe e larmishme, shpreh faktin së trojet tona që në lashtësi janë trajtuar si pikë kyçe në jug të Ballkanit dhe të Adriatikut për komunikimin lindje – perëndim, konkretisht Europë – Lindje e Mesme dhe Mesdhe – Europë Qendrore. Në historinë e Ballkanit dhe më tej njihen mirë rruga Ilire Via Candavia, rrugët e periudhës së Perandorisë Romake Via Egnatia, Lissus – Naissus, rrugët e luginave Vjosë, Devoll, Shushicë, Kalasë etj, të cilat me rikonstruksione dhe adaptime kanë funksionuar edhe gjatë Mesjetës dhe shekujve XV – XIX të Perandorisë Osmane. Rrugët, përveçse si arterie jetësore për ekzistencën e një kombi ato janë të lidhura dhe me ngjarje të rëndësishme historike si dhe me emra figurash të njohura gjatë zhvillimeve tona historike. Nëpër rrugët tona kanë lëvizur prijësit romakë Cezari dhe Ciceroni gjatë Via Egnatia në shek. e I p.e.sonë, e po këndej dhe barbarët në shekujt V – VI, kryqëzatat normane me Beomundin gjatë shek. të XI kaluan nëpër rrugët e luginave të Shkumbinit, Vjosës e Devollit. Në fundin e shek. XI forcat bizantine me Kantakuzenin lëvizën gjatë Devollit. Në fillim të shek. të XIII komandanti bizantin Gjergj Akropoliti me trupat e tij kaloi nëpër rrugën e Shkumbinit dhe atë të Dibrës (e Arbrit). Pasi humbi rëndësinë gjatë Mesjetës, në shek. XV rruga e Shkumbinit (Egnatia e dikurshme) filloi të aktivizohej përsëri. Në vitin 1466, kur Sulltan Mehmeti II (pushtuesi) erdhi për rrethimin e Krujës, ndoqi rrugën e Luginës së Shkumbinit. Po këtej lëvizi dhe Sulltan Sulejmani me trupat e tij, në verën e vitit 1537, i cili ngriti kampet në Elbasan e Vlorë, si dhe ambasadori Venedikas Bernardi gjatë vitit 1591.

Gjatë shekujve XVIII - XIX një kontribut të ndjeshëm për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në trojet tona dhanë pashallarët e njohur shqiptarë Ali Pashë Tepelena në jug, Ahmet Kurt Pasha dhe Ismail Pashë Velabishti në Berat, si dhe Bushatllinjtë në trevat e Veriut. Gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII

[5] Krasniqi, S. *Prizreni udhëtime nëpër kohë.* Prizren 2002, fq. 27.

[6] po aty, fq. 32.

[7] Machiel Kiel, *Ottoman Architecture in Albania 1385-1912,* fq 203.

[8] Valter Shtylla, "Ujësjellësi i Vjetër i Kalasë së Gjirokastrës", në *Monumentet* 1980, fq. 70.

DO NOT COPY

Ahmet Kurt Pasha dhe Ali Pashë Tepelena patën ofiqin e "Derven Pashajit", ruajtësit dhe mirëmbajtësit të rrugëve, grykave dhe shtigjeve malore, ku kalonin karvanet tregtare. Veç kësaj, në historinë e rrjetit rrugor në Shqipëri figurojnë dhe fshatrat "Dervene", banorët e të cilëve në këmbim të disa detyrimeve fiskale, kishin për detyrë të mirëmbanin dhe kontrollonin rrugët gjatë territorit të tyre. Kështu ishin Derveni në Përmet, në Krujë (Bilaj), në Gjorm të Krujës, në Rubik, në fshatrat e krahinës së Polisit, Librazhd – Babje, Dardhë e Rrajcë. Gjatë rrugës së Arbrit në funksionin e Dervenit ishin Zall – Dajti, Guri i Bardhë etj. Në Shqipërinë e Veriut malësorët e fshatrave të Hotit, të Pultit, të Shalës së Shoshit, të Nikaj – Mërturit e të Kelmendit ishin derbenxhinj. Me vendosjen e sistemit të derveneve tregtare dhe udhëtarët gjatë kalimit nëpër qafat e ndryshme, që edhe ato quheshin "Derbende" (qafa apo ngushtica), ishin të detyruar të paguanin taksën e kalimit që quhej "baxhi derbend" ose "dervenatikon", në Jug.

Përveç figurave dhe vendbanimeve të lidhura me funksionin, ndërtimin dhe kontroll – mirëmbajtjen e rrugëve, element i prekshëm historik për rrugët është dhe përshkrimi kronologjik i tipologjisë së tyre gjatë periudhave historike në vazhdimësi. Llojet e shtresave, përmasat dhe detajet e ndryshme si, kanalet, muret mbajtëse, tombinot etj, përcaktojnë tipologjinë historike të rrugëve tona të hershme. Populli ynë, me tradita të lashta në fushën e ndërtimeve dhe me aftësi krijuese në çdo periudhë, nuk u pajtua asnjëherë me atë që kultura dhe tradita e tij të shuheshin dhe asimiloheshin nga të huajt që kanë shkelur trojet tona. Ai kurdoherë ka respektuar kriterin e kontributeve të ndërsjella duke aplikuar zgjidhjet teknike më të përshtatshme dhe duke përfituar nga përvojat pranë trojeve tona. Ndërtuesit shqiptarë në Mesjetë ishin të organizuar në shoqërinë esnafore. Të njohur kanë qenë esnafët shëtitës të muratoreve e karpentiereve dibranë dhe oparakë, të kalldrëmxhinjeve të Beratit, të mjeshtrave hidraulikë nga Lunxheria, të gurëgdhendësve tiranas etj. Këto grupe shëtitës drejtoheshin nga një kryemjeshtër, i cili, nga shek. XIX fitoi përherë e më tepër tiparet e sipërmarrësit kapitalist.

Këto grupe kishin karakter stinor, pasi në dimër e ndërprisnin punën duke qëndruar pranë familjeve deri në fillimin e pranverës. Aktiviteti i mjeshtrave vendas të ndërtimit përbën një kapitull të rëndësishëm në historinë e artit shqiptar të të ndërtuarit. Mjeshtrit shqiptarë të ndërtimit të rrugëve njiheshin dhe jashtë trevave shqiptare. Në gjysmën e parë të shek. XIX, kalldrëmxhinjtë e Elbasanit riparonin rrugët e prishura të qendrës së Perandorise së Stambollit. Pothuaj në të gjitha rrugët e Stambollit punonin mjeshtër shqiptarë nga Opari, Tomorrica, Çermenika, etj, të cilët i përmblidhte një esnaf i fuqishëm, i vetmi sipërmarrës i punimeve të drejtuara nga Bashkia e Stambollit. Shoqëritë esnafore të ndërtuesve shqiptarë gjatë shekujve XVIII – XIX kryenin shumë funksione komunale, si ndërtimin e rrugëve, urave, krojeve, ujësjellsave etj. Në këtë kohë administrata turke kishte vendosur një sistem rojesh të armatosura për ruajtjen e rrugëve siç ishin, martallozët (roje rrugore të armatosura), sejmenet ose bekçinjtë (jeniçerë të rregullt me armë), arkobuzjerët (roje ushtarake me armë zjarri) si dhe panduret- xhandarmëria fushore. Këto roje lëviznin gjatë rrugëve si dhe qëndronin edhe në karakollet rrugore nëpër qafat malore. Në fushën e ndërtimit të rrugëve dhe urave, populli ynë, duke qenë i interesuar për zhvillimin e lidhjeve ndërkrahinore dhe për ecurinë e marrëdhënieve ekonomike me trevat jashtë vendit, mbështetur në traditat e tij të hershme, realizoi në çdo kohë përshtatjen dhe ndërtimin e rrugëve me parametrat e nevojshëm teknikë. Gjithashtu, gjatë arterieve rrugore u ndërtuan mjaft ura druri dhe guri

PO NOT COPY

mbi lumenj e përrenj të ndryshëm.

Gjatë shekujve të parë të erës sonë, në kohën e Perandorisë Romake, me Perandor August, Vespasjan e veçanërisht gjatë sundimit të Trajanit dhe Hadrianit, në lumenjtë tanë u ndërtuan mjaft ura me qemere guri apo tulla, përgjithësisht për nevojat e fushatave ushtarake. Nga urat romake më të mëdhatë ishin Ura e Vjosës në Tepelenë, e Keçit dhe e Haxhi Beqarit në Elbasan mbi Shkumbin, e Quksit po mbi Shkumbin, e Bashtovës në Kavajë, e Bahçallëkut mbi lumin Drin etj. Të gjitha me qemere, si dhe urat e mëdha prej druri, Topçiasi mbi Shkumbin në Elbasan dhe ura e Rogovës mbi Drinin e Bardhë në Rogovë të Gjakovës. Këto ura të mëdha janë pjesë e rëndësishme e historisë së ndërtimeve romake në trojet e Ilirisë.

Nje urë interesante me qemer tullë e kohës së kapërcyellit Romë – Bizant, nga shekujt IV – V, ruhet e plotë në fshatin Poshnje të Beratit, e cila shërben si vepër historike për kronologjinë e urave të vendit tonë, pasi urat janë objekte të ekspozuara më shumë së të tjerat ndaj faktorëve dëmtues natyrorë, përgjithësisht urat e ruajtuara mbi lumenjtë tanë i takojnë shekujve XVIII – XIX. Shumë nga këto ura janë të lidhura me ngjarje apo figura historike aktive në kronikat gjatë shekujve. Ndërtimi i urës së drunjtë mbi lumin e Bunës nën Kalanë e Razafatit në Shkodër përkon me rrethimin e Kalasë nga turqit në vitin 1479, të cilët e mbronin urën me një kullë druri në hyrjen e saj. Sipas dokumentave historike, Muço Hysa, parardhës i familjes së Ali Pashë Tepelenës, në fillim të shek. XVIII ka qenë Dizdari i Kalasë së Tepelenës, i cili në vitin 1707 udhëhoqi kryengritësit tepelenas kundër sundimit turk. Në këtë kohë ai ndërtoi një urë të madhe me qemer guri mbi lumin Vjosë tek burimi në rrepet ndërmjet Këlcyrës dhe Dragotit, e cila u ngrit mbi gjurmët e një ure të hershme romake. Sot ura metalike mbështetet mbi mbështetjet e urave historike. Mjaft e përmendur është ura e madhe e Vezirit mbi lumin Drin në Kukës. Udhëtarët dhe studiues të ndryshëm e evidentojnë atë si objektin me të rëndësishëm gjatë rrugës së njohur të karvaneve Shkodër – Prizren. Burimet përshkruajnë së në vitin 1910 në urën e Vezirit u vranë 25 kryengritës të Idriz Seferit, njëri nga udhëheqësit kosovarë të lëvizjes shqiptare antiosmane në trevën e Kosovës gjatë fillimit të shek. të XX. Ndërtuar nga Mustafa Pashë Bushati në 1810-20, Ura e Hasan Beut në Berat (sot Ura vajgurore) gjatë mesit të shek. të XIX u bë dëshmitare e përpjekjeve të kryengritësve të kësaj zone me në krye Rrapo Hekalin, Shaban Peshtanin, Ymer Aliun, etj, kundër forcave pushtuese turke me në krye Hysen Pashë Vrionin. Veç këtyre urave që lidhen me ngjarje të ndryshme historike janë dhe një sërë urash të tjera, ndërtimi i të cilave është lidhur me prijës apo ndërtues vendas të njohur në historinë e popullit tonë. Ura e Kasabashit në Çorovodë, një nga urat tona më të hershme është ndërtuar në mesin e shek. të XVII nga arkitekti i njohur Mimar Kasemi, me origjinë nga Gramshi i Tomorricës, në atë kohë në funksionin e Kryearkitektit të Perandorise Osmane. Në urën e Tepelenës mbi lumin Vjosë, në fillim të shek. të XIX ka punuar Petro Korçari, kryearkitekti i njohur i stafit të Ali Pashë Tepelenës, që shquhej për një administrate teknike të fuqishme. Në Shqipërinë e Veriut u ndërtuan mjaft ura nga ana e sunduesve Bushatllinj gjatë shek. të XVIII të Mehmet Pashe Bushati në vitet ‘70 të këtij shek. ndërtoi urën e Mesit mbi lumin Kir, urën e Vezirit në Podgoricë dhe Kara Mahmut Pasha ndër më të përmendurit e derës së Bushatllinjve, në vitin 1796 ka ngritur urën e Tamarës mbi lumin e Cemit të Tamarës të Vermoshit, një vepër mjaft solide.

Në vitet 60 të shek. XVIII Ismail Pashë Velabishti në Berat pati ndërtuar urën e Velabishtit, pranë Xhamisë dhe Sarajeve të tij, urë me kambanë të varur në zinxhir nën kyçin e qemerit kryesor. Një dekadë më vonë,

DO NOT COPY

sundimtari i Beratit Ahmet Kurd Pasha do të ndërtonte urën me qemer guri të Goricës, në vend të një ure të mëparshme prej druri. Ai ndërtoi dhe ura të tjera në Çukas, Mollas, në urën Vajgurore të sotme etj.

Një tjetër figurë historike, Ali Pashë Tepelena, në fundin e shek. XVIII fillim i shek. XIX pati ndërtuar mjaft ura në Shqipërinë e Jugut. Në Zagori – Pogon dhe në Rrëzomën e Delvinës, në fshatrat Hoshtevë, Nivan, Skore dhe në Kalanë e Tatzat akoma dhe sot ruhen në këmbë ura me qemere guri në shërbim të rrugëve të karvaneve që lidhnin Gjirokastrën me Përmetin, me Konicën etj.

Mjeshtri vendas Sotir Ura në vitin 1830 ndërtoi urën e Orgockës mbi lumin Osum në Kolonjë. Gjatë shek. XIX grupe mjeshtrish, zanatçinj të traditës pajtoheshin nga krahina të ndryshme për ndërtimin e urave prej guri. Mjeshtrit kolonjarë nga Borova ndërtuan në vitin 1888 urën e Theollogos në malësitë e Sarandës, ndërsa mjeshtrit nga Opari ndërtuan në fundin e shek. XIX urën e Drashovicës në Lumin e Vlorës. Ura të tjera janë realizuar në nderim ose me kontributin e grave anonime, të cilat përgjithësisht nuk kanë lënë emrin e tyre në objektet. Ato njihen me emërtimet si vijon, Ura e Zonjës në lumin Suhës në Dropull, Ura e Vashës mbi lumin Mat në Gurin e Bardhë të Matit, Ura e Çines mbi lumin e Kalasë së Rrëzomës etj.

Në Bilisht të Zadrimës mbi përroin e Veracakut ndodhet një urë guri mesjetare, pjesë e rrugës së qerreve Durrës – Shkodër. Ajo njihet nga banorët me emrin Ura e Shkinës dhe duhet të jetë ndërtuar në fundin e shek. të XIII në kohën e Mbretëreshës Serbe Helena, me origjine Latine. Në këtë periudhe, në Shqipërinë e Veriut, nën dominimin serb, pati mjaft ndërtime të arkitekturës Romanike si: Kishat e Shirgjit, të Vaut të Dejës, të Balldrenit, Blinishtit, Lezhës etj, siç qe dhe vetë Ura e Shkinës.

1. Në gjysmën e parë të shek. XIX, si pasojë e ndarjes së vendit në Pashallëqe, tregtia ishte mjaft e copëtuar duke pasur karakter të theksuar territorial. Me kalimin e kohës, me zhvillimin dhe fuqizimin e tregut dhe të marrëdhënieve kapitaliste, lindi nevoja për një shpeshtim dhe sistemim të komunikacionit tek ne. Shqipëria, e cila në mesin e shek. XIX zhvillonte një tregti të gjerë me shtetet e huaja, angazhonte 1150 anije në vit, me një kapacitet prej 140 mije tonësh. Rrugët tokësore që trashëgonte vendi nga shekujt e pushtimit turk ishin të ngushta e të pasistemuara, pa mirëmbajtje dhe zgjidhje teknike optimale. Kuadrot e pakta teknike i vlerësonin këto ndërmarrje si mjete përfitimi. Megjithë taksat e mëdha rrugore që vileshin nga popullsia e varfër, rrugët dhe urat e projektuara nuk përfundonin kurrë. Sipas ligjit të vitit 1870, gjithë popullsia me moshë 16-60 vjeç duhet të punonte 4 ditë në vit për ndërtim rrugësh dhe urash. Në fund të pushtimit turk, gjendja e rrugëve në territorin tonë ishte e pakënaqshme. Qytetet ndërmjet tyre lidheshin akoma me rrugët e ngushta tradicionale të karvaneve.

Në gjysmën e dytë të shek. të XIX , si pasojë e rritjes së kërkesave të tregut kapitalist botëror dhe interesave të sunduesve vendas, lindi një farë interesimi për rrjetin rrugor tokësor. U ndërtuan disa rrugë të gjera për karro e qerre dhe u sistemuan disa rrugë ekzistuese. Më 1870 ndërtohet rruga Sarandë – Janinë, me 1875 në Vilajetin e Manastirit ndërtohen 67 km rrugë për karro, 31 ura guri dhe 17 prej druri. Në këtë kohë nga Korça në drejtime të ndryshme kishte 111 km trase dhe në Kolonjë ishin të shtruara 54 km rrugë. Në vitin 1875 filloi ndërtimi i rrugës Durrës – Tiranë. Gjatë viteve 1891 – 93 ndërtohen Ura e Bahçallëkut mbi lumin Drin me gjatësi 114 m. Gjatë vitit 1894, në Vilajetin e Manastirit po ndërtoheshin 256 km rrugë të reja. Rrugët për qerre që trashëgoi vendi nga periudha turke ishin gjithsej 182 km. Ato ishin: rruga Shkodër – Lezhë

DO NOT COPY

42 km, Lezhë – Shëngjin 7 km, Elbasan – Labinot 6 km, Peshkopi – Maqellarë 17 km, Maqellarë – Bllatë 3 km, Korçë – Bilisht 25 km, Gjirokastër – Kakavijë 20 km, Delvinë – Sarandë 16 km dhe Durrës – Tiranë 37 km. Automjeti i parë në Elbasan është parë në vitin 1915, një veturë e ushtrise serbe që vinte nga Polisi e Babja, ndërsa kamioni i parë që erdhi nga Peqini është parë në vitin 1922, e më vonë pas 4 vjetësh u hap rruga e Korçës.

Në fillim të shek. XX[te] u planifikua rigjallërimi i trasesë së Via Egnatia për lidhjen e kryeqytetit Stamboll me skajin perëndimor të Perandorisë. Në vitin 1902 filloi puna nga të dy anët, nga Manastiri dhe Elbasani. Deri në vitin 1909 gjatë kësaj rruge u punua me intervale duke kontribuar dhe sipërmarrës vendas si Osman bej Verlaci, Grigor Nosi nga Elbasani etj. Gjatë viteve 1914 – 1918 të Luftës së Parë Botërore, fuqitë e huaja që hyn në Shqipëri, austro-hungarezët, italianët dhe francezët, duke gjetur një territor pa rrugë, ndërmorën sipërmarrje rrugore për të komunikuar lehtësisht gjatë veprimeve të tyre.

Në veri, austro-hungarezët që patën më shumë territore treguan një përkujdesje më të madhe për rrugët. Rruga Shkodër – Vorë u përshtat për automjete, po kështu dhe rrugët Tiranë – Durrës, Durrës – Kavajë.

Në jug të Shqipërisë, italianët në periudhën 1914-20, për qëllimet e tyre ushtarake, ndërtuan rrugën e Vjosës, Vlorë – Tepelenë – Gjirokastër. Ata ndërtuan gjithashtu dhe rrugën e Bregut, Vlorë – Llogara – Sarandë, 135 km e gjatë. Edhe rrugët Vlorë – Mifol dhe Sarandë – Delvinë – Gjirokastër u ndërtuan prej italianëve. Rruga e vështirë malore Tepelenë – Këlcyrë – Berat gjithashtu i takon asaj kohe.

Në zonën e Korçës qenë forcat franceze, të cilat gjetën atje një rrjet rrugor me të zhvilluar, prandaj nuk patën nevojë të investonin shumë në këtë drejtim. Përveç disa traseve me karakter lokal si rruga Korçë - Bilisht apo ajo e Voskopojës, investimi me i madh i francezëve gjatë Luftës së Parë Botërore, ishte rruga Korçë – Pogradec.

Një tjetër intensitet njohën rrugët shqiptare në periudhën 1920-39, e cila përkon më së shumti me kohën kur Shqipëria drejtohej nga Ahmet Zogu. Qeveria e Kongresit të Lushnjës me seli në Tiranë, ishte pa Ministri të Punëve Botore, Ajo pati vetëm një drejtori me këtë emër, pa një program të gjerë, fillimisht e angazhuar me riparime të vogla në rrugët dhe urat. Në vitin 1921, drejtoria u kthye në Ministri, e cila filloi planifikimin e ngritjes së rrugëve dhe urave. Me një program të studiuar filloi ndërtimi i rrugëve, së pari në aksin Elbasan – Peqin 37 km, dhe në vazhdim me rrugët Pogradec – Qafë Thanë dhe Elbasan - Qukës – Prrenjas. Çelja dhe trasimi i rrugëve kryhej me taksa dhe pune angari, ndërsa veprat e artit financoheshin nga Ministria e Punëve Botore.

Gjyqi ushtarak i vitit 1922 dënoi kryengritësit e revoltës së dështuar Hamid Bej Toptanit, me punë të rëndë e angari të riparonin rrugën e shkatërruar Tiranë – Durrës, e cila përdorej normalisht për karro e automjete. Për të realizuar komunikimin Tiranë – Shkodër, mbi lumenjtë e vegjël u ndërtuan ura druri, si në lumin e Gjoles në Fushë – Krujë. Problem mbeti kalimi i lumit Mat në Milot dhe i Drinit në Bahçallëk, lumenj që atëhere kaloheshin me trap. Në vitin 1923 qeveria plotësoi veprat që mungonin në aksin Durrës – Elbasan – Korçë. U ndërtuan ura dhe u çelën pjesë rrugësh në Peqin, Librazhd, Hotolisht, Qukës, Qafë Thanë etj. Në vitin 1925 u hap pjesa e parë e rrugës Durrës – Elbasan dhe vazhdimi përfundoi në gusht 1926. Trafiku i automjeteve në aksin e rëndësishëm Tiranë – Korçë filloi pikërisht në këtë kohë. Këto rrugë të ndërtuara gjallëruan së tepërmi tregun e brendshëm. Ato lidhën qytetet e vendit me kryeqytetin si dhe trevat tona me ato të Rajonit. Para vitit 1925 u ndërtua rruga

DO NOT COPY

Rrogozhinë – Lushnjë. Lidhja e Lushnjës me Vlorën kryhej nga Roskovec – Fier. Këto lidhje, veçanërisht në dimër paraqitnin vështirësi pasi Shkumbini në Rrogozhinë dhe Vjosa në Mifol kaloheshin me trape. Realizimi i rrugës Rrogozhinë – Lushnjë siguroi trafikun midis Tiranës dhe Beratit, Vlorës, Gjirokastrës dhe Sarandës. Me ligjin e rrugëve, me punë angari të detyruar, u ndërtua deri në vitin 1925 edhe aksi Elbasan – Gostinë si dhe rruga e Gollobordës, Librazhd – Steblevë – Peshkopi e cila, për mungesë të urave hyri në funksion në vitin 1930.

Qeveria pas Kongresit të Lushnjës, fillimisht ndërtoi rrugët kryesore si akse të rëndësishme për ekonominë e vendit. Veçohej zona e Korçës, ku pas ndërtimit të rrugëve kryesore pat filluar dhe ndërtimi i rrugëve lokale si lidhjet me Voskopojën, Vithkuqin etj. Deri në vitin 1925, ndërtimi i rrugëve në Shqipëri ishte realizuar me fondet e buxhetit kombëtar. Më tej, qeveria e Ahmet Zogut, duke e njohur rëndësinë e rrugëve për vendin, në marsin e vitit 1925 kontaktoi me Shoqërine Italiane S.V.E.A. dhe mori një hua të konsiderueshme në franga ari, ndërkohë ligji i rrugëve për punë të detyruar mbeti në fuqi me disa ndryshime në Parlament deri në vitin 1926. Banorët vendas do të punonin 8-10 orë në dite deri në intervalin 55km nga vendbanimi, ndërsa zotëruesi i një qerreje do të punonte 6 ditë për llogari të rrugës. Nga fundi i 1926 vendi kishte një rrjet rrugor që përgjithësisht i përmbushte nevojat e tij, me problem kryesisht në mungesat e urave të mëdha. Në këtë kohë u arrit lidhja e kryeqytetit me të gjithë qytetet e vendit. Në kushtet e huasë së S.V.E.A. parashikohej pjesëmarrja e ndërmarrjeve italiane në ndërtimin e rrugëve dhe urave tek ne, si dhe drejtimi i kualifikuar teknik nga ana e specialistëve të shoqërise së huaj. Jo më pak se 75 % e fuqisë punëtore do të ishin vendas. Në periudhën 1926-37 me huanë e S.V.E.A. u ndërtuan rruga Shkodër – Pukë – Ura e Vezirit, rruga Krujë – Qafë Shtamë, rruga Tiranë – Krrabë – Elbasan si dhe rruga Lushnjë – Kolonjë – Mbrostar. Gjithashtu gjatë kësaj kohe u ndërtuan dhe 18 ura të rëndësishme prej betoni apo hekuri mbi lumenjtë e mëdhenj të Shqipërisë. Këto ishin: Ura e Bunës, Ura e Drinit në Lezhë, e Matit (Zogut) në Milot, e Gjoles në Fushë – Krujë, e Shkumbinit në Elbasan e Librazhd, e Semanit në Mbrostar, e Frrajt në Vjosë, e Kuçit në Seman, e Erzenit në Mullet, e Drinit në Topojan, e Drinit në Vau – Dejë, e Gomsiqes në Pukë, e Vjosës në Dragot, e Drinit në Kukës si dhe shumë ura të tjera në të gjithë territorin.

Ndër këto spikasin: Ura e Zogut në Milot, një kryevepër e kohës, e projektuar nga specialisti i njohur gjerman i Universitetit të Shtutgartit Emil Mersh në vitin 1927, si dhe ura elegante metalike e Dragotit mbi Vjosë, me kapriata metalike të prodhuara në vitin 1936 nga firma italiane ANSALDO e Xhenovas. Në këtë mënyrë, në prag të fundit të Mbretërisë së Zogut, në vitin 1937 në Shqipëri numëroheshin 2224 km rrugë, ndërkohe që 611 km të tjera ishin në proces ndërtimi. Rruga Shkodër – Pukë – Kukës ishte një nga akset me të rëndësishme të ndërtuara me huanë e S.V.E.A. Një tjetër rrugë e ndërtuar nga kjo shoqëri ishte ajo që lidhte Tiranën me Peshkopinë nga ura e Matit, Burreli e Klosi. Mjaft shpenzime mori rruga Krujë – Qafë Shtamë – Burrel, sikurse dhe ajo Qafë – Krrabë – Elbasan. Me rëndësi të madhe ekonomike ishte ndërtimi i rrugës Lushnjë – Mbrostar.

Përgjithësisht, me huanë e S.V.E.A. u angazhuan shoqëritë italiane të ndërtimit, veç rrugëve Tiranë – Qafë Krrabë – Elbasan dhe Lushnjë – Fier, që u realizuan nga një shoqëri sipërmarrëse gjermane.

Përgjithësisht duhet shprehur se pozita gjeografike dhe interesi i komunitetit, historikisht kanë mbështetur trasimin e rrjetit rrugor në trevat tona.

DO NOT COPY



Fig. 1a, 1b, 1c. Vijat antike. Trasetë dhe kalldrëmet antike për karvane dhe qerre



Fig. 2a. Urat e drurit dhe të gurit në vijat e njohura antike

DO NOT COPY





Fig. 2b, 2c. Urat e drurit dhe të gurit në vijat e njohura antike

DO NOT COPY



Fig. 2d. Urat e drurit dhe të gurit në vijat e njohura antike



Fig. 3a. Teknikat e ndërtimit të kalldrëmeve



Fig. 3b. Teknikat e ndërtimit të kalldrëmeve



Fig. 4a. Rrugë antike



Fig. 4b. Rrugë e ndërtuar gjatë periudhës së mesjetës



Fig. 4c. Dendësia e madhe e rrugëve të karvaneve në mesjetë

DO NOT COPY



Fig. 4d. Komunikacioni në rrugët mesjetare



Fig. 5a. Infrastruktura e rrugëve mesjetare. Hanet, karakollet, krojet etj



Fig. 5b. Infrastruktura e rrugëve mesjetare. Hanet, karakollet, krojet etj



Fig. 6a. Urat në Mesjetë. Periudha e pashallëqeve Ahmed Kurd Pasha, Ali Pashë Tepelena, Bushatllinjtë e Shkodrës

DO NOT COPY



Fig. 6b. Urat në Mesjetë. Periudha e pashallëqeve Ahmed Kurd Pasha, Ali Pashë Tepelena, Bushatllinjtë e Shkodrës



Fig. 7a. Ndërtimet hidraulike. Termatantike, vendndodhjet e tyre dhe funksionet



Fig. 7b. Ndërtimet hidraulike. Termatantike, vendndodhjet e tyre dhe funksionet



Fig. 8a. Ndërtimet hidraulike. Hamamet mesjetare (tipologjia, funksioni, tradita)

DO NOT COPY



Fig. 8b. Ndërtimet hidraulike. Hamamet mesjetare (tipologjia, funksioni, tradita)



Fig. 8c. Ndërtimet hidraulike. Hamamet mesjetare (tipologjia, funksioni, tradita)



Fig. 8d. Ndërtimet hidraulike. Hamamet mesjetare (tipologjia, funksioni, tradita)



Fig. 9a. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet

DO NOT COPY



Fig. 9b. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet



Fig. 9c. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet



Fig. 9d. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet



Fig. 10a. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet

DO NOT COPY



Fig. 10b. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet



Fig. 10c. Ndërtimet hidraulike. Krojet: tipologjia dhe datimet



Fig. 11a. Ndërtimet hidraulike. Sterat



Fig. 11b. Ndërtimet hidraulike. Sterat

DO NOT COPY



Fig. 11c. Ndërtimet hidraulike. Sterat



Fig. 12. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Ura e Mesit



Fig. 13. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Ura e Vokopolës



Fig. 14. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Ura e Kasabashit

DO NOT COPY



Fig. 15. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Ura e Poshnjes



Fig. 16a. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Urat e Kosovës



Fig. 16b. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Urat e Kosovës



Fig. 16c. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Urat e Kosovës

DO NOT COPY



Fig. 16d. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Urat e Kosovës



Fig. 17a. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike, si në terma dhe hamame. Durrës, Butrint, Elbasan, Gjirokastër, Shkodër.



Fig. 17b. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike, si në terma dhe hamame. Durrës, Butrint, Elbasan, Gjirokastër, Shkodër.



Fig. 17c. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike, si në terma dhe hamame. Durrës, Butrint, Elbasan, Gjirokastër, Shkodër.

DO NOT COPY



Fig. 18a. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike, si në puse dhe çezma. Shkodër, Prezë, Krujë, Gjirokastër.



Fig. 18b. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike, si në puse dhe çezma. Prezë, Krujë, Gjirokastër.



Fig. 18c. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike, si në puse dhe çezma. Prezë, Krujë, Gjirokastër.



Fig. 19. Ndërhyrjet restauruese në ndërtimet inxhinierike. Punimet e kryera në sterën e Durrësit.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

ENGINEERING MONUMENTS, A SIGNIFICANT PART OF ALBANIAN CULTURAL HERITAGE. ANCIENT AND MEDIEVAL HYDRAULIC CONSTRUCTIONS AS HISTORIC FACTOR

Historic hydraulic constructions in Albania, based on the cronology of their construction, high variety, wide territorial distribution as well as high construction quality, are a significant tangible element for the national history.

The Albanian territory is very rich with water sources, which is the main factor for the construction of a large number of hidraulic structures in many regions of the country thoughout the history.

The first part of this article offers a general overview of these type of constructions and their masters based on historic written sources as well as on local knowledge.

The second part of the article focuses particularly on the historic roads and bridges as the most widespread type of the engineering monuments. The historic road infrastructure in Albania is very rich and diverse. This is due to the fact that the Albanian territory, since ancient times, has been a key point in the southern Adriatic region for the east – west communication routes. The connections of these constructions with important historic events and well known historic figures is presented in this part of the article. The cronological evolution of the different types of hidraulic constructions together with information on their masters, donators and curators throughout the historic periods such as antiquity, medieval times up to the beginning of 20th century is carefully explained in the article. Main monuments of historic roads and bridges are described together with their connections with local guild societies or local masters as well as important historic events.

The historic hydraulic constructions have a fragile nature due to their high exposure to the atmospherical agents and water energy pressure. As a result, these type of historic constructions have a limited lifespan. For this reason, this article is an important contribution to the completeness of knowledge in this particular field as well as on the Albanian history in general.

Prof. Asoc. Dr.Frederik STAMATI

DO NOT COPY

DISA NGA SHPATAT DAMASKINE QË RUHEN NË SHQIPËRI

Në Shqipëri ndodhen rreth njëzet shpata damaskine. Katërmbëdhjetë prej tyre ruhen në Fondin etnografik të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, një në Muzeun Historik Kombëtar, katër në koleksionin e armëve të Ahmet Zogut, një në familjen Stamati. Një tjetër në koleksionin e Z. Artan Lame, është e dyshimtë në sajë të një ndërhyrjeje restauruese të bërë dikur.

Origjina e qenies së tyre në Shqipëri nuk dihet. Shumica e atyre që ruhen në fondin etnografik kanë qenë pasuri e Muzeut Kombëtar, por për to nuk gjëndet ndonjë dokumentacion lidhur me prejardhjen. Të tjerat janë të blera në popull, por edhe këto, gjithashtu, nuk janë të shoqëruara me të dhëna mbi prejardhjen.

Është e mira që në fillim të sqarojmë termin damaskin. Sot nuk përdoret më në literaturën profesionale, ku është zëvendësuar me termin çelik ujor, ose çelik me pamje ujore.

Termi "damaskin" nuk është i saktë dhe nuk paraqet të vërtetën e vendprodhimit të këtij tipi shpatash. Studimet e derisotme[1] kanë treguar se shumica e objekteve të prodhuara me këtë çelik janë nga Irani, apo India dhe asnjë nga Damasku. Megjithatë, termi damaskin, damaskus, apo të damaskuara është përdorur gjerësisht për t'iu referuar efekteve dekorative strukturore të çelikut, kryesisht ne tehet e shpatave, këlliçeve etj.

Të gjitha këto shpata janë dekorative, apo ceremoniale dhe jo luftarake. Në to shprehet aftësia e një mjeshtri për të realizuar me teknika të ndryshme një lloj arti aplikativ. Kjo shprehet në dekoracionin delikat, brishtësinë e tehut, dorezën e dobët dhe pa mbrojtëse të mjaftueshme për dorën etj.

Është e pamundur të diskutosh për shpatat damaskine pa i lidhur ato me historinë botërore të prodhimit të tyre. Le ta shikojmë shkurtimisht këtë çështje.

Çeliku damaskin njihej në Kinë që para erës së re. Por, të dhënat e para për prodhimin e tij janë ato që i përkasin periudhës paraislamike të Iranit, kur përmenden shpatat e prodhuara me çelik ujor në shek. VI. Këto të dhëna jepen nga poeti Imru' Ulqais dhe nga Aus ibn Hajar[2]. Edhe më vonë përmendet prodhimi i tyre në Hera nga al-Biruni, për të vazhduar me përshkrime dokumentore të mëvonshme, të faktuara edhe nga prania më e madhe e këtyre objekteve.

Deri më sot shpata më e vjetër damaskine që

[1] Gilmour, B., *The development of iron and steel technology in southern Asia, 1991*

[2] Smith, C. S. *A history of metallography.*Chikago IL. 1960

ekziston konsiderohet ajo e Nishapurit, megjithëse rrethohet nga një sërë dyshimesh[3], por më e vjetra e padiskutueshme është ajo e Saljuq-it, e realizuara në Hera të Khurasanit rreth vitit 1200[4].

Shpata më e vjetër damaskine e identifikuar deri tani në Shqipëri është ajo e Sulltan Bajazitit të II-të, e fillimit të shekullit XVI, numër inventari 941, (Foto 1, 1a, 1b).

Të pesë të tjerat nuk kanë të shkruar asnjë datë dhe identifikimi i tyre është një proces në studim ende i papërfunduar.

Një nga pyetjet që është shtruar përpara studiuesve ka qënë ajo, se çfarë e bën një çelik të ketë pamje ujore, apo njëlloj, damaskin. Janë bërë studime të shumta për sa i përket përbërjes kimike

dhe kristaline, pra strukturës, dhe tashmë gjithshka është zgjidhur, duke lënë të hapur përcaktimin e qendrave të prodhimit të këtij lloj çeliku dhe shpatave të prodhuara me çelik ujor.

Nga pikpamja kimike, çeliku ujor është hekur me pak mangan, (që shtohej gjatë shkrirjes, ndoshta në formën e piroluzitit për të larguar komponimet e dëmshme të squfurit), me përmbajtje karboni 1,5-2%, ndërsa nga pikpamja strukturore përcaktohet si një përzierje jo e mirë e dy fazave kristaline, konkretisht i cementit në çelik me shumë karbon, që është ferriti. Ngjyrat e ndryshme të këtyre dy fazave kristaline, njëra e bardhë dhe tjetra e zezë formojnë pamjen ujore.

Nuk dihet me saktësi se si ka qenë teknologjia e prodhimit të këtyre shpatave para shek. XIX, pavarësisht nga ndonjë e dhënë përshkrimore e pamjaftueshme që ndeshet në literaturën e kohës përkatëse.

Bazë ka qenë përdorimi i hekurit të zakonshëm të përftuar nga minerali hekuror dhe çeliku i përftuar nga transformimi strukturor i hekurit në çelik, duke shtuar karbon me anë të qymyrgurit, apo materiali drusor, nëpërmjet një teknologjie tepër mjeshtërore, që nuk mund të realizohej nga cilido kovaç.

Dy dokumentet më të plotë që demonstrojnë këtë mjeshtëri janë përshkrimet e Kapitenit të Dytë Massalskij, të publikuara në revistën vjetore të minierave në Rusi[5] dhe nga Bininig[6].

Massalskij bën një përshkrim të zgjeruar, duke u nisur që nga lënda bazë për formimin e shpatave, që është hekuri, çeliku dhe pak argjend. Hekuri duhej të ishte i mirë për një shpatë të mirë. Shfrytëzoheshin hekurat e vjetër, si gozhdat etj., por të pastruara nga ndryshku. Edhe çeliku duhej të ishte i një kualiteti shumë të lartë. Raporti midis hekurit dhe çelikut përcaktohej në 3:1. Të dy metalet coptoheshin, përziheshin mirë dhe vendoseshin në një gotë refraktare, që mbulohej me kapak. Pastaj vendosej në furrë, e cila mbushej plot e përplot me qymyr dhe ndizej. Mbas pesë, apo gjashtë orëve metali shkrinte. Në këtë moment shtohej në gotë 13-17 gr argjend, që shërbente për pastrimin e metalit, e përzihej me një shufër hekuri. Mbas kësaj gota lihej tre ditë për t'u ftohur gradualisht në furrën e fikur. Metali i përftuar përzgjidhej e përpunohej më tej me prerje, rrahje etj., për të dhënë formën përfundimtare, shpatën, sipërfaqja e së cilës gdhendej kimikisht me sulfat bakri, për të bërë të dukshme strukturën damaskine.

Binning jep një njoftim shumë të rëndësishëm kur thotë se për prodhimin e shpatave damaskine përdorej çelik indian. Mbas përgatitjes, tehu futej në

[3] Allan, J. W. *Nishapur Metalwork of the Early Islamic Period.* Metropolotan Museum of Art, New York, 1982.

[4] Hause, C. P., Kroger, J., Lienert, V.*Oriental splendor. Islamic Art from German Private Collections.*MuseumfÿrKunst und Gerwerte.Hamburg, 1993.

[5] Massalskij, "Preparation de l'aceirdamaseé en Perse", *Annuarie du Lournal des Mines de Russier*, 1841.

[6] Binning, R. B. M.*A journal of two years travel in Persia, Ceilon, etc.*London, 1857.

DO NOT COPY

furrë ku mbahej në temperaturë të ulët gjatë natës. Në mëngjes nxirrej, lëmohej, nxehej deri në ngjyrë të kuqe, e pastaj zhytej në një govatë të mbushur me vaj kastori. Më vonë luçidohej, mprihej, montohej doreza dhe kështu bëhej gati për të nxjerrë pamjen damaskine, ose siç quhej jawar, e që përkthehet xhevahir.

Pastaj përgatitej tretësira gdhendëse e sipërfaqes. Për këtë merrej një lloj guri i verdhë, që quhej zaj, (fjalë me prejardheje nga gjuha indiane), ash shami, ose gurkali sirian, pluhurzohej e tretej në një tas porcelani, ose qelqi, por jo metalik dhe lyhej me këtë tretësirë me anë të një shtupe pambuku tri herë sipërfaqja e tehut. Kjo e nxirrte plotësisht në pah strukturën damaskine.

Herë-herë janë dhënë receta të ndryshme nga autorë të ndryshëm për mjeshtërinë që ata kanë ndeshur. Pavarësisht nga komplikimet e mjeshtrit dhe veçantitë e veta në përdorimin e materialeve të ndryshme, në fund të fundit struktura ujore ishte rezultat i mospërzierjes së mirë të dy fazave kristaline, cementit dhe ferritit, ku padyshim është faza e cementit ajo që përzihet në ferrit dhe bërja e dukshme e kësaj strukture nëpërmjet gdhendjes kimike.

Teknikisht ka ekzistuar edhe përftimi i një pamjeje tjetër dekorative që realizohej nëpërmjet ftohjes së ngadalshme të metalit të shkrirë. Gjatë kësaj kohe formohej një strukturë dentrite si rezultat i kristalizimit të veçantë të fazave.

Kërkesat për një shpatë të mirë e që njëkohësisht shërbejnë për identifikimin janë të shumta, si forma, pesha, gjatësia, gjerësia që arrin në dy gisht, mprehja uniforme e tehut në një linjë uniforme 2 mm të gjerë, madhësia dhe forma, tingulli, brimat e çpuara në pjesën fundore të gjuhëzës së tehut ku montohet doreza, ndonjë vulë e prodhuesit, si dhe lloji i dekoracionit ujor.

Megjithatë al-Kindi dallon që në shek. IX çelik me pamje ujore[7].

[7] Noyland, R. B., Gilmour, B., Allan, J., On swords and their kinds, a treatise of Jàqubibnishuq al-Kindi. Nëbotimcituarnga Gilmour, B.*The development of iron and steel technology in Southern Asia, 1991.*

Gjatë studimit janë analizuar disa shpata të Fondit Etnografik pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike. Përmbajtja në elementë kimikë është përcaktuar në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar me anë të Spektroskopisë së Fluoreshencës së Rrezeve X.

Nr.	Nr. inv.	Shek.	Gjatësia	Perberja kryesore kimike	Perberja kimike e shkrimit dhe dekoracionit		Ngjyra okside në teh	Doreza
1	823	-	92,5 cm	Fe	Fe	Cu+Mn	Blu dhe qielli	metalike
2	829	XVII-XVIII	90 cm	Fe+Mn	Cu+Zn		-	lëkurë
3	832	-	95 cm	Fe+Mn	Au		-	bri
4	841	XVI	93 cm	-	Au		-	metalike
5	842	-	94 cm	-	Cu+Zn		-	metalike
6	5485	-	106 cm	-	Au		-	dru

Në shpatat e Fondit Etnografik mund të dallojmë disa shfaqje të pamjes ujore, të cilat mund t'i karakterizojmë vetëm në saj të vëzhgimit me sy të lirë:

a - shpata me çelik ujor, ku përzierja e fazave ka qenë më e mirë, p.sh. shpatat me Nr. inv. 829, (Foto 2 dhe 3) dhe 823, (Foto 4) dhe,

b - shpata me çelik ujor, ku përzierja e fazave ka qenë e lehtë, shpata me Nr. inv. 5485, 832 (Foto 5, Foto 5a) dhe shpatat me numër inventari 841 dhe 842.

Një tjetër klasifikim mund të bëhet duke marrë për bazë ngjyrën e valëzimeve:

a - valëzime me ngjyrë të çelët: në dy raste, siç është shpata e Sulltan Bajazitit të II-të, me Nr. inv. 841 dhe ajo me Nr. inv. 842 nuk mund të gjykohet, sepse për arsye se janë pastruar me zmerilim nga poseduesit e tyre para Luftës së dytë botërore, duke humbur pamjen ujore dhe vetëm disa valëzime të lehta e të lokalizuara aty-këtu dëshmojnë për karakterin e tyre damaskin.

b - valëzime me ngjyrë të errët, shpata me Nr. inv. 832, për të cilën, duke u nisur pikërisht nga kjo paraqitje, mund të gjykohet si e mundshme që të jetë

DO NOT COPY

prodhuar në traditën e Khurasanit. Për këtë tip çeliku mund t'i referohemi shënimeve të lëna nga al-Kindi për tipin e shpatave muharrar.

E veçantë përsa u përket ngjyrave të aplikuara në këto shpata është rasti i shpatës me Nr. inv. 823. Ajo ka dy kanale gjaku, paralele me njëri tjetrin dhe të ndarë me dekoracione në pesë segmente, tri me ngjyrë blu dhe dy me ngjyrë të kaltër, të alternuar. Realizimi i ngjyrave blu është rrjedhojë e një temperimi të ngadalshëm të çelikut në temperaturë 315° C, proces gjatë të cilit formohet një cipë e hollë dhe delikate oksidi. Prania e blusë dhe e së kaltrës në këtë rast mund të shpjegohet me temperim më të gjatë kohor për ngjyrën blu.

Përsa i përket teknikës së realizimit të shkrimeve dhe dekoracioneve dallohen disa raste:

1. Vizatohej shkrimi dhe dekoracioni në tehun e shpatës. Pastaj, me anë të një dalte të hollë incizohej imazhi. Incizimi realizohej në dy forma:

a - si ulluk

b - duke patur kujdes që të formoheshin zgavra anësore, më të zgjeruara në brendësi. Në këtë rast, fundi i ullukut të kujton dhëmbët e sharrës, ndërsa seksioni tërthor një trapez të përmbysur.

Pastaj merrej një tel prej ari, ngrohej i gjithë sistemi dhe teli ngulej në ulluk, duke e rrahur me çekiç. Në shpata më të vjetra, siç është rasti i shpatës së Sulltan Bajazitit të II, teli i arit lihej në reliev (shih Foto 1) mbi sipërfaqen e tehut dhe ky është një tipar dallues i vjetërsisë dhe i cilësisë së lartë.

Në prodhimet e mëvonshme filloi të përdorej një tel më i hollë ari. Shkrimi dhe motivet lëmoheshin në fund të procesit deri në sipërfaqen e shpatës, (shih Foto 5).

2. Parapërgatitej sipërfaqja e shpatës me anë të gërvishjes duke të kujtuar sipërfaqen e limës. Kanalet bëheshin të tërthortë për të mundësuar lidhjen e arit, që realizohej me ngrohje dhe rrahje të telit.

3. Me inçizim të vulave dhe të shkrimeve, siç është rasti i shpatës me Nr. inv. 829, (Foto 6).

Në përgjithësi, dekoracioni është realizuar prej ari dhe jo vetem në shpatë, por edhe në dorezë dhe në ata këllëfe që janë padyshim origjinalë.

Njëkohësisht ndeshet edhe dekoracioni i realizuar me tunxh, siç është rasti i shpatave me Nr. inv. 829, (shih Foto 6) dhe ai me Nr. inv. 842. Madje në rastin e parë ndeshet edhe një alterim në dekoracion i telit prej tunxhi dhe telit prej bakri, rasti i shpatës me Nr. inv. 829, ku ndeshim edhe ngjyrë të kuqe mbi bakër. Më interesant është rasti i shpatës me Nr. inv. 823. Mbi dekoracionin prej tunxhi është formuar një ngjyrë e kuqe, që i përngjet kupritit, pra oksidit një valent të bakrit. Në të tashmen nuk jemi në gjendje të argumentojmë në se kjo ngjyrë e kuqe është krijuar artificialisht për efekt dekorativ, apo është rezultat i proceseve korrozive.

Një shpatë përbëhet nga disa pjesë, siç është fleta kryesore e shpatës, në fund të së cilës zgjatet gjuhëza, herë-herë e të njëjtit trup, ku montohet doreza. Vetë gjuhëza ka shërbyer herë-herë për të karakterizuar një shpatë, p.sh. cilësinë e saj. Ajo shpohej. Sa më shumë brima, aq më e mirë cilësia. Nga ana jonë është i pastudiuar ky aspekt për arsye të kostos dhe se jo gjithmonë është e mundur të çmontosh një dorezë. Por, në disa prej shpatave në studim, kur doreza ka qenë prej briri, dallohen kunjat si ribatina, që kanë shërbyer për montimin, e këto janë dy.

Doreza është një tjetër pjesë përbërëse e shpatës, e kjo mund të ketë qenë prej çeliku damaskin, e dekoruar me ar, rasti i shpatës me Nr. inv. 823, prej një lege argjendi e bakri, Nr. inv. 842, ose prej druri e pështjellë me rrypa lëkure, (aplikim i mëvonshëm), shpata me Nr. inv. 829. Doreza prej briri e shpatës së Sulltan Bajazitit të II-të nuk është origjinale. Në përgjithësi dorezat janë montuar ose me ribatina bakri,

DO NOT COPY

të praruara etj., sipas rastit, ose prej hekuri. Por, vihet re edhe fiksimi i tyre në gjuhëz me anë të derdhjes së një materiali të shkrirë me bazë kollofoni, ose me një material akoma të paidentifikuar.

Midis trupit të shpatës dhe dorezës, në shumicën e rasteve ndeshet një pjesë e ndërmjetme metalike në formë kryqi, që në literaturë ndeshet me emërtimin "quilloin", e që shërbente për të mbrojtur dorën nga goditjet dhe për të pozicionuar shpatën në këllëf. Në një rast, në atë me Nr. inv. 5485, hekuri është damaskin dhe përmban shkrim dhe dekoracione prej ari. Dekoracion tepër të dëmtuar, aq sa nuk mund të studiohet, vërejmë edhe në shpatën me Nr. inv. 829.

Këllëfi përbën një tjetër pjesë të shpatës. Brendësia e tij është prej dy pjesësh druri të gdhendura sipas formës së shpatës, e që pështillen nga jashtë me lëkurë kafshësh, (në një rast mund të jetë lëkurë dhije), ose lëkurë peshku, të lyer me karabojë dhe e "qepur" me një spirale metalike prej ari, ose bronxi. Në këllëf dallohen një sërë pjesësh metalike të realizuara me çelik damaskin, si p.sh. rasti i shpatës me Nr. inv. 823 dhe 5485, ose prej legave të argjendit, apo imitacioneve të tij. Në këllëf ndodhen edhe "medalionet", ku mbërtheheshin unazat, që shërbenin për varjen e shpatës në brez.

Në mbyllje, një këshillë e vetme për restaurimin e tyre. Ato janë tepër delikate dhe nuk pranojnë ndërhyrje kimike për pastrim, por vetëm një punë shumë të gjatë, të lodhshme dhe të kujdesshme në stereomikroskop, vetëm mekanike dhe nga specialistë me përvoje të madhe të punës në restaurim.

DO NOT COPY

Prof. Asoc. Dr. Frederik STAMATI

DOWNLOAD

DAMASCENE SWORDS IN ALBANIA

In Albania there are about twenty damascene swords. Most of them, fourteen pieces, are stored in the Ethnography Fund of the Institute of Cultural Anthropology and Study of Art, at the Centre of Albanological Studies, one is stored at the National Historical Museum and others in private collections, the richest one belonging to the royal family.

Their early origin is unknown. Most of those belonging to the Ethnography Fund originate from the National Museum, maybe one is purchased. Even the one from the National Historical Museum is purchased, as well as that belonging to Stamati family. We do not know the origin of the damascene collection of sword stored in the royal collection.

Term "damascene sword" was used for the first time since mid 19th century, when they were sold in the Damascus market. Later, it was specified that the swords had nothing to do with Damascus, moreover they were not produced there, however, term *damasene* remained to characterize the surface decoration that they have. Today, instead of the term damaskin, the term "steel with water look" is used.

The discovery of the complicated technology of their production was a problem. There is evidence from different sources, describing how this type of steel has been obtained. Today, science has clarified this issue, stating that water structure is the result of mixing the two crystalline phases, the cement in ferrite. Thanks to the different carbon content and different colors, a structure is created, which, if chemically engraved, gives the appearance of water. Written memoirs show that different masters, with more experience, had their own way of obtaining this type of steel.

But, generally, everything was focused on mixing two kinds of materials, ordinary iron and steel. Metals were selected, cracked up, cleansed of rust and placed in refractory closed containers, which were gradually heated. Sometimes, different chemicals were added, as oxide manganese and silver, so as to clean impurities from molten metal.

Melted content was slightly mixed, so as to become unique. That little mixture made that stages remained somewhat special, because only in that way the decorated surface could be realized. After cooling, the acquired block was cut and shaped in the form of the sword. Through various procedures the sword was created, smoothed, inscriptions were carved, which were filled in hot with a gold wire, which, during previous times raised above surface to show value. Later in time it was smooth, equal with the surface of the sword. After all these procedures, the surface of the sword was heated to about 300 Celsius degrees and dyed three times with iron sulphate solution.

During this procedure, a different corrosion of cement and ferrit happened, giving a decorated surface, which is very delicate due to its thickness of only several microns. Finally, the hilt was fixed.

This area is very sensitive and may disappear by different friction. It also dictates a very masterful restoration for mechanical removal of corrosion products.

In the end, we can say that damascene swords were not sword for fighting, but decorative or ceremonial swords, and showed what the master of their implementation was capable of. Ultimately, we can consider this as an applied art.



Foto 1. Shpata e Sulltan Bajazidit të II-të, shpata më e vjetër damaskine e identifikuar në Shqipëri, deri më sot



Foto 1a. Këllëfi i shpatës së Sulltan Bajazidit të II-të



Foto 1b. Fragment nga Këllëfi i shpatës së Sulltan Bajazidit të II-të pas restaurimit



Foto 2. Shpatë damaskine me përzierje më të mirë të fazave cementit dhe ferrit

DO NOT COPY



Foto 3. Fragment nga e njëjta shpatë damaskine



Foto 4. Shpatë damaskine me përzierje më të mirë të fazave cementit dhe ferrit



Foto 5. Shpatë damaskine me përzierje të lehtë të fazave cementit dhe ferrit



Foto 5a. Shpatë damaskine me përzierje të lehtë të fazave cementit dhe ferrit



Foto 6. Shpatë damaskine, ku dekoracioni i verdhë është realizuar me tunxh dhe me teknikën e incizimit.

DO NOT COPY

Arjana SEITI
QSA
Instituti i Antropolgjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit

DO NOT COPY

TRADITË PA MUZE
KRIJIMI I FONDEVE ETNOGRAFIKE DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT NË NJË INSTITUT KËRKIMOR

Qëllimi i kësaj kumtese mbetet parashtrimi i ngritjes së një Muzeu Etnografik Kombëtar Shqiptar në Kryeqytetin e Shqipërisë, në një nga banesat e shumta që janë shpallur Monument Kulture, duke u nisur nga shkaku i mungesës së një ndërtese që do t'i shërbejë këtij qëllimi. Një bashkëpunim mes dy institucioneve mund të realizonte ngritjen e një muzeu të tillë. Të gjithë e dimë se prezantimin e traditës së një kombi apo lokaliteti e realizon fare mire edhe një muze etnografik. Sigurisht që ngritja e tij kërkon edhe lëndën e parë, të cilën do ta prezantojmë si një jehonë ekspozitash etnografike kombëtare dhe ndërkombëtare, ku u afirmuan aspekte të identitetit kombëtar shqiptar.

Instituti i Antropolgjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit [IAKSA] pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike [QSA], prej më se 60 vitesh disponon një koleksion objektesh të ndryshme, të dhuruara dhe të blera sipas kushteve të kohës. Koleksionet, si përfaqësuese të traditës shqiptare, paraqesin spektrin e jetës popullore; *ambiente banimi* në fshat e në qytet; *traditë bujqësore e blegtorale; teknologji e mjeshtëri* popullore; *veshje* karakteristike të traditave lokale si dhe një sërë *aksesorësh* funksionalë dhe zbukurues, duke i bërë këto elementë protagonistë në hapjen e ekspozitave. Përmes promovimit të tyre u arrit fare mirë një rrugëtim i traditës popullore shqiptare e prekshme herë herë edhe në arenën ndërkombëtare. Thuhet se fillimi i çdo aktiviteti publik ose privat: një zyrë, një ent, një ndërmarrje, një industri, një institut kulture, një fondacion, një shoqëri etj., nis me arkivin. Duke u nisur nga ky postulat vë theksin e krijimit të këtij Instituti Kulture, i cili në vetvete përmban një sërë arkivash, ku ruhet dhe hulumtohet tradita shqiptare. Edhe një muze etnografik do të mundësohej falë këtyre fondeve të ekspozueshme të traditës. Por, fatkeqësisht, një muze i tillë në kryeqytetin e Shqipërisë nuk ekziston. Për studiuesen Miriam Kahn, muzetë ndikojnë mbi përkufizimin e traditës dhe trashëgimisë, duke *'krijuar kontekstin'* e këtyre objekteve si dhe *'formuar sensin e autoritetit të tyre'*. Ndërsa studiuesja Ame e konsideron prezantimin, sponsorizimin, përzgjedhjen, kujdesin, stilin e ekspozimit të objekteve, si dhe punën në një muze; si akte politike.

Përpjekjet e vazhdueshme nga kërkuesit shkencorë të këtij institucioni për hapjen e një muzeu etnografik nuk kanë rreshtur prej vitesh. Platforma e tij pa një rrugëzgjidhje endet në tryezat e Institucioneve shtetërore. Ajo çka e bën më specifike këtë muze

etnografik mbetet natyra e këtyre koleksioneve, që e bën atë të ndryshme nga muzetë e artit, historisë apo natyrës, apo nga i shkencave e veprave artizanale. Vetë përbërjet e këtyre objekteve kërkojnë kushte specifike për konservimin, mirëmbajten, mbajtjen nën kontroll të lagështirës, temperaturës, kimikateve të ndryshme, të cilat fatkeqësisht lënë shumë për të dëshiruar sidomos tashmë me ngrirjen e Laboratorit të Restaurimit, i cili i trajtonte objektet dhe njëkohësisht u mundësonte jetëgjatësi. Shqetësimet e Institucionit në lidhje me koleksionet janë gjithnjë tryezë e debateve. Ajo çka do desha të vija theksin dhe që ngrihet si një nga problemet më të mëdha që e shqetësojnë administratën ka të bëjë me mungesën e ndërtesës, kur dimë fare mirë që ka shumë objekte, të cilat janë shpallur monumente kulture e fare mirë një prej tyre mund të ishte i përshtatshëm për të kryer rolin e këtij muzeu, e cila do t'i shkonte për shtat fare mirë kur bëhet fjalë per një traditë të kohës së lashtë. Nuk do desha ta anashkaloja edhe faktin që një pjesë e mirë e këtyre objekteve të shpalluara si *monument kulture* janë kthyer në lokale argëtimi, por që fare mirë, do të dilnin më në pah, nëse do të ekspozonin në ambjentet e tyre artefaktet etnografike (po ofroj një shembull, 'Sarajet', në qendër të Tiranës). E marr këtë spunto dhe për faktin se Muzeu Etnografik i Prishtinës është i vendosur në një shtëpi të vjetër tradicionale.

Do të mundohem të paraqes një panoramë të ekspozitave etnografike si jetë e re, faktet etnografike si kohë e lashtë. Ndërkohë, më pas, do të paraqes dhe pavionet etnografike të cilat u përhapën gjërësisht nëpër rrethet e shumta të Shqipërisë, të cilat tejkaluan caqet e tematikave të tyre, por që do t'i vinin në ndihmë ngritjes së një Muzeu Etnografik Kombëtar në Kryeqytetin e Shqipërisë, *nëse flasim për mungesë përfaqësimi të ekzemplarëve.*

Do t'i kthehemi vitit 1976, kur në ambientet e ekspozitës ***"Shqipëria Sot",*** Instituti i Kulturës Popullore [sot IAKSA] do të kurorëzonte hapjen e ekspozitës [pavionit] *"Kultura popullore shqiptare". Edhe pse logoja e ekspozitës dhe ajo e pavionit do të tingëllonte disi paradoksale: ekspozita e quajtur "Shqipëria Sot", identifikonte realitetin e ri socialist, por kultura fshatare e ekspozuar duhej kuptuar dhe vlerësuar politikisht e shkencërisht nën dritën e këtij fakti.*

Kjo ekspozitë e shtrirë në një sipërfaqe prej 920 m^2 dhe shpesh herë e konsideruar nga studiuesit vendas si "pavion etnografik", me një jetë sociale prej 18 vjetësh, më lejojnë ta trajtoj atë në këndvështrim të një muzeu, i cili bëri jetë edhe pse jo në dimensionet e duhura që kërkonte koha. Në të do të ekspozoheshin vetëm 1000 objekte nga koleksioni etnografik apo "*Fondet"* siç quhen ndryshe të IKP-së nga 1976-2008**.**

Në këtë hapësirë, ku IKP-ja ekspozoi një pjesë nga fondet disponuese në rastin tonë të mbledhura në terren, të blera apo të dhuruara prej thuajse tri dekadash, me origjinalitetin e tyre të pacënuar me qëllimin e një prezantimi të ndërthurjeve të kulturave e traditave lokale e krahinore*, kishte një paraqitje dinjitoze për të sjellë fakte të së shkuarës sa më afër.*

"Jeta e re", përmes ekspozitave, si dhe jehona në skenën kulturore shqiptare arriti të joshte pasurim të jetës kulturore, vizitorë më të shumtë, si dhe kërkesë për mirëmbajtje të objekteve të ekspozuara. Për fat të keq, rifreskimi i pritshëm ndaj kësaj vitrine të madhe dhe dinjitoze të traditës shqiptare, nuk ndodhi. Kjo tregon se mes institucionit dhe ekspozitës nuk kishte një lidhje organike, një nga faktet që e bën këtë muze të mos mbijetojë. Sipas rregullave të muzeve ndërkombëtare, nëse nuk gjenden pesë ekzemplarë për një objekt të caktuar, ai nuk mund të gëzojë të drejtën e ekspozimit të përhershëm, por vetëm të përkohshëm, fakt ky ndoshta themelor, që nënkupton të mos trajtuarit e ekspozitës si muze. Në mungesë të ekzemplarëve, ndonjëherë

DO NOT COPY

ky rregull nuk ka gjetur zbatim gjatë ngritjes së këtyre ekspozitave. Stafi që duhej të menaxhonte këtë ekspozitë të madhe e komplekse ishte tepër i cunguar: vetëm një përgjegjës, një ciceron, një mirëmbajtës dhe një sanitare, pak a shumë një staf i tillë ka qenë prezent dhe në muzetë historike nëpër rrethe që u hapën më pas.

Fill pas viteve '90, në 1994, bashkë me shumë ndryshime dhe rrënime që ndodhën në Shqipëri, as kjo ekspozitë nuk arriti dot që të shmangte fatin e saj për të mbijetuar. Koleksionet ekspozuese u rikthyen në fondet e Institutit, kështu që ekspozita nuk mundi të funksionontë më.

Në një nga relacionet e përgjegjësit të kësaj ekspozite, Prof. P. Karkanaqe, thuhet se kjo ekspozitë u frekuentua prej 15 mijë personave prej 50 vendeve të ndryshme, pikërisht kur Shqipëria konsiderohej si më e izoluara në Ballkan. Përgjatë informacionit të tij, jepen dhe disa përshtypje të cilat mund të jenë dhe të përzgjedhura sipas interesave të asaj kohe. Por, ajo që do theksoja është se në ndonjë prej përshtypjeve, të cilat janë dhënë prej grupeve të huaja vëmë re se i drejtohen '*muze etnografik*', edhe pse ajo ishte cituar e propaganduar si një pavion brenda një ekspozite.

Ndërkohë, pas hapjes së kësaj ekspozite, në Shqipëri nis dhe merr përmasa në shtrirje hapja e "muzeve tematikë" në rrethe, të cilët nuk mund të anashkalojnë traditën. Për 'Muzetë tematikë' propagandohej që të mos kalohej jashtë asaj çka kërkohej. Tema dhe tematika, që do përfshinte ekspozitën, ideohej nga specialistët e IKP dhe miratohej nga instancat drejtuese të vetë institucionit [Këshilli Shkencor], dhe pa dyshim e gjitha kjo falë faktit se IKP posedonte arsenalin autokton etnografik shqiptar. Në tetor të vitit 1976 hapet *Muzeu Historik i Rrëshenit*, në ‹79 hapet *Muzeu Historik në Librazhd*, në prill të 1980 hapet *Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë,* ku përveç historisë, etnografia ofronte pavione të ndryshme apo atë artit të kultivuar fetar. Përurimi i *Muzeut Historik Kombëtar* në Tiranë më 28 tetor 1981 pati rezervuar një hapësirë në dispozicion të kulturës popullore shqiptare kryesisht fshatare (punë të fshatarëve, barinjve, punë me vegjë), sepse mendohej se vetëm përmes tyre ruheshin besnikërisht traditat. E njëjta situatë ndodh edhe sot, pranë këtij muzeu po përgatitet hapja e një pavioni etnografik me një pjesë nga koleksionet e IAKSA. *Pikërisht fakti i të moslënit pa prezantuar kohën e lashtë përtej tematikave që miratoheshin, nuk mund të trajtohet si nostalgji por si domosdoshmëri identitetesh kombëtare, të cilat i duhen përçuar patjetër masës.*

Tematika specifike në ekspozitat e përkohshme etnografike

Pas viteve '80 kemi një lulëzim të ekspozitave të përkohëshme [2-3 javore]. Spektri tematik i ekspozitave u zgjerua në mënyrë të ndjeshme dhe hapja e tyre u mirëprit me interes nga publiku, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Kështu po rendisim disa ekspozita: '*Kultura popullore shqiptare*' në Shkodër me objekte nga gjithë trevat shqiptare; '*Tradita e ndërtimeve popullore në Mat*',; në mars të 1983 hapet ekspozita *'Veshje popullore të Tiranës*'. Dua të përmend edhe ekspozitat në vende të ndryshme të Europës: Greqi, Rumani, Itali, Francë, Austri, Norvegji, Gjermani, të cilat prireshin nga tematika të larmishme, por që këtë radhë nuk lanë mënjanë edhe objektet qytetare shqiptare. Kështu përmendim: "*Arti shqiptar në shekuj*" në Romë, 24 shkurt - 19 maj 1985, *ku vlen të përmendet fakti i realizimit të saj përmes bashkëveprimit të katër institucioneve kulturore dhe shkencore shqiptare* (Qendra e Kërkimeve Arkeologjike, Instituti i Kulturës Popullore me 165 objekte kryesisht tekstile dhe argjendari, Galeria Kombëtare e Arteve dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës). Më 21-31 gusht 1985 në

DO NOT COPY

Vollos të Greqisë hapet ekspozita e katërt ballkanike, ku pasqyrohej puna e mjeshtërve zejtarë në të gjitha llojet e metaleve (teneqe, bakër, hekur, bronx, argjend, ar). Në këtë ekspozitë ishin të pranishme dhe pajisjet e guzhinës së Ali Pashë Tepelenës; ekspozita në Bari të Italisë (10 tetor – 9 nëntor 2007), realizon dhe promovon online koleksionet jashtë kufijve shqiptarë; ekspozitë në Uashington, ekspozitë në 100 vjetorin e shtetit shqiptar pranë Muzeut Historik Kombëtar me tematikë "Veshje popullore shqiptare" (7-28 nëntor, 2012), e shumë të tjerë.

Në këtë çast dëshiroj të theksoj dhe dy qëllimet kryesore të ngritjes së këtij muzeu specifik: Mos të harrojmë se si gjithnjë në fokus të muzeve mbeten vizitorët, të cilët tërhiqen tek e vërteta. Muzeu ynë etnografik përveçse do të përcillte ngjarje dhe njohuri tradicionale shqiptare, njëkohësisht do të lehtësonte mësimdhënien përsa i përket traditës shqiptare.

Në mbyllje do të shtoja se lënda e parë për ngritjen e një muzeu etnografik nuk mungon dhe se janë instancat shtetërore që duhet të mundësojnë objektin si ndërtesë, për faktin e vetëm se një muze i tillë do të realizonte më së miri një paraqitje dinjitoze të traditave të kombit tonë.

REFERENCA

1. Kahn Miriam., "Heterotopic Dissonance in the Museum Representation of Pacific Island Cultures". *American Anthropologist*, New Series, Vol. 97, No. 2 (Jun., 1995), pp. 324-338
2. Becker Karin., "Picturing Our Past An Archive Constructsa National Culture", *Journal of American Folklore* 105 (1992)
3. Revista: *Kultura Popullore*; 1982/1. f.112, f. 178; KP/2, 1980, f.236,f. 230.
4. Abaz Dojaka, "Disa udhëzime për mbledhjen sistemimin dhe studimin e materialeve etnografike, *Etnografia Shqiptare*, 1976, nr.7
5. Gazeta: 'Drita', 12 maj 1985; 19 maj 1985; opininone rreth ekspozitës: 'Arti Shqiptar në shekuj'
6. Gazeta: "*Zëri i popullit*" 1 mars 1983.
7. Seiti, Arjana., "Një vështrim historik mbi themelimin e arkivave shkencorë të IAKSA-s", *Gjurmime albanologjike, folklor dhe etnologji*, 44/2014, Prishtinë. f.321
8. Seiti Arjana., "Identitet kulturor shqiptar në 100 vjet", 2013., *Arkivat e shkruara të IAKSA dhe pasurimi i tyre*, f.117.

DO NOT COPY



Foto 1. Ekspozita: Kultura Popullore



Foto 4. Foto nga ekspozita në Bari. Foto A.Seiti



Foto 3. Ekspozita në Bari-Itali



Foto 2. Pusi, objekt qyteti



Foto 5. Muzeu Etnografik – Prishtinë

DO NOT COPY

Arjana SEITI
Centre for Albanological Studies

DO NOT COPY

TRADITION WITHOUT MUSEUM
ETHNOGRAPHIC FUNDRAISING AND MANAGEMENT POLICIES IN A RESEARCH INSTITUTE

The topic of this paper deals with the closed ethnographic collections stored at the research institute of the Centre for Albanological Studies as well as with the presentation forms of cultural artefacts. The ethnographic exhibitions, which have been temporarily opened at home and abroad, do usually present concrete objects, reconstructed milieu and idealized images of Albanian local traditions, comprising the daily life, agricultural traditions, traditional technologies and handcrafts, representative regional costumes and textile, and many functional and decoration objects. The absence of an Albanian Ethnographic Museum cannot be merely compensated through publications, illustration books or audiovisual documentation, hence, the researchers of the former Institute for Folk Culture had made many efforts to find an optimal solution for their closed ethnographic collection but unfortunately without success. Taking into account the globalist hegemony in contemporary period, where many languages and traditions are dying every day, it is more than necessary to construct and implement cultural polities for the preservation of Albanian traditional practices as well as for their (re)presentation in local and national ethnographic museums.

Erilda SELAJ
Muzeu Historik Kombëtar

DO NOT COPY

PASQYRË E PROJEKTEVE TË HARTUARA NGA INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS PËR PERIUDHËN 2010 -2013 DHE IMPAKTI I TYRE NË RUAJTJEN E VLERAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE.

Hyrje

Instituti i Monumenteve të Kulturës është institucioni më i rëndësishëm në sistemin e trashëgimisë për ruajtjen, restaurimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore materiale. Si i tillë ai harton projekte dhe propozon politika në këtë fushë që nga themelimi i tij. Ky artikull është një përmbledhje e shkurtër e një studimi të bërë në arkivën e institucionit, me qëllim evidentimin e projekteve të konservimit/restaurimit dhe rijetëzimit, të hartuara dhe propozuara nga specialistët e këtij institucioni dhe jo vetëm, në harkun kohor 2010-2013. Duke qenë të ndërgjegjshëm se në morinë e projekteve jo të gjithë kanë qenë të suksesshëm, ky material nuk ka për qëllim analizimin e tyre por synon specifikisht të sjellë në kujtesë disa raste studimi mbi projekte të cilat kanë pasur një impakt pozitiv në lëmin e trashëgimisë materiale.

I gjithë materiali që ka shërbyer si objekt studimi dhe paraqitur në këtë material është marrë pranë arkivës së Institutit të Monumenteve të Kulturës. Janë shqyrtuar rendet e ditës dhe vendimet e mbledhjeve të Këshillit Shkencor të IMK dhe Këshillit Kombëtar të Restaurimit. Më pas janë studiuar të gjitha dosjet përkatëse të projekteve dhe raportet përfundimtare, në rastet kur kishte një të tillë. Informacioni i grumbulluar është hedhur në një databazë të hartuar për këtë qëllim e më pas është përpunuar duke nxjerrë rezultatet e mëposhtme.

Gjatë katër viteve (2010-2013), Këshilli Shkencor i IMK dhe më pas Këshilli Kombëtar i Restaurimit ka marrë vendim për 312 projekte në monumente, zona historike dhe arkeologjike, zona tampon apo zona të mbrojtura dhe 31 kërkesa subjektesh apo individësh (Fig.1).

Gjatë vitit 2010 janë zhvilluar 9 mbledhje nga



Fig. 1. Grafik përmbledhës i çështjeve për të cilat Këshilli Shkencor i IMK ka marrë vendim

të cilat kanë dalë 20 vendime, të cilat miratojnë ose jo 98 projekte dhe 5 kërkesa, gjithsej 103 shqyrtime. Në vitin 2011 janë mbajtur 5 mbledhje nga të cilat kanë dalë 11 vendimet. Anëtarët kanë dalë me vendim për 68 projekte 9 kërkesa, gjithsej 77 shqyrtime. Në vitin 2012 në këto mbledhje janë marrë 26 vendime mbi 74 projekte dhe 10 kërkesa, pra është marrë vendim mbi 84 çështje. Ndërsa në 2013, Këshilli Shkencor mblidhet vetëm 2 herë, por merr 28 vendime mbi 72 projekte dhe 7 kërkesa.

Financimi i projekteve të hartuara apo miratuara nga IMK

Për t'u zbatuar një projekt sigurisht që duhet më parë të financohet dhe një problem i madh për menaxhimin e trashëgimisë kulturore është mungesa e financimit të projekteve. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e trashëgimisë, veçanërisht IMK hartojnë projekte, mirëmbatje, restaurimi, prezantimi por në shumicën e rasteve këto projekte nuk realizohen për mungesë fondesh. Kështu, institucionet i drejtohen subjekteve të ndryshme për financim, kuptohet që jo gjithmonë marrin dritën e gjelbër. Ndërkohë, projektet



Fig. 2 . Grafik, Llojet e financimit të projekteve

me financim privat kanë tjetër fat, kjo kategori projektesh thuajse gjithmonë zbatohet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihet raporti i financimit të projekteve (Fig. 2).

Vendin më të madh e zënë projektet me financim privat, të cilat ndiqen nga donacionet, e në fund projektet e financuara nga buxheti i shtetit. Projektet me financim privat janë kryesisht projekte për rikonstruksione, ndërtime apo rindërtime banesash, projekte për kthim banesash në objekte shërbimi, duke kryer rikonstruktim apo rindërtim në to. Në këtë kategori, projektet thuajse gjithmonë financohen nga pronarët e objektit përkatës. Objektet apo truallet në të cilat bëhen ndërhyrje ndodhen kryesisht në qendra historike, zona arkeologjike ose zona tampon.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, gjatë këtij segmenti kohor ka hartuar një numër të konsiderueshëm projektesh me qëllim ruajten, mbrojtjen, restaurimin dhe prezantimin e objekteve të trashëgimisë. Financimi i këtyre projekteve ka rezultuar gjithmonë problematik. Pas hulumtimesh mbi objektin këto projekte hartohen, preventivohen dhe qëndrojnë në pritje të financimeve, të cilat vijnë nga buxheti i shtetit.

Në tabelën e mësipërme mund të shihet që numri i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit është më i vogël në krahasim me llojet e tjera të financimit. Vlen të theksohet që në realitet numri projekteve të financuara nga buxheti i shtetit është më i vogël, pasi shumica e projekteve që hartohen e miratohen e që duhet të financohen nga buxheti i shtetit, në mungesë financimi dhe në pamundësi të ngritjes së fondeve të tjera, përfundojnë në listën e gjatë të pritjes për fonde, që mund të mos vijnë kurrë. Ndaj kjo kategori projektesh ka koeficentin me të vogël të zbatimit.

Vitet e fundit projektet e hartuara nga IMK të financuara nga donatorë, janë më të shumtë në numër se ato të financuar nga buxheti i shtetit. Ambasadat e huaja

DO NOT COPY

në Shqipëri, delegacionet e ndryshme, si ai i Këshillit të Europës, organizatat, fondet e zhvillimit etj. janë dyert ku trokitet gjithmonë në mungesë fondesh. Pjesa më e madhe e projekteve të hartuara nga institucionet e trashëgimisë financohet pikërisht nga këto donacione. Komisionit Europian ka financuar: Projektin e Restaurimit të Kalasë së Tiranës dhe projektin për Vlerësimin dhe Zhvillimin e Trashëgimisë Materiale të Beratit në vitin 2010, Projektin e Restaurimit të Infrastukturës së Qendrës Historike-Shkodër etj. UNESCO është gjithashtu financues i shumë projekteve, përgjithësisht financues në projektet e konservimit dhe restaurimit të ikonave, por dhe financues i Projektit të Rehabilitimit të Muzeut Arkeologjik të Apollonisë[1]. Fondi për Zhvillimin Rajonal del si financues në plot 18 projekte konservimi e restaurimi, por jo të gjitha këto projekte janë zbatuar. Disa nga këto janë: 1. Punime Restauruese dhe Konservuese-Qyteti Antik Lissus, Lezhë. 2. Projekti i Restaurimit të Kambanares së Kishës së Shën Nikollës, Voskopojë. 3. Projekt Restaurimi i Banesës së Hasan Tahsinit-Ninat, Sarandë [2] etj.

Ambasadat e shteteve të huaja në Shqipëri janë gjithashtu pjesë e donatorëve të projekteve të restaurimit. Projekti i restaurimit të Teqesë Helvetive në Berat, monument i kategorisë së parë, u financua nga ambasada e SHBA[3]. Një projekt tjetër ishte ai i Restaurimit të mozaikut Paleokristian në Parkun Arkeologjik të Antigonesë[4]-Gjirokastër, financuar nga Ambasada Gjermane. TIKA[5] është një tjetër donator dhe agjencitë që kryen ndërhyrje restuauruese në objektet trashëgimisë që i përkasin kultit islam. Kjo agjensi ka zhvilluar 6 projekte restaurimi në xhami të ndryshme të Shqipërisë, si: Projekti i Restaurimit të Xhamisë në Kalanë e Prezës dhe ngritjen e minaresë sipas origjinalit. Projekti i Restaurimit të Xhamisë së Iliaz Bej Mirahorit. Korçë, Projekti i restaurimit të Xhamisë së Plumbit-Berat[6] etj. Po ashtu, ka një pjesë të projekteve që bëhen me financim të përbashkët privat dhe shtetëror, por këto lloj financimesh janë në numër të vogël dhe janë praktikuar kryesisht në ndërhyrjet në qëndrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës.

Materialet e përdorura

Pjesë shumë e rëndësishme e konservimit dhe restaurimit në vetvete, pa të cilën nuk mund të kuptohet ky proces, janë dhe materialet e restaurimit. Materialet e përdorura në ndërhyrjet e ndryshme variojnë në bazë të karakteristikave, problematikave dhe materialit përbërës të objektit si dhe ndërhyrjes që do të kryhet në objekt etj. Por ajo që vihet re në këtë studim është se materialet e përdorura ndryshojnë jo në vartësi të karakteristikave të mësipërme por vartësi të faktit së kush ekzekuton këtë ndërhyrje. Kryesisht, në ndërhyrjet e restaurimit të bëra nga specialistë të institucioneve shtetërore, materialet e përdorura janë tradicionale dhe tentojnë të jenë materiale të rikthyeshme. Ndërsa materialet e përdorura në projektet me financim privat janë kryesisht moderne e nuk i përmbahen parimeve të konservimit apo restaurimit, nuk përfshijmë këtu materialet e përdorura në ndërtimet e reja, ku përdorimi i materialeve moderne është logjik.

Në projektet e konservimit që u përkasin veprave të artit[7], të cilat janë hartuar nga institucionet shtetërore, më saktësisht nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, materialet e përdorura, proçedura e restaurimit dhe

[1] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 18 dt. 31.08.2010

[2] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 8 dt. 31.05.2012

[3] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 1 dt. 23.03.2010

[4] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 21 dt. 09.10.2012 (Qarkullues)

[5] Agjensia Ndërkombëtare Turke për Zhvillimin

[6] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 6 dt. 16.04.2012

[7] Në të tilla projekte bëhet fjalë për ndërhyrje konservimi në ikona dhe mozaikë.

DO NOT COPY

metodat janë konform parimeve tashmë të mirënjohura të restaurimit. Nuk mund të themi të njëjtën gjë në rastin e ndërhyrjeve restauruese në banesa. Në pjesën më të madhe të banesave historike, që përbëjnë monument të kategorisë së dytë materialet e përdorura në ndërhyrje janë të moderne e që nuk përkojnë në ato të përdorura më parë në objekt. Nëse në të tilla raste qasja është deri diku e kuptueshme e kundërta mund të thuhet për banesat monument kulture të kategorisë së parë në të cilat përveç materialeve tradicionale janë përdorur dhe materiale moderne të huaja për objektin.

Shpërndarja gjeografike e projekteve

Gjatë studimit të shtrirjes gjeografike të projekteve të hartuara nga IMK apo të subjekteve dhe institucioneve të tjera por të miratuara katër vitet e fundit nga Këshilli Shkencor, është e dukshme shpërndarja aspak homogjene e këtyre projekteve, dhe mungesa e një studimi për të hartuar një plan mbi objektet që kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershmë dhe ato në të cilat nevojitet ndërhyrje në një periudhë afatmesme.

Shtrija e këtyre projekteve në hapësirë dhe në kohë është interesante. Në vitet 2010-2011 numrin më të madh të projekteve qoftë të ndërhyrje private apo për ndërhyrje të mirëfillta restaurimi, e ka Berati e pas tij Gjirokastra ndërsa në vitet 2012- 2013 kjo qendër zhvendoset duke bërë Korçën rrethin me numrin më të madh projekteve. Më poshtë paraqitet grafiku i cili pasqyron numrin e monumenteve për secilin rreth dhe numri i projekteve të miratuara gjatë këtyre katër viteve. Me ngjyrë blu është nr. i monumenteve të kulturës dhe me ngjyrë të kuqe numri i projekteve të realizuara në çdo rreth (Fig. 3). Korça është rrethi me numrin më të madh të projekteve të hartuara dhe miratuara plot 61, më pas vjen Berati me 57 projekte, Gjirokastra me 31, Tirana dhe Shkodra me nga 24 projekte, Elbasani me 14 ndjekur nga Saranda me 13 projekte, Vlora me 11,



Fig. 3. Grafik i shpërndarjes së projekteve sipas rretheve në raport me numrin e monumenteve për çdo rreth.

etj. Po të shohim hartën e shpërndarjes së projekteve e ndërhyrjeve të miratuara nga Këshilli Shkencor i IMK dhe KKR, vërejmë se shpërndarja e tyre nuk është homogjene (Fig. 4).

Për shumë arsye, projektet në pjesën dërrmuese janë hartuar për monumentet e shtrira në jug të vendit gjithashtu dhe të gjithë projektet e tjera të miratuara shpërndahen në jug të vendit. Vetëm në pak raste në pjesën veriore si në Shkodër e Lezhë hasen projekte restaurimi. Ndërhyrjet me iniciativë dhe financim

DO NOT COPY



Fig. 4. Harta e shpërndarjes së projekteve

privat janë të përqëndruara në jug të vendit, e më pak në Shqipërinë e mesme dhe thuajse aspak në veri. Por ky dallim nuk vihet re vetëm në projektet e hartuara për ndërhyrje nga individë privat, por dhe në projektet e restaurimit në monumente të hartuara nga institucionet e trashëgimisë e veçanërisht nga IMK.

Kategoritë e ndërhyrjeve

Ndërhyrjet e hartuara nga specialistët e IMK apo të miratuara në vendimet e Këshillit Shkencor dhe KKR janë të kategorive të ndryshme. Projektet e miratuara janë rigrupuar dhe është bërë një kategorizim specifik i tyre. Më poshtë gjeni tabelën e këtyre projekteve me kategorizimin dhe numrin e ndërhyrjeve sipas secilës kategori (Fig. 5). Kjo ndarje është bërë në bazë të natyrës të secilit projekt të miratuar. Projektet janë ndarë në 12 kategori. Mbizotërojnë ndërhyrjet restauruese të cilat përfshijnë projektet e restaurimit, 22 ndërhyrje konservimi dhe 20 restaurime historike, gjithsej rreth 135. Vendin e dytë e zënë rindërtimet, 56 të tilla. Më pas vijojnë rikostruksionet 26 të tilla, ndërtimet zënë 24 e kështu me rradhë. Instituti i Monumenteve të Kulturës ka hartuar kryesisht projekte ndërhyrjesh restaurimi dhe konservimi e më pak projekte mirëmbajtje apo të natyrave të tjera.

Pavarësisht faktit që një pjesë e konsiderueshme e projekteve të hartuara nga IMK nuk janë zbatuar për mungesë fondesh, projektet e realizuara kanë pasur kryesisht një impakt pozitiv në rang lokal dhe më gjerë. Më poshtë janë dhënë disa shembuj projektesh të suksesshme të realizuar gjatë viteve 2010-2013.

Projekt Restaurimi i Kalasë së Tiranës

Restaurimi i fasadës verilindore të Kalasë së Tiranës që përfshin dy kulla, një rrethore dhe një katrore, u zhvillua në vitin 20108. Gjatë disa punimeve

[8] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 6 dt. 08.06.2010



Fig. 5. Grafik, Llojet e ndërhyrjeve

DO NOT COPY

infrastrukturore u zbuluan rrënojat e Kalasë së Tiranës, të cilat përbënin pjesën e murit verilindor të kalasë. Pas zbulimit rastësor punimet u ndërprenë dhe u zhvilluan gërmime arkeologjike. Muri fillestar i kalasë ruhej në 2-4 rrathë gurësh të latuar, ndërsa poshtë tij është gurë e themeli[9]. Faqet e kullës së rrumbullakët ishin të



Fig. 6. Kullë rrethore, Kalaja e Tiranës, foto e marrë nga interneti www.google.com

rrënuara deri në pjesën e poshtme të themelit. Në kullën me formë drejtkëndore mungonte një pjesë e murit perëndimor. Pas studimit të objektit dhe konstatimit të gjendjes së konservimit u hartua projekti i restaurimit të fasadës. Përgatitja dhe realizimi i projektit doli si domosdoshmëri e ndërtimit të rrugës këmbësore, ekzistenca e të cilës u kushtëzua nga zbulumi i rrënojave të kalasë. Projekti konsistoi në konsolidimin dhe sigurimin e stabilitetit të rrënojave. Projekt restaurimi i Kalasë së Tiranës është një shembull i mirë jo vetëm i ndërhyrjeve të restaurimit por dhe një shembull shumë i mirë i prezantimit të trashëgimisë e specifikisht i monumenteve me natyrë arkeologjike, në kontekste urbane (Fig. 6).

[9] Projekt restaurimi i Kalaja e Tiranës, 2010, f. 1

Ndërhyrjet konservuese në bazilikën e Shën Janit, Delvinë[10] (dyshemeja me pllaka guri dhe mozaik opus sectile). Ndërhyrjet konservuese të cilat u zhvilluan gjatë muajit shtator 2010, si rezultat i një



Fig. 7. Pjesë nga dyshemeja e bazilikës së Shën Janit, marrë nga projekti

bashkëpunimi midis Misionit Arkeologjik Italian në Shqipëri, të Universitetit të Bolonjës dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës, u përqendruan në pjesën e brendshme të bazilikës, veçanërisht tek dyshemeja e naosit dhe më pak tek ajo e narteksit, duke pasur parasysh se monumenti përbëhet nga elementë me vlerë që paraqesnin paqëndrueshmëri dhe patologji të ndryshme, të cilat me kalimin e kohës kishin agravuar gjendjen konservuese

[10] Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Vendimi Nr. 12 dt. 27.07.2010

DO NOT COPY

të monumentit[11]. Ky projekt është një shembull i mirë i bashkëpunimit të suksesshëm të IMK me institucionet shkencore të shteteve fqinje (Fig.7).

Ndërhyrjet konservuese në mozaikët e Triconch Domus, Butrint. Përmendim këtu një seri projektesh konservimi të shtrira në harkun kohor 2010-



Fig. 8. Mozaik i Triconch Domus, marrë nga projekti

2013, në ambientet me mozaik të pallatit të Trikonkës. Projektet u zhvilluan në një bashkëpunim frytdhënës midis IMK, Fondacionit Butrinti dhe Parkut Kombëtar, Butrint. Jo vetëm një model i mirë konservimi të këtyre mozaikëve brenda kontekstit të tyre origjinal (in situ) por solli dhe një impakt të vazhdueshëm pozitiv në rritjen e vizitueshmërisë, si një atraksion i veçantë për këtë sit të trashëgimisë botërore gjatë sezonit turistik (Fig.8).

[11] Islami, A., Ricciardone, M., Zguro, K., « Ndërhyrjet konservuese në bazilikën e Shën Janit, Delvinë (dyshemeja me pllaka guri dhe mozaik opus sectile) », *Monumentet,* 52, 2011-2014, f. 93



Fig. 9. Kisha Fjetja e Shën Mërisë, Voskopojë

Restaurimi i kishës Fjetja e Shën Mërisë, Voskopojë. Ky projekt restaurimi u implementua në vitin 2012. Ndërhyrjet restauruese në këtë monument janë një shembull i mirë se si restaurimi mund të përdoret për të sjellë më pranë trashëgimisë brezat e rinj, të tërhequr gjithmonë e më shumë ndaj teknologjive të reja. Ky projekt u zhvillua në vitin 2012 në formën e një kampi restaurimi për studentët e degëve të lidhura me restaurimin, të cilët vinin nga Shqipëria dhe vendet fqinje. Voskopoja Restoration Camp rezultoi një projekt i sukseshëm i IMK. Përsëritja e këtij kampi do të ishte me rëndësi për sjelljen e të rinjve më afër trashëgimisë në përgjithësi dhe restaurimit në veçanti (Fig. 9).

DO NOT COPY

Erilda SELAJ
Nation Historical Museum

DO NOT COPY

AN OVERVIEW OF THE PROJECTS DEVELOPED BY THE INSTITUTE OF CULTURAL MONUMENTS FOR THE PERIOD 2010 -2013 AND THEIR IMPACT ON THE PRESERVATION OF CULTURAL HERITAGE IN ALBANIA.

Institute of Culture Monuments is the most important institution in the cultural heritage system for the preservation, restoration and presentation of tangible cultural heritage. It creates and proposes policies and projects in this field since its establishment. This article is a brief summary of a research conducted in the archives of the institution, in order to identify conservation/ restoration and revitalization projects, created and proposed by specialists of this institution and not only, for the period 2010-2013.

The material that served as the subject of research and presented in this paper is taken in the archive of the Institute of Cultural Monuments. A database with all the material taken from the projects is created from which are provided the results below. During four years (2010-2013) the scientific council of the Institute of Culture Monuments and then the National Council for Restoration has decided to develop 312 projects in monuments, in historical and archaeological areas, buffer zones or protected areas and on 31 entities or individuals request. Three are the sources of projects funding; individual funds, state funds and donations. Materials used on restoration projects are traditional and reversible in the case when these projects are made by state institutions and modern (inreversible) when done by individuals. The geographical spreading of projects in monuments is not homogeneous. Most of the projects created and conducted concerning the period above are focused in south Albania, less in middle Albania and almost inexistent in the north of the country.

Gjejlane HOXHA
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

DO NOT COPY

TRASHËGIMIA NDËRTIMORE E DËMTUAR NË KOSOVË UDHËZIME PËR KONSOLIDIM (FIRST AID TO BUILT HERITAGE).

Studiuesja nga Republika e Kosovës, znj. Gjejlane Hoxha, kumtoi në Konferencë udhëzimet përndërmarrjen e masave të shpejta urgjente për të siguruar, shpëtuar dhe stabilizuar trashëgiminë ndërtimore, të dëmtuar nga faktorë të ndryshëm natyrorë apo njerëzorë. Këto udhëzime, të trajtuara edhe në Kursin e parë ndërkombëtar 'First Aid to Cultural Heritage in Times of Conflict', ICCROM, Romë, Itali, 2010, përbëjnë një eksperiecë të vlefshme për t'u aplikuar edhe për monumentet tona



Fig. 1





DO NOT COPY

Fig. 2, 3

TRASHËGIMIA NDËRTIMORE E DËMTUAR
SITUATA

- Ndërtimet tradicionale të dëmtuara janë në situatë të pafavorshme dhe të rrezikuara nga shpërbërja apo zhdukja.



- Sfondi i ndërtimeve tradicionale të dëmtuara, padyshim bartë vlera artistike, historike, kulturore, shoqërore, ekonomike, shkencore, mjedisore, politike, etj.

- Si pasuri me vlera dhe rëndësi shumëdimensionale të njerëzimit, i duhet **NDIHMA E PARË** për shpëtim, konsolidim dhe riaftësim të përdorimit nga brezat e sotëm dhe atyre pasardhës.

NDIHMA E PARË - DETYRIM LIGJOR GLOBAL

- **Detyrim ligjor në rafshin nacional dhe ndërkombëtar.**
- **Zbatimi përmes politikave dhe programeve nacionale e ndërkombëtare për mbrojtjen dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore të dëmtuar.**
- **Monumentet arkitekturale ose ndërtesat brenda ansambleve që janë në një gjendje të keqe të riparimit ose janë në rrezik të dëmtimit domethënës bëhen objekt i një procedure riparuese urgjente ose emergjente.**



DO NOT COPY

Fig. 4, 5





DO NOT COPY

Fig. 6, 7





DO NOT COPY

Fig. 8, 9





DO NOT COPY

Fig. 10, 11

Klasifikimi i dëmeve



- Rënim komplet.
- Rënim i pjesëshëm.
- Shkputje të elementeve arkitektonike dhe atyre dekorative.
- Plasaritje në sipërfaqe, në murre, rreth hapjeve, etj.
- Lëkundje dhe deformime të elementeve konstruktive.
- Diletime në fuga, ndërtesë, hapje, shpërbërja e elementeve konstruktive.
- Çregullime konstruktive të tjera.

SIGURIA DHE STABILIZIMI



- Siguria;
- Evakuimi;
- Rivendosja (salvage), triazha, stabilizimi in situ;
- Deponimi i përkohshëm

DO NOT COPY

Fig. 12, 13





PHOTOCOPY

Fig. 14, 15





DO NOT COPY

Fig. 16, 17





DO NOT COPY

Fig. 18, 19





PROTOTYPE COPY

Fig. 20, 21

DO NOT COPY

Joaquín Ruiz de Arbulo
Universitat Rovira i Virgili / Institut Català d'Arqueologia Clàssica
CHTMBAL Tempus Project
Spanjë

DO NOT COPY

TARRAGONA. LIVING IN A ROMAN CITY
A CULTURAL HERITAGE EXPERIENCE.

Profesor Joaquín Ruiz de Arbulo prezantoi në Konferencë një temë me shumë interes, që lidhet me rijetëzimin e monumenteve të periudhës romake, të ruajtura në qytetin e Tarragonës, në Spanjë .

Tarragona është një qytet në bregdetin lindor të Spanjës (Fig. 1), kur dikur ngrihej një qytet romak (Fig. 2), nga i cili kanë arritur deri në ditët tona një numër i madh monumentesh (Fig. 3, 4). Restaurimi i rrënojave të ndërtimeve romake është bërë krahas integrimit të tyre në strukturën e sotme të qytetit (Fig. 5, 6, 7), njëkohësisht ato janë vënë në përdorim për kërkesat e shoqërisë së kohës (Fig. 8, 9, 10).

Rijetëzimi i amfiteatrit romak përbën një shembull të suksesshëm të shfrytëzimit të monumenteve. Deri para pak kohe amfiteatri ishte i vizitueshëm vetëm nga turistët, pra kishte një shfrytëzim të kufizuar. Përdorimi i tij nga një publik i gjerë rriti në mënyrë të konsiderueshme vizitueshmërinë e tij dhe gjallëroi së tepërmi jetën e qytetit, duke rikthyer qoftë edhe funksionin fillestar të amfiteatrit (Fig. 11-16).

Funksione të tjera të preferuara ishin dhe shfaqjet artistike në ambientet antike (Fig. 17, 18). Por një funksion shumë kurioz dhe i suksesshëm ishte rikthimi i mjeshtërive të vjetra, jo vetëm për ekspozim, por edhe për tregtim prodhimesh të këtyre mjeshtrive, madje edhe duke mësuar përdorimin e veglave të tyre (Fig. 19-21).

Pikërisht kjo mënyrë rijetëzimi rriti ndjeshëm fluksin e vizitueshmërisë, që pati si rezultat edhe rritjen e të ardhurave, të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e vazhdueshëm të monumentit (Fig. 22).

Vlerat, përkujdesja dhe vënia në shërbim të publikut të gjerë të monumenteve të Tarragonës merituan deklarimine tyre si Pasuri Kulturore Botërore, në mbrojtjen e UNESCO-s në vitin 2000 (Fig. 23). Referimi mbyllet me ftesën "Mirë se vini në Tarragona" (Fig. 24)

---

1 Redaksia mendoi të botojë një pjesë të referimit për interesin që paraqet për opinionin shkencor dhe atë publik tema kaq aktuale e rijetëzimit të monumenteve

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 1

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 3 Rrënojat romake ndodhen kudo, Fig. 4 Rrënojat romake janë monumentale







Fig. 5, 6, 7

DO NOT COPY







DO NOT COPY

Fig. 8, 9, 10





DO NOT COPY

Fig. 11, 12 Ka një problem. Unë që jetoj në Tarragona, nuk e vizitoj teatrin. Këtë gjë e bëjnë vetëm turistët





DO NOT COPY

Fig. 13 Tarraco Viva do të thotë ndryshim në mënyrën se si ne i qasemi trashëgimisë sonë. P.sh. Një mbrëmje letrare shoqëruar me një pije. Fig. 14 Ripërjetim. Amfiteatri romak mund të kthehet në funksionin e tij, si dikur



DO NOT COPY

Fig. 15, 16 Publiku merr pjesë. Nuk ka asgjë të përbashkët me një Muze





DO NOT COPY

Fig. 17, 18







Fig. 19, 20, 21 Të mësosh se si të bluash







DO NOT COPY

Fig. 22 Tarragona. Pasuri Botërore, Fig. 23 Viti 2000. Mbledhja e ICOMOS/UNESCO në Caims (Australi). Tarraco u shpall Pasuri Botërore. Objektivi u arrit. Po tjetër…?, Fig. 24 Rafa, faleminderit për fotot! – Rafael Lopez-Monné, gjeograf dhe shkrimtar.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ISSN 0253-1607